

MINISTRIA E ARSIMIT, E SHKENCËS DHE E TEKNOLOGJISË

PLANI DHE PROGRAMI MËSIMOR GJUHË SHQIPE

PËR NXËNËSIT E KOMUNITETEVE JOSHQIPTARE

për klasat 3,4,5,6,7,8,9,10,11,12,13

Prishtinë
dhjetor, 2006

Kryeredaktor

Dr. Fehmi Ismaili

Redaktorë:

Mr. Miranda Kasneci

Ramush Lekaj



**INSTITUCIONET E PËRKOHSHME VETËQEVERISËSE
PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF-GOVERNMENT
PRIVREMENE INSTITUCIJE SAMOUPRAVLJANJA**

QEVERIA E KOSOVES – GOVERNMENT OF KOSOVO – VLADA KOSOVA

**MINISTRIA E ARSIMIT, E
SHKENCËS DHE E
TEKNOLOGJISË**

**MINISTRY OF EDUCATION,
SCIENCE & TECHNOLOGY**

**MINISTARSTVO ZA
OBRAZOVANJE, NAUKU I
TEHNOLOGIJU**

Kabineti i Ministrat

Cabinet of the Minister

Kabinet Ministra

UDHËZIM ADMINISTRATIV

NUMËR: 2/2007

DATË: 19.01.2007

LËNDA: Zbatimi i planit dhe programit të gjuhës shqipe për nxënësit e komuniteteve joshqiptare për klasat 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9, 10, 11, 12, 13

Në bazë të nenit 6.1 paragrafi (b), (c) dhe (d), nenit 7, 8 si dhe nenit 12.3 të Ligjit mbi Arsimin Fillor dhe të Mesëm dhe në përputhje me nenin 1.3 pika (ç) të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2001/19 mbi Degën e Ekzekutivit të Institucioneve të Përkohshme të Vetëqeverisjes në Kosovë, Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë nxjerr këtë Udhëzim Administrativ:

Neni 1

Qëllimi

Qëllimi i këtij udhëzimi është zbatimi i planit dhe programit mësimor për nxënësit e komuniteteve joshqiptare për klasat 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9, 10, 11, 12, 13 si rezultat i ristrukturimit të sistemit të arsimit.

Neni 2

Plani-programi

Plani dhe programi i ri për klasat 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9, 10, 11, 12, 13 i është bashkangjitur këtij Udhëzimi Administrativ.

Neni 3

Zbatueshmëria

1. Ky plan dhe program për klasat 3, 4, 5, 8, 9, 12, 13 zbatohet nga viti shkollor 2006/2007.
2. Me zbatimin e planit dhe të programit të klasave 3, 4, 5, 8, 9, 12, 13 shfuqizohen planet dhe programet e deritashme.

Neni 4

Hyrja në fuqi

Ky Udhëzim administrativ hyn në fuqi me nënshkrimin e Ministrit.



Agim Veliu, ministër

PËRMBAJTJA

Udhëzim administrativ	3	
UDHËZIME		
PËR ZBATIMIN E PLANIT DHE TË PROGRAMIT	7	
I. Hyrje		7
II. Qëllimet		8
III. Vlerësimi		10
IV. Udhëzime metodologjike		13
V. Burimet dhe mjetet mësimore		14
GJUHË SHQIPE 3	17	
GJUHË SHQIPE 4	29	
GJUHË SHQIPE 5	41	
GJUHË SHQIPE 6	53	
GJUHË SHQIPE 7	65	

GJUHË SHQIPE 8	77
GJUHË SHQIPE 9	91
GJUHË SHQIPE 10	105
GJUHË SHQIPE 11	119
GJUHË SHQIPE 12	131
GJUHË SHQIPE 13	143

UDHËZIME PËR ZBATIMIN E PLANIT DHE TË PROGRAMIT

I. HYRJE

Arsimi përfaqëson fushëveprimtarinë prirëse të zhvillimeve shoqërore, politike dhe ekonomike të Kosovës.

Vizionin për krijimin e një shkolle bashkëkohore sipas standardeve më të avancuara ndërkombëtare, që filloi pas përfundimit të luftës, Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë (MASHT) po e realizon duke ndërmarrë hapa të gjithanshëm dhe praktikë në të gjitha fushat e veprimit.

Në këtë ndërmarrje me rëndësi historike për zhvillimin dhe për përparimin e shoqërisë kosovare MASHT-ti synon të ndryshojë pikëpamjet në procesin e ndërtimit të individit me një vizion të qartë për të ardhmen e tij dhe të vendit të tij.

Kjo krijon parakushtet e nevojshme për integrimin e individit dhe të shoqërisë kosovare në lëvizjet politike, në zhvillimet ekonomike, intelektuale, shkencore e teknologjike, si dhe në zhvillimet social-kulturore të vendeve të përparuara evropiane dhe botërore.

Zhvillimi i Planit dhe programit lëndor mbështet mbi bazën e një procedure të mirëfilltë shkencore, si nga forma, qasja metodologjike, organizimi dhe ndërtimi i përmbajtjes së lëndës, ashtu edhe nga parashtrimi i rezultateve të të nxënit, mjetet mësimore, metodat, teknikat dhe instrumentet e vlerësimit.

Grupet punuese profesionale për zhvillimin e planeve dhe të programeve ishin vazhdimisht në rrjedhë të zhvillimeve të reja në arsim dhe në konsultim me ekspertët ndërkombëtarë. Në këtë proces të zhvillimit të planprogrameve, i cili qëndron mbi bazën e strategjisë afatgjatë të MASHT-it, ndihmë të konsiderueshme kanë dhënë UNICEF-i, agjencitë dhe qeveritë e disa shteteve.

Vëmendje e veçantë i është kushtuar kultivimit të qëndrimit pozitiv ndaj të nxënit, inkurajimit të nxënësve që të angazhohen në mënyrë të arsyeshme në përmbushjen e kërkesave shkollore, zhvillimit të shkathtë-

sive në jetën e përditshme, gjithmonë duke pasur parasysh karakteristikat e zhvillimit fizik dhe psikologjik në këtë moshë.

Realizimi i qëllimit të këtij Plani dhe programi do të varet nga puna e përkushtuar e mësimitdhënësve, të cilëve edhe u kushtohet ky plan dhe program. Për ta lehtësuar zbatimin e këtij plani dhe programi mësimor, Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë do të organizojë kohë pas kohe cikle ligjëratash me mësimitdhënës të udhëhequr nga ekspertë fushash përkatëse me një udhëzim shtojcë të këtij plani dhe programi.


II. QËLLIMET

Plani dhe programi mësimor në klasat 3,4,5,6,7,8,9,10,11,12,13 për nxënësit e komuniteteve joshqiptare ka për qëllim që nxënësve:

- t'iu sigurojë kushte të përshtatshme për zhvillimin intelektual, estetik, fizik, shoqëror, moral dhe shpirtëror të nxënësve;
- t'iu sigurojë orientim dhe t'iu ndihmojë në realizimin e interesave të tyre personale për plotësimin e aspiratave përmes nxënies.
- t'iu bëjë konsolidimin e diturive, ngritjen, orientimin e prirjeve dhe të shkathtësive në ndërtimin e të ardhmes së tyre;
- t'iu mundësojë shfrytëzimin e burimeve të shumta për sigurimin dhe përpunimin e informacioneve si dhe për zhvillimin e një qasjeje kritike ndaj informacioneve dhe fakteve që u ofrohen;
- t'iu mundësojë që në mënyrë të pavarur të marrin iniciativë dhe veprim të pavarur, gjithnjë duke pasur parasysh rregullat themelore të sjelljes në grup, varësisht prej llojeve të ndryshme të veprimtarive që zhvillojnë;

Grupet punuese për zhvillimin e planeve dhe të programeve në përshtatshmëri me përmbajtjen i kanë zgjedhur objektivat e përgjithshëm dhe specifike për sendërtimin e qëllimeve të lartshënuara nga të cilat në mënyrë të qartë janë përcaktuar edhe rezultatet e pritura në përfundim në klasat 3,4,5,6,7,8,9,10,11,12,13.

STRUKTURA E SISTEMIT TË ARSIMIT NË KOSOVË



III. VLERËSIMI

Vlerësimi është proces i vrojtimit, i mbledhjes sistematike, i analizimit dhe i interpretimit të informatave me qëllim të përcaktimit se deri në çfarë shkalle nxënësi i ka zotëruar objektivat udhëzuese. Ai duhet të mbështetet në rezultatet e pritura të programit të lëndës përkatëse dhe të nivelit përkatës.

Ky proces mbështetet në disa parime themelore, siç janë:

- përcaktimi i qëllimit dhe i përparësive në procesin e vlerësimit;
- zbatimi i instrumenteve adekuate të matjes në përputhje me qëllimin në mënyrë që të matet ajo që është synuar të matet;
- sigurimi i cilësisë së informatave për arritshmërinë e rezultateve të nxënësit nëpërmes matjes dhe vlerësimit të vazhdueshëm;
- matja dhe vlerësimi duhet të jenë të balancuara, të përfshihet e tërë përmbajtja programore e lëndës;
- vlefshmëria e qëndrueshme e të dhënave se shkalla e arritshmërisë së nxënësit është e saktë;
- zbatimi i teknikave të vlerësimit me anë të së cilave bëjmë dallimin e qartë të arritshmërisë së nxënësve.

III.1. Instrumentet e vlerësimit

Mësimdhënësi i lëndës dhe shkolla duhet të zgjedhin dhe të zbatojnë një numër të mjaftueshëm instrumentesh për matje dhe vlerësim, siç janë:

- vrojtimi;
- pyetësi (vetëvlerësimi);
- raporti me shkrim i një pune praktike apo një hulumtimi;
- të shprehurit me gojë;
- të shprehurit me shkrim;

- fleta kontrolluese (përdoret për shkathtësitë manovruese të nxënësit);
- dosja apo portofoli (vetëvlerësimi);
- testi i bazuar në kriteret dhe objektiva;
- testi i arritshmërisë i ndërtuar nga kërkesa (pyetje):
 - me përgjigje alternative të shumta;
 - me përgjigje të hapura të shkurtra;
 - me përgjigje të hapura të zgjeruara etj.

dhe çdo instrument tjetër që mësimitdhënësi e vlerëson të nevojshëm.

Çdo shkollë vendos standardet apo kriteret me anën e së cilave përcaktohet shkalla e arritshmërisë në fund të procesit mësimor për klasën e gjashtë, shtatë, dhjetë, njëmbëdhjetë.

III. 2. Shkalla e përfitimit

Në fund të vitit mësimor çdo nxënës duhet të arrijë njërin prej shkallëve të përfitimit të arritshmërisë:

- shkëlqyeshëm (arritje shumë e lartë);
- shumë mirë (arritje e lartë);
- mirë (arritje mesatare);
- mjaftueshëm (arritje e kufizuar) dhe
- pamjaftueshëm (arritje e pamjaftueshme).

Shkalla e përfitimit të arritshmërisë varet drejtpërdrejt nga standardet e arritshmërisë të cilat bazohen në:

Objektivat e përgjithshëm	Arritje shumë e lartë 90%	Arritje e lartë 80%	Arritje e kënaqshme 60%	Arritje e kufizuar 40%	Arritje e pamjaftueshme
<i>Njohja e lëndës</i>	Aftësi shumë e lartë në njohjen dhe në zbatimin e njohurive të lëndës në situata të thjeshta.	Aftësi e lartë në njohjen dhe në zbatimin e njohurive të lëndës në situata të thjeshta.	Aftësi mesatare në njohjen dhe në zbatimin e njohurive të lëndës në situata të thjeshta.	Aftësi e kufizuar në njohjen dhe në zbatimin e njohurive të lëndës në situata të thjeshta.	Aftësi jo e mjaftueshme në njohjen dhe në zbatimin e njohurive të lëndës në situata të thjeshta.
<i>Të kuptuarit e proceseve shkencore</i>	Aftësi shumë e lartë e të kuptuarit dhe e zbatimit të fakteve, parimeve, relacionit shkak pasojë, mbledhjes dhe organizimit të informacioneve, të gjykuarit e thjeshtë.	Aftësi e lartë e të kuptuarit dhe e zbatimit të fakteve, parimeve, relacionit shkak pasojë, mbledhjes dhe organizimit të informacioneve, të gjykuarit e thjeshtë.	Aftësi e kënaqshme e të kuptuarit dhe e zbatimit të fakteve, parimeve, relacionit shkak pasojë, mbledhjes dhe organizimit të informacioneve, të gjykuarit e thjeshtë.	Aftësi e kufizuar e të kuptuarit të detyrave dhe të proceseve shkencore	Aftësi e pamjaftueshme e të kuptuarit të detyrave dhe të proceseve shkencore
<i>Të menduarit kritik</i>	Aftësi e lartë e të menduarit kritik në situata komplekse si: njohja me informacione relevante, zgjidhja e problemeve, duke zbatuar parimet dhe ushtrimet e interpretueshme.	Aftësi e të menduarit kritik në situata komplekse, si: njohja me informacione relevante, zgjidhja e problemeve duke zbatuar parimet dhe ushtrimet e interpretueshme.	Aftësi e kufizuar e të menduarit kritik në situata komplekse: njohja me informacione relevante, zgjedhja e problemeve, duke zbatuar parimet dhe ushtrimet e interpretueshme.		
<i>Shkathësitë manovruese</i>	Shkallë e kënaqshme e përfitimit në shkathësitë manovruese.			Shkallë e ulët e përfitimit (disa) në shkathësitë manovruese.	

IV. UDHËZIME METODOLOGJIKE

Përzgjedhja e metodave mësimore është në kompetencë të mësimitdhënësit të lëndës. Ajo bëhet në përshtatje me nevojat dhe me kërkesat e nxënësve, me veçoritë e përmbajtjes së temave mësimore, me bazën didaktike, me nivelin e formimit të nxënësve etj.

Metodat dhe teknikat e punës me nxënës duhet kombinuar, të jenë sa më të larmishme, ngase nxitin dinamikën e orës, thyejnë monotoninë dhe motivojnë nxënësit për mësim.

Metodat dhe teknikat e mësimitdhënies janë po aq të larmishme sa edhe vetë llojet e mësimitnxënies. Mësimitdhënësi mund të përdorë disa teknika dhe metoda mësimore të kombinuara për të arritur rezultate sa më të larta gjatë procesit mësimor.

Duke synuar përmbushjen e kërkesave për nxënie cilësore sugjeronen disa metoda dhe teknika të ndryshme:

- shpjegimi dhe sqarimi;
- të shprehurit me gojë;
- të shprehurit me shkrim;
- të mësuarit problemor;
- diskutimi (debati);
- puna në grupe;
- demonstrimi dhe interpretimi;
- teknika e të menduarit kritik;
- shtrim idesh (brainstorming);
- vetëhulumtimi (kërkimi).

Për tema të caktuara që karakterizohen me informacione të bollshme gjen zbatim edhe ligjërata ndërvepruese e kombinuar me veprimtari praktike.

Për tema mësimore të caktuara mund të shfrytëzohen me sukses mësimi në natyrë, eskursionë të ndryshme studimore, vizitat institucioneve të ndryshme etj.

Në të gjitha rastet zbatimi i metodave apo i teknikave mësimore të lartpërmendura duhet të shoqërohet me përdorimin e materialeve dhe të mjeteve përkatëse didaktike, pa të cilat nuk mund të arrihen rezultatet e pritura.

V. BURIMET DHE MJETET MËSIMORE

Që të realizohet mësimdhënia dhe mësimnxënia efektive e këtij plani dhe programi, mësimdhënësit dhe nxënësit duhet të shfrytëzojnë burime dhe mjete të ndryshme informimi. Deri tash burim kryesor informimi ishte teksti shkollor i lëndës përkatëse.

Krahas teksteve të ndryshme shkollore sugjerojmë të përdoren edhe materiale të tjera informimi:

- doracakë, atlase, broshura;
- gazeta, revista profesionale dhe shkencore;
- fotografi, posterë, afishe, skema, diagrame, harta, tabela;
- modele, figura, makete;
- fotoslajde, filma, videokaseta;
- programe të kompjuterëve, interneti, CD-të etj.

Është në kompetencën e mësimdhënësit që, varësisht nga kushtet në të cilat punon shkolla, të zgjedhë burimin e informacionit dhe mjetet ndihmëse mësimore, duke i kushtuar vëmendje baraspeshës së të dhënave gojore, vizuale, auditive dhe audiovizuale, me theks të veçantë në atë që është qenësore për t'u mësuar.

Kjo liri e të zgjedhurit të burimeve mësimore duhet t'i takojë edhe nxënësit.

GJUHË SHQIPE

3

HYRJE

Lënda mësimore *Gjuhë shqipe* për klasën e tretë të shkollës fillore-për nxënësit e komuniteteve joshqiptare të Kosovës, përfshihet në lëmin *Gjuhët dhe komunikimi* dhe ka rëndësi të madhe për komunikimin me gojë dhe me shkrim të nxënësve dhe për formimin kulturor të tyre. Mësimi i shqipes në këtë klasë synon të zhvillojë dijet dhe shkathtësitë për komunikim, të sigurojë mundësi për komunikim, për bashkëpunim dhe për qëllime dhe veprimtari të tjera shumë të dobishme.

Gjatë hartimit të këtij programi mësimor janë marrë parasysh nivelet e përcaktuara në “*Kornizën e përbashkët evropiane të raportit mbi gjuhët*”, të miratuar dhe të publikuar nga Këshilli i Evropës (2001), kërkesat dhe kushtet e shkollimit të nxënësve dhe disa programe mësimore për gjuhën e dytë.

Programi mësimor i *Gjuhës shqipe* përfshin: Të dëgjuarit dhe të folurit, Të lexuarit dhe Të shkruarit.

Përmbajtjet e programit janë të përshtatshme dhe u përgjigjen moshës dhe nivelit të nxënësve. Ecuria e mbarështrimit të lëndës dhe metodologjia e mësimdhënies në tërësi zgjon interesimin e tyre për të përvetësuar gjuhën shqipe. Nxënësit aftësohen për të përdorur forma të ndryshme të komunikimit, të flasin, të lexojnë dhe të shkruajnë, të pyesin dhe të përgjigjen rrjedhshëm me gojë dhe me shkrim dhe të komunikojnë lehtë.

QËLLIMI

Qëllimi i mësimimit të Gjuhës shqipe në klasën e tretë- për nxënësit e komuniteteve joshqiptare është përvetësimi i shkathtësive të komunikimit në gjuhën shqipe. Të aftësohen nxënësit për zhvillimin e të folurit, për zhvillimin e të dëgjuarit, për përvetësimin e leximit dhe të shkrimit të

gjuhës standarde shqipe. Qëllimi i kësaj lënde mësimore është formimi i shprehisë së komunikimit, të bashkëveprimit, përforcimi dhe zhvillimi i njohurive të përvetësuara më parë në arsimin parafillor dhe në dy klasat e para të arsimit fillor dhe përvetësimi i njohurive dhe i shkathtësive të reja.

- Nxënësit të kuptojnë dhe të përdorin fjalë dhe shprehje nga jeta e përditshme, nga jeta shkollë, nga aktivitetet e tjera kulturore dhe shoqërore. Të aftësohen të përdorin shprehje të llojllojshme, me të cilat begatojnë komunikimin e duhur për plotësimin e nevojave konkrete dhe për formimin kulturor;
- Nxënësit të aftësohen për të komunikuar me gojë dhe me shkrim në shkollë, jashtë shkollës dhe në aktivitete të tjera;
- Përjetimi artistik i krijimeve të zgjedhura letrare dhe artistike;
- Nxënësit të inkurajohen të marrin pjesë në lojë, në biseda dhe në aktivitete arsimore, kulturore dhe shoqërore;
- Të njohin gjuhën shqipe, të mësojnë veçoritë e saj, të pasurojnë fjalorin;
- Programi mësimor, duke marrë parasysh moshën dhe nivelin e nxënësve, përfshin përmbajtje të pasura e interesante dhe udhëzime adekuate metodologjike, për të ndihmuar nxënësit për mësimin e gjuhës shqipe;
- Realizimi i objektivave të përgjithshëm dhe specifikë, që parashihen për mësimin e gjuhës shqipe si lëndë mësimore për komunitetet joshqiptare, nxit bashkëpunimin e mirë midis nxënësve, mirësjelljen dhe shoqërimin, respektimin e gjuhës shqipe dhe të gjuhëve të tjera, motivon fëmijët për ta përvetësuar gjuhën shqipe.

OBJEKTIVAT E PËRGJITHSHËM

Nxënësit duhet të jenë në gjendje:

Të përvetësojnë

shqiptimin e tingujve dhe alfabetin e gjuhës shqipe;
shkathtësit e komunikimit
fjalë e shprehje gjuhësore

Të zhvillojnë

kulturën gjuhësore që i përgjigjet moshës dhe nivelit të tyre

Të kuptojnë

Fjalët, fjalitë, tekstet e lexuar dhe të shkruara dhe të pasurojnë fjalorin;

Të identifikojnë

Tekste të ndryshme dhe elemente gjuhësore;

Të zbatojnë

Njohuritë e fituara gjuhësore për komunikim me gojë dhe me shkrim

Njohuritë e fituara mbi modelet e teksteve letrare dhe joletrare për fëmijë

Të analizojnë

Fjalë dhe fjali të thjeshta dhe fjali të përbëra
Tekste të shkurtra për fëmijë

Të formojnë qëndrim kritik dhe të vlerësojnë vlerat

Të zhvillojnë aftësitë për vlerësim kritik
Të fitojnë shprehje të leximit dhe edukatë qytetare

KATEGORIA

I. TË DËGJUARIT DHE TË FOLURIT

Nënkategoritë:

- I. 1 Kulturë e të dëgjuarit dhe të folurit
- I. 2 Tekste letrare dhe joletrare
- I. 3 Njohuri gjuhësore

KATEGORIA

II. TË LEXUARIT

Nënkategoritë:

- II. 1 Kulturë e të lexuarit
- II. 2 Tekste letrare dhe joletrare
- II. 3 Njohuri gjuhësore

KATEGORIA

III. TË SHKRUARIT

Nënkategoritë:

- III. 1 Kulturë e të shkruarit
- III. 2 Tekste letrare dhe joletrare
- III. 3 Njohuri gjuhësore

Vërejtje: Përmbajtjet e programit mësimor realizohen në funksion të tri kategorive kryesore:

I.1, I.2, I.3. Kulturë e të dëgjuarit dhe të folurit, Kulturë e të lexuarit, Kulturë e të shkruarit 40 orë

I.2, II.2, III.2 Tekste letrare dhe joletrare 20 orë

I.3, II.3, III.3 Njohuri gjuhësore 10 orë

Në dispozicion 4 orë

PROGRAMI NË FORMË TABELARE

Nënkategoritë: I.1, II.1 III.1	Përmbajtja	Rezultatet e pritshme
* Kulturë e të dëgjuarit dhe të folurit * Kulturë e të lexuarit * Kulturë e të shkruarit	Përshëndetjet Prezantimi Familja ime Shtëpia ime Klasa ime Shkolla jonë Ditët e javës Kënga „Zilja e shkollës” Lodrat Emra të sendeve Në teatrin e kukullave Objektet që na rrethojnë Dukuritë e natyrës Rrugët dhe sheshet Përmendoret Njeriu-pjesët e trupit Mëngjesi -përgatitja për në shkollë Çanta ime Kafshët shtëpiake Kafshët e egra	Nxënësit prezantohen pa vështirësi dhe përshëndesin Tregojnë anëtarët e familjes Përshkruajnë shtëpinë Flasin për familjen dhe për shkollën Përshkruajnë klasën Flasin shqip Përvetësojnë fjalë të reja Këndojnë këngën “Zilja e shkollës” Mësojnë emrat e lodrave Mësojnë emrat e objekteve që na rrethojnë Njohin emrat e vendbanimeve Njohin ditët e javës Njohin pjesët e trupit të njeriut

	<p>Pemët dhe perimet Kënga: “Alfabeti” Festat Kënga e ditëlindjes Në qytet Shoku im, shoqja ime Ushtrime leximi (Tekste të zgjedhura) Përralla: “Kësulëkuqja” Ngjyrat Numrat themelorë dhe rreshtorë (deri në 100) Veprimet matematikore Vjersha: “Shifrat lavdëraçe” Lexim i gazetës për fëmijë (Tekst i zgjedhur) Orientimi në natyrë (djathtas, majtas, lart, poshtë...) Krahasimi: më i madh-më i vogël, më i gjatë, më i shkurtër Mjetet e punës në kuzhinë Stinët e vitit Këngë: “Mirë se vjen o Viti i Ri” Flasim në telefon Sportet-unë në lojë Kënga: “Topi” Kur të rritem do të bëhem (profesionet) Automjetet (Automjeti im i adhuruar-përshkrim) Bisedë për shëtitjen dhe për lojën në natyrë Këndojmë (Këngë e zgjedhur) Emisioni i radios dhe i televizionit për fëmijë Ushqimi Veshmbathja Dialogu (Tekst i zgjedhur) Pushimet verore</p>	<p>Tregojnë lirshëm si përgatiten për të shkuar në shkollë Tregojnë për gjërat në çantë Tregojnë cila janë kafshët shtëpiake dhe kafshët e egra Flasin dhe shkruajnë për bimët, pemët dhe perimet Recitojnë vjershën e mësuar Këndojnë këngën: “Alfabeti” E përvetësojnë alfabetin Flasin për festat .Këndojnë këngën e ditëlindjes Përshkruajnë shokun dhe shoqen e vet Tregojnë përrallën “Kësulëkuqja” Njohin ngjyrat themelore Mësojnë numrat (deri në 100) dhe veprimet matematikore. Këndojnë këngën: “Shifrat lavdëraçe” Lexojnë gazetën për fëmijë Kuptojnë dhe flasin fjalët djathtas, majtas, lart, poshtë.. Njohin shkallët e mbiemrit: i vogël, më i vogël, shumë më i vogël, më i madh, më i gjatë, më i shkurtër etj. Njohin mjetet e punës në kuzhinë Flasin për stinët e vitit Shkruajnë urime dhe këndojnë këngën “Mirë se vjen Viti Ri” Shruajnë dikttime Flasin mirë në telefon Flasin për sportet e</p>
--	---	--

	<p>Ushtrime të komunikimit Loja me role (Dramatizim) Ushtrime recitimi (Tekst i zgjedhur) Dëgjimi i incizime</p>	<p>adhuruara Këndojnë këngën: “Topi” Flasin për profesionet Tregojnë përrallën e mësuar Lexojnë gazetat për fëmijë Komunikojnë për sportet Hartim me temë të lirë Mësojnë emërtimet për gjërat ushqimore Flasin për veshmbathjen Zhvillojnë dialogë Flasin për pushime verore</p>
Nënkategoritë: I.2, II.2 III.3	Përmbajtja	Rezultatet e pritshme
*Tekste letrare dhe joletrare	<p>Poezi, tregime, përralla, pjesë dramatike Krijime popullore: këngë, valle, fabula, fjalë të urta Artikuj nga gazetat dhe revistat për fëmijë Botime të ilustruara për fëmijë</p>	<p>Lexojnë tekste letrare dhe joletrare dhe komunikojnë Shkurtimisht flasin dhe shkruajnë për përmbajtjen e teksteve të lexuara Bisedojnë për personazhet e letërsisë për fëmijë Recitojnë dhe bëjnë dramatizime</p>
Nënkategoritë: I.3, II.3, III.3	Përmbajtja	Rezultatet e pritshme
*Njohuri gjuhësore	<p>Alfabeti i gjuhës shqipe Fjala, rrokja, tingujt Zanoret dhe bashkëtingëlloret Fjalë pohore dhe mohore Vendi i fjalëve në fjali Krahasimi: të folurit e përditshëm dhe krijimi letrar Emri; llojet e emrave. Tingujt: ë, y, r, rr, x, xh, l, ll, t, th, dh, s, sh, z, zh (krahasimi dhe dallimi i tyre) Shenjat e pikësimit Diktimi dhe format e tjera të shprehjes me gojë e me</p>	<p>Përvetësojnë alfabetin Duke dëgjuar tekste të incizuara dallojnë gjuhën e të folurit të përditshëm dhe të folurit e gjuhës standarde Përvetësojnë drejtshkrimin dhe drejtshqiptimin e nivelit fillestar të gjuhës shqipe Përvetësojnë të folurit, leximin dhe shkrimin e gjuhës shqipe të nivelit të parë Përvetësojnë shqiptimin dhe shkrimin e tingujve Në shkrimet e tyre përdorin shenjat e pikësimit</p>

	shkrim Ushtrime leximi dhe shkrimi	Njohin gjymtyrët e fjalisë Flasin, shkruajnë dhe korrigjojnë gabimet Aftësohen të komunikojnë, të flasin dhe të shkruajnë
--	--	---

Nga përmbajtjet mësimore arsimtarët zgjedhin temat adekuate dhe i përshtatin në kuadër të nënkategorive të caktuara sipas planit mësimor. Arsimtarët mund të zgjedhin edhe përmbajtje të tjera nga libri i leximit, nga gazetatat dhe nga revistat për fëmijë.

Njësitë mësimore realizohen sipas planit dhe programit mësimor, varësisht nga numri i përgjithshëm i orëve mësimore. Parashihen orët për njësitë e reja mësimore dhe ato për përsëritje dhe përforcim të lëndës së mësuar më parë.

METODOLOGJIA

Për të realizuar me sukses programin e lëndës Gjuhë shqipe për nxënësit e komuniteteve joshqiptare në klasën e tretë fillore kërkohet zbatimi i metodologjisë bashkëkohore të mësimdhënies së gjuhëve, i metodave dhe i teknikave mësimore dhe i mjeteve të konkretizimit. Metodika e mësimit të gjuhës amtare, metodika e përvetësimit të gjuhëve të huaja dhe metodologjia e mësimdhënies në tërësi, përfshijnë udhëzime interesante dhe të dobishme për këtë veprimtari arsimore. Komunikimi të zhvillohet në plan më të gjerë: bashkëbisedimi, dëgjimi i realizimeve programore audiovizuale me tematikë dhe me përmbajtje që lidhet me mësimin e gjuhës shqipe, por edhe me lëndë të tjera, të shprehurit me gojë dhe me shkrim, puna në grupe, në çifte, debatet, testet, intervistat, letërkëmbimi, lojërat me role, lojërat skenike (dramatizimi), ushtrime leximi dhe shkrimi, lojëra mësimi, pyetësi, fleta kontrolluese dhe forma të tjera të komunikimit me gojë dhe me shkrim.

Parimet kryesore metodologjike të mësimit të gjuhës shqipe janë:

- Përqendrimi në komunikim;
- Përqendrimi në gjuhën e gramatizuar;
- Përqendrimi në nxënësin dhe në të nxënësit e tij;

Roli i mësimdhënësit është i pazëvendësueshëm. Ai duhet të njohë dhe të zbatojë metodat dhe teknikat bashkëkohore të mësimdhënies.

Ai duhet të njohë mirë nxënësit, përgatitjen dhe aftësitë e tyre, prirjet për mësimin e gjuhës. Nxënësi duhet të jetë në qendër të vëmendjes.

Mjetet mësimore: libri, fletorja e punës, fotografitë, kasetat disqet, ilustrimet, videoprojektori, materiali auditiv, videomateriali dhe mjetet e tjera të konkretizimit. Mësimdhënësi, varësisht nga njësia mësimore dhe nga qëllimet e mësimin, zgjedh mjete mësimore, me të cilat e konkretizon mësimin, nxit aktivitetin e nxënësve dhe siguron cilësinë më të lartë të realizimit të mësimin praktik.

VLERËSIMI

Vlerësimi i punës me nxënësit dhe i suksesit në mësim ka rëndësi të madhe. Mësimdhënësi në vazhdimësi duhet të vlerësojë:

- * Njohuritë që kanë fituar nxënësit: në ç`shkallë kanë zotëruar fjalorin dhe sa është i aftë nxënësi t`i përdorë shkathtësitë gjuhësore gjatë komunikimit
- * Angazhimin e nxënësve në procesin e mësimin
- * Përvetësimin e njohurive nga nxënësit e klasës së tretë (niveli i parë, niveli i dytë dhe niveli i tretë)
- * Suksesi i kënaqshëm, i arritur me të gjithë nxënësit e klasës, por edhe me secilin nxënë.
- * Ecuritë e volitshme, por edhe ato të pavolitshme të mësimin, identifikohen vështirësitë, pengesat, shqyrtohen problemet e veçanta të mësimdhënies, të përdorimit të mjeteve të konkretizimit etj., dhe ndërmerren masa për përmirësimin i nivelit të mësimin të gjuhës shqipe, që nxënësit të flasin, të lexojnë dhe të shkruajnë lirshëm dhe të arrijnë sukses sa më të mirë në mësim dhe në komunikim të përditshëm në shkollë dhe në ambiente të tjera.
- * Mësimdhënësi vlerëson drejtshqiptimin e tingujve dhe të fjalëve, leximin dhe shkrimin e teksteve, fjalorin e nxënësve dhe në tërësi vlerëson shkathtësinë e komunikimit. Po ashtu vlerëson edhe shkallën e përvetësimit të njohurive të tjera plotësuese, që lidhen me programin e kësaj lënde mësimore.
- * Me vlerësimin e gjithanshëm dhe të vazhdueshëm mësimdhënësi synon të përmirësojë nivelin e mësimin. Vlerësimi i drejtpërdrejtë bëhet gjatë zhvillimit të orëve të mësimin dhe sidomos gjatë përforsimit të njësive mësimore, ndërsa vlerësimi indirekt bëhet me

anë të ushtrimeve, të diktimit dhe të formave të tjera të komunikimit.

- * Vlerësimi apo vetëvlerësimi bëhet edhe nga nxënësit. Ata e pyesin njëri tjetrin, përgjigjen dhe bëjnë vlerësimin e njohurive dhe shkallën e aftësisë për komunikim në gjuhën shqipe.
- * Vlerësimi përfshin: leksikun, radhitjen e fjalëve në fjali, të shprehurit me gojë, leximin, të shprehurit me shkrim, aftësinë e komunikimit, pyetjet dhe përgjigjet, shqiptimin e tingujve dhe të fjalëve, komunikimin aktiv, angazhimin individual dhe në grupe gjatë procesit të mësimet etj.

LITERATURA

Plani dhe programi mësimor 3, MASHT, Prishtinë, 2004

Bahri Beci, Gjuha shqipe 2, “Dukagjini”, 2004

Musai, Bardhyl: Metodologjia e mësimdhënies, Tiranë, 2003

Teksti i klasës së tretë që do të hartohet mbi bazë të programit të ri

Tekstet e gjuhës shqipe, dhe të gjuhëve të tjera, që i plotësojnë kërkesat e këtij programi

GJUHË SHQIPE

4

HYRJE

Lënda mësimore *Gjuhë shqipe* për klasën e katërt të shkollës fillore-për nxënësit e komuniteteve joshqiptare të Kosovës, përfshihet në lëmin *Gjuhët dhe komunikimi* dhe ka rëndësi të madhe për komunikimin me gojë dhe me shkrim të nxënësve dhe për formimin kulturor të tyre. Mësimi i shqipes në këtë klasë synon të zhvillojë dijet dhe shkathtësitë për komunikim, të sigurojë mundësi për komunikim, për bashkëpunim dhe për qëllime dhe veprimtari të tjera shumë të dobishme.

Gjatë hartimit të këtij programi mësimor janë marrë parasysh nivelet e përcaktuara në “*Kornizën e përbashkët evropiane të raportit mbi gjuhët*”, të miratuar dhe të publikuar nga Këshilli i Evropës (2001), kërkesat dhe kushtet e shkollimit të nxënësve dhe disa programe mësimore për gjuhën e dytë. Programi mësimor i *Gjuhës shqipe* përfshin: Kulturën e të dëgjuarit dhe të folurit, Kulturën e të lexuarit, Kulturën e të shkruarit, Tekste letrare dhe joletrare dhe Njohuri gjuhësore

Përmbajtjet e programit janë të përshtatshme dhe u përgjigjen moshës dhe nivelit të nxënësve. Ecuria e mbarështrimit të lëndës dhe metodologjia e mësimdhënies në tërësi zgjon interesimin e tyre për të përvetësuar gjuhën shqipe. Nxënësit aftësohen për të përdorur forma të ndryshme të komunikimit, të flasin, të lexojnë dhe të shkruajnë, të pyesin dhe të përgjigjen rrjedhshëm me gojë dhe me shkrim dhe të komunikojnë lehtë.

QËLLIMI

Qëllimi i mëimit të Gjuhës shqipe në klasën e katërt- për nxënësit e komuniteteve joshqiptare është përvetësimi i shkathtësive të komunikimit në gjuhën shqipe. Të aftësohen nxënësit për zhvillimin e të folurit, për zhvillimin e të dëgjuarit, për përvetësimin e leximit dhe të shkrimit të

gjuhës standarde shqipe. Qëllimi i kësaj lënde mësimore është formimi i shprehisë së komunikimit, të bashkëveprimit, përforcimi dhe zhvillimi i njohurive të përvetësuara më parë në klasën e tretë të fillor dhe përvetësimi i njohurive dhe i shkathhtësive të reja.

- Nxënësit të kuptojnë dhe të përdorin fjalë dhe shprehje nga jeta e përditshme, nga jeta shkollë, nga aktivitetet e tjera kulturore dhe shoqërore. Të aftësohen të përdorin shprehje të llojllojshme, me të cilat begatojnë komunikimin e duhur për plotësimin e nevojave konkrete dhe për formimin kulturor;
 - Nxënësit të aftësohen për të komunikuar me gojë dhe me shkrim në shkollë, jashtë shkollës dhe në aktivitete të tjera;
 - Përjetimi artistik i krijimeve të zgjedhura letrare dhe artistike;
- Nxënësit të inkurajohen të marrin pjesë në lojë, në biseda dhe në aktivitete arsimore, kulturore dhe shoqërore;
- Të njohin gjuhën shqipe, të mësojnë veçoritë e saj, të pasurojnë fjalorin;
 - Programi mësimor, duke marrë parasysh moshën dhe nivelin e nxënësve, përfshin përmbajtje të pasura e interesante dhe udhëzime adekuate metodologjike, për të ndihmuar nxënësit për mësimin e gjuhës shqipe;
 - Realizimi i objektivave të përgjithshëm dhe specifikë, që parashihen për mësimin e gjuhës shqipe si lëndë mësimore për komunitetet joshqiptare, nxit bashkëpunimin e mirë midis nxënësve, mirësjelljen dhe shoqërimin, respektimin e gjuhës shqipe dhe të gjuhëve të tjera, motivon fëmijët për ta përvetësuar gjuhën shqipe.

OBJEKTIVAT E PËRGJITHSHËM

Nxënësit duhet të jenë në gjendje:

Të zhvillojnë kulturën gjuhësore që i përgjigjet moshës dhe nivelit të tyre

- Të dëgjojnë dhe të mësojnë fjalë e shprehje gjuhësore;
- Të përvetësojnë edhe më mirë shqiptimin e tingujve dhe shkrimin e gjuhës shqipe;
- Të aftësohen të flasin, të shkruajnë dhe të komunikojnë në gjuhën shqipe

Të kuptojnë

- Fjalët, fjalitë, tekstet e lexuar dhe të shkruara dhe të pasurojnë fjalorin;

Të identifikojnë

- Tekste të ndryshme dhe elemente gjuhësore;
- Shkathtësi të komunikimit

Të zbatojnë

- Njohuritë e fituara gjuhësore për komunikim me gojë dhe me shkrim
- Njohuritë e fituara mbi modelet e teksteve letrare dhe joletrare për fëmijë

Të analizojnë

- Fjalë dhe fjali të thjeshta dhe fjali të përbëra
- Tekste të shkurtra për fëmijë

Të formojnë qëndrim kritik dhe të vlerësojnë vlerat

- Të zhvillojnë aftësitë për vlerësim kritik
- Të përvetësojnë shkathtësitë e komunikimit
- Të fitojnë shprehje të leximit dhe edukatë qytetare

KATEGORIA

I. TË DËGJUARIT DHE TË FOLURIT

Nënkategoritë:

- I. 1 Kulturë e të dëgjuarit dhe të folurit
- I. 2 Tekste letrare dhe joletrare
- I. 3 Njohuri gjuhësore

KATEGORIA

II. TË LEXUARIT

Nënkategoritë:

- II. 1 Kulturë e të lexuarit
- II. 2 Tekste letrare dhe joletrare
- II. 3 Njohuri gjuhësore

KATEGORIA

III. TË SHKRUARIT

Nënkategoritë:

- III. 1 Kulturë e të shkruarit
- III. 2 Tekste letrare dhe joletrare
- III. 3 Njohuri gjuhësore

Vërejtje: Përmbajtjet e programit mësimor realizohen në funksion të tri kategorive kryesore:

- I.1, I.2, I.3. Kulturë e të dëgjuarit dhe të folurit, Kulturë e të lexuarit, Kulturë e të shkruarit 40 orë
- I.2, II.2, III.2 Tekste letrare dhe joletrare 20 orë
- I.3, II.3, III.3 Njohuri gjuhësore 10 orë
- Në dispozicion 4 orë

PROGRAMI NË FORMË TABELARE

Nënkategoritë: I.1, II.1 III.1	Përmbajtja	Rezultatet e pritshme
* Kulturë e të dëgjuarit dhe të folurit * Kulturë e të lexuarit * Kulturë e të shkruarit	Mësojmë gjuhën shqipe Bashkëbisedimi Përshëndetjet Urimet, falënderimet, njoftimet Dëgjojmë, flasim, lexojmë, shkruajmë, këndojmë, bisedojmë, pyesim, përgjigjemi Orari i mësimit Shprehjet e mirësjelljes Drejtshqiptimi dhe drejtshkrimi i shqipes:	Nxënësit fitojnë kulturë komunikimi Aftësohen të bashkëbisedojnë Mësojnë fjalët për të përshëndetur dhe për të uruar Kuptojnë brendinë e teksteve Flasin, lexojnë dhe shkruajnë Bisedojnë për orarin, për

	<p>zanoret, bashkëtingëlloret, rrokjet, fjalët, fjalitë Ushtrime të leximit dhe të shkrimit Harta e Kosovës Fjalë të urta shqipe Ggjëegjëza Në bibliotekën e shkollës, në bibliotekën e qytetit Në librari Vjersha: “Puna” Komunikacioni Diktim (Tekst i zgjedhur) Ushtrime të folurit (tekste të zgjedhura) Hartim me temë të lirë Këngë e zgjedhur për fëmijë Njeriu ka krijuar çudira(mjetet audiovizuale, filmi, kompjuteri) Letra ime e parë Moti Emisioni i radios dhe i televizionit për fëmijë Dialogu (tekste të zgjedhura) Krahasimi i të folmeve të gjuhës shqipe Higjiena personale (bashkëbisedim) Ta ruajmë mjedisin Monumentet kulturore E dua vendin tim (Hartim- detyrë e shtëpisë)</p>	<p>lëndët mësimore. Përvetësohen fjalë të reja Përmirësohet drejtshqiptimi i tingujve dhe i fjalëve Aftësohen të shkruajnë dhe e pasurojnë të shprehurit me gojë dhe me shkrim Mësojnë emërtimet gjeografike, të vendbanimeve të rrugëve, të institucioneve kulturore dhe administrative Aftësohen të komunikojnë Fitojnë përvojë të re Përvetësojnë fjalë të reja Aftësohen të recitojnë Pasurojnë fjalorin Nxënësit aftësohen të lexojnë dhe të shkruajnë mirë dhe përvetësojnë njohuri të reja Shkruajnë hartim të lirë Bisedojnë për muzikën Mësojnë disa fjalë të reja Shkruajnë letër Bisedojnë lidhur me motin dhe klimën Aftësohen të bisedojnë dhe të paraqesin vlerësimin e tyre Njohin dallimet e të folmeve Bisedojnë për higjienën dhe ruajtjen e mjedisit ku jetojnë Mësojnë disa fjalë dhe shprehje të reja Flasin për monumentet (mësojnë fjalë të reja) Bëjnë hartim të lirë</p>
Nënkategoritë: I.2, II.2 III.3	Përmbajtja	Rezultatet e pritshme
*Tekste letrare dhe joletrare	Poezi, tregime, përralla, tekste dramatike (Fragmente të zgjedhura) Arti popullor	Aftësohen të flasin, të lexojnë dhe të shkruajnë. Njohin një pjesë të krijimtarisë letrare dhe disa

	<p>Krijime letrare: këngë, fabula, fjalë të urta, gjëegjëza</p> <p>Artikuj nga gazetat dhe revistat për fëmijë</p> <p>Tekste të zgjedhura edukative</p> <p>Botime të ilustruara për fëmijë</p>	<p>nga vlerat kulturore.</p> <p>Dallojnë dhe ritregojnë tekstet letrare dhe joletrare</p> <p>Analizojnë personazhet</p> <p>Zgjojnë interesimi për të lexuar edhe gazetat dhe revistat në gjuhën shqipe</p>
<p>Nënkategoritë: I.3, II.3, III.3</p>	<p>Përmbajtja</p>	<p>Rezultatet e pritshme</p>
<p>*Njohuritë gjuhësore</p>	<p>Alfabeti i gjuhës shqipe</p> <p>-ushtrime shqiptimi dhe shkrimi</p> <p>Fjala, fjala, rrokja, tingujt</p> <p>Ndarja e fjalës në fund të rreshtit</p> <p>Formimi i fjalës</p> <p>Fjalori i gjuhës shqipe</p> <p>Fjalor shkollor i gjuhës shqipe</p> <p>Fjala e thjeshtë dhe zgjeruar</p> <p>Shenjat e pikësimit</p> <p>Analiza e fjalisë</p> <p>Formimi i fjalive</p> <p>Llojet e fjalisë</p> <p>Krahasimi i shkrimit të gjuhës shqipe me atë të gjuhës amtare.</p> <p>Emri: gjinia dhe numri i emrave</p> <p>Mbiemri</p> <p>Përemri</p> <p>Folja (kohët themelore të foljes:</p> <p>E kryer, e tashme dhe e ardhme</p> <p>Veprime brenda fjalisë</p> <p>Fjala pohore, mohore, dëftore, pyetëse</p> <p>Fjala e thjeshtë dhe e zgjeruar (Ushtrime)</p> <p>Përdorimi i shkronjës së madhe</p>	<p>Nxënësit përvetësojnë alfabetin, drejtshqiptimin dhe drejtshkrimin e zanoreve dhe të bashkëtingëlloreve</p> <p>Mësojnë kuptimin dhe përdorimin e fjalëve</p> <p>Pasurojnë leksikun dhe aftësohen ta përdorin fjalorin</p> <p>Respektojnë shenjat e pikësimit</p> <p>Njohin mënyrën e formimit të fjalëve dhe të fjalive</p> <p>Plotësojnë tekste të ndryshme në fletoren e ushtrimeve dhe bëjnë korrigjimin e tyre</p> <p>Përdorin trajtat e emrit, të mbiemrit dhe të përemrit në të folur dhe në shkrime</p> <p>Njohin dhe përdorin fjalë e ndryshueshme dhe të pandryshueshme në fjali</p> <p>Njohin dhe dallojnë pjesët përbërëse të fjalës dhe të fjalisë. Dallojnë fjalitë.</p> <p>Aftësohen të shprehin mendimet e tyre dhe të komunikojnë</p>

Nga përmbajtjet mësimore arsimtarët zgjedhin temat adekuate dhe i përshtatin në kuadër të nënkategorive të caktuara sipas planit mësimor. Arsimtarët mund të zgjedhin edhe përmbajtje të tjera nga libri i leximit, nga gazetatat dhe nga revistat për fëmijë.

Njësitë mësimore realizohen sipas planit dhe programit mësimor, varësisht nga numri i përgjithshëm i orëve mësimore. Parashihen orët për njësitë e reja mësimore dhe ato për përsëritje dhe përforcim të lëndës së mësuar më parë.

METODOLOGJIA

Për të realizuar me sukses programin e lëndës Gjuhë shqipe për nxënësit e komuniteteve joshqiptare në klasën e katërt fillore kërkohet zbatimi i metodologjisë bashkëkohore të mësimdhënies së gjuhëve, i metodave dhe i teknikave mësimore dhe i mjeteve të konkretizimit. Metodika e mësimit të gjuhës amtare, metodika e përvetësimit të gjuhëve të huaja dhe metodologjia e mësimdhënies në tërësi, përfshijnë udhëzime interesante dhe të dobishme për këtë veprimtari arsimore. Komunikimi të zhvillohet në plan më të gjerë: bashkëbisedimi, dëgjimi i realizimeve programore audiovizuale me tematikë dhe me përmbajtje që lidhet me mësimin e gjuhës shqipe, por edhe me lëndë të tjera, të shprehurit me gojë dhe me shkrim, puna në grupe, në çifte, debatet, testet, intervistat, letërkëmbimi, lojërat me role, lojërat skenike (dramatizimi), ushtrime leximi dhe shkrimi, lojëra mësimi, pyetësi, fleta kontrolluese dhe forma të tjera të komunikimit me gojë dhe me shkrim.

Parimet kryesore metodologjike të mësimit të gjuhës shqipe janë:

- Përqendrimi në komunikim;
- Përqendrimi në gjuhën e gramatizuar;
- Përqendrimi në nxënësin dhe në të nxënit e tij;

Roli i mësimdhënësit është i pazëvendësueshëm. Ai duhet të njohë dhe të zbatojë metodat dhe teknikat bashkëkohore të mësimdhënies.

Ai duhet të njohë mirë nxënësit, përgatitjen dhe aftësitë e tyre, prirjet për mësimin e gjuhës. Nxënësi duhet të jetë në qendër të vëmendjes.

Mjetet mësimore: libri, fletorja e punës, fotografitë, kasetat disqet, ilustrimet, videoprojektori, materiali auditiv, videomateriali dhe mjetet e tjera të konkretizimit. Mësimdhënësi, varësisht nga njësia mësimore dhe nga qëllimet e mësimit, zgjedh mjete mësimore, me të cilat e konkretizon

mësimin, nxit aktivitetin e nxënësve dhe siguron cilësinë më të lartë të realizimit të mëimit praktik.

VLERËSIMI

Vlerësimi i punës me nxënësit dhe i suksesit në mësim ka rëndësi të madhe. Mësimdhënësi në vazhdimësi duhet të vlerësojë:

- * Njohuritë që kanë fituar nxënësit: në ç`shkallë kanë zotëruar fjalorin dhe sa është i aftë nxënësi t`i përdorë shkathtësitë gjuhësore gjatë komunikimit
- * Angazhimin e nxënësve në procesin e mëimit
- * Përvetësimin e njohurive nga nxënësit e klasës së tretë (niveli i parë, niveli i dytë dhe niveli i tretë)
- * Suksesi i kënaqshëm, i arritur me të gjithë vënësit e klasës, por edhe me secilin nxënës.
- * Ecuritë e volitshme, por edhe ato të pavolitshme të mëimit, identifikohen vështirësitë, pengesat, shqyrtohen problemet e veçanta të mësimdhënies, të përdorimit të mjeteve të konkretizimit etj., dhe ndërmerren masa për përmirësimin i nivelit të mëimit të gjuhës shqipe, që nxënësit të flasin, të lexojnë dhe të shkruajnë lirshëm dhe të arrijnë sukses sa më të mirë në mësim dhe në komunikim të përditshëm në shkollë dhe në ambiente të tjera.
- * Mësimdhënësi vlerëson drejtshqiptimin e tingujve dhe të fjalëve, leximin dhe shkrimin e teksteve, fjalorin e nxënësve dhe në tërësi vlerëson shkathtësinë e komunikimit. Po ashtu vlerëson edhe shkallën e përvetësimit të njohurive të tjera plotësuese, që lidhen me programin e kësaj lënde mësimore.
- * Me vlerësimin e gjithanshëm dhe të vazhdueshëm mësimdhënësi synon të përmirësojë nivelin e mëimit. Vlerësimi i drejtpërdrejtë bëhet gjatë zhvillimit të orëve të mëimit dhe sidomos gjatë përforsimit të njësive mësimore, ndërsa vlerësimi indirekt bëhet me anë të ushtrimeve, të diktimit dhe të formave të tjera të komunikimit.

- * Vlerësimi apo vetëvlerësimi bëhet edhe nga nxënësit. Ata e pyesin njëri tjetrin, përgjigjen dhe bëjnë vlerësimin e njohurive dhe shkallën e aftësisë për komunikim në gjuhën shqipe.
- * Vlerësimi përfshin: leksikun, radhitjen e fjalëve në fjali, të shprehurit me gojë, leximin, të shprehurit me shkrim, aftësinë e komunikimit, pyetjet dhe përgjigjet, shqiptimin e tingujve dhe të fjalëve, komunikimin aktiv, angazhimin individual dhe në grupe gjatë procesit të mësimin etj.

LITERATURA

Plani dhe programi mësimor 3, MASHT, Prishtinë, 2004

Bahri Beci, Gjuha shqipe 2, “Dukagjini”, 2004

Musai, Bardhyl: Metodologjia e mësimdhënies, Tiranë, 2003

Teksti i klasës së katërt që do të hartohet mbi bazë të programit të ri

Tekstet e gjuhës shqipe, dhe të gjuhëve të tjera, që i plotësojnë
kërkesat e këtij programi

GJUHË SHQIPE

5

HYRJE

Lënda mësimore *Gjuhë shqipe* për klasën e pestë të shkollës fillore-për nxënësit e komuniteteve joshqiptare të Kosovës, përfshihet në lëmin *Gjuhët dhe komunikimi* dhe ka rëndësi të madhe për komunikimin me gojë dhe me shkrim të nxënësve dhe për formimin kulturor të tyre. Mësimi i shqipes në këtë klasë synon të zhvillojë dijet dhe shkathtësitë për komunikim, të sigurojë mundësi për komunikim, për bashkëpunim dhe për qëllime dhe veprimtari të tjera shumë të dobishme.

Gjatë hartimit të këtij programi mësimor janë marrë parasysh nivelet e përcaktuara në “*Kornizën e përbashkët evropiane të raportit mbi gjuhët*”, të miratuar dhe të publikuar nga Këshilli i Evropës (2001), kërkesat dhe kushtet e shkollimit të nxënësve dhe disa programe mësimore për gjuhën e dytë.

Programi mësimor i *Gjuhës shqipe* përfshin: Të dëgjuarit dhe të folurit, Të lexuarit, Të shkruarit, Njohuritë gjuhësore dhe Tekstet letrare dhe joletrare.

Përmbajtjet e programit janë të përshtatshme dhe u përgjigjen moshës dhe nivelit të nxënësve. Ecuria e mbarështrimit të lëndës dhe metodologjia e mësimdhënies në tërësi zgjon interesimin e tyre për të përvetësuar gjuhën shqipe. Nxënësit aftësohen për të përdorur forma të ndryshme të komunikimit, të flasin, të lexojnë dhe të shkruajnë, të pyesin dhe të përgjigjen rrjedhshëm me gojë dhe me shkrim dhe të komunikojnë lehtë.

QËLLIMI

Qëllimi i mësimimit të Gjuhës shqipe në klasën e pestë- për nxënësit e komuniteteve joshqiptare është përvetësimi i shkathtësive të komunikimit në gjuhën shqipe. Të aftësohen nxënësit për zhvillimin e të folurit, për

zhvillimin e të dëgjuarit, për përvetësimin e leximit dhe të shkrimit të gjuhës standarde shqipe. Qëllimi i kësaj lënde mësimore është formimi i shprehisë së komunikimit, të bashkëveprimit, përforcimi dhe zhvillimi i njohurive të përvetësuara më parë në klasën e katërt të arsimit fillor dhe përvetësimi i njohurive dhe i shkathtësive të reja.

- Nxënësit të kuptojnë dhe të përdorin fjalë dhe shprehje nga jeta e përditshme, nga jeta shkollore, nga aktivitetet e tjera kulturore dhe shoqërore. Të aftësohen të përdorin shprehje të llojllojshme, me të cilat begatojnë komunikimin e duhur për plotësimin e nevojave konkrete dhe për formimin kulturor;
- Nxënësit të aftësohen për të komunikuar me gojë dhe me shkrim në shkollë, jashtë shkollës dhe në aktivitete të tjera;
- Përjetimi artistik i krijimeve të zgjedhura letrare dhe artistike;
- Nxënësit të inkurajohen të marrin pjesë në lojë, në biseda dhe në aktivitete arsimore, kulturore dhe shoqërore;
- Të njohin gjuhën shqipe, të mësojnë veçoritë e saj, të pasurojnë fjalorin;
- Programi mësimor, duke marrë parasysh moshën dhe nivelin e nxënësve, përfshin përmbajtje të pasura e interesante dhe udhëzime adekuate metodologjike, për të ndihmuar nxënësit për mësimin e gjuhës shqipe;
- Realizimi i objektivave të përgjithshëm dhe specifikë, që parashihen për mësimin e gjuhës shqipe si lëndë mësimore për komunitetet joshqiptare, nxit bashkëpunimin e mirë midis nxënësve, mirësjelljen dhe shoqërimin, respektimin e gjuhës shqipe dhe të gjuhëve të tjera, motivon fëmijët për ta përvetësuar gjuhën shqipe.

OBJEKTIVAT E PËRGJITHSHËM

Nxënësit duhet të jenë në gjendje:

Të zhvillojnë kulturën gjuhësore që i përgjigjet moshës dhe nivelit të tyre

- Të dëgjojnë dhe të mësojnë fjalë e shprehje gjuhësore;
- Të flasin, të shkruajnë dhe të komunikojnë në gjuhën shqipe

Të kuptojnë

- Fjalët, fjalitë, tekstet e lexuar dhe të shkruara dhe të pasurojnë fjalorin;

Të identifikojnë

- Tekste të ndryshme dhe elemente gjuhësore;
- Shkathtësi të komunikimit

Të zbatojnë

- Njohuritë e fituara gjuhësore për komunikim me gojë dhe me shkrim
- Njohuritë e fituara mbi modelet e teksteve letrare dhe joletrare për fëmijë

Të analizojnë

- Fjalë dhe fjali të thjeshta dhe fjali të përbëra
- Tekste të shkurtra për fëmijë

Të formojnë qëndrim kritik dhe të vlerësojnë vlerat

- Të zhvillojnë aftësitë për vlerësim kritik
- Të përvetësojnë shkathtësitë e komunikimit
- Të fitojnë shprehi të leximit dhe edukatë qytetare

KATEGORIA

I. TË DËGJUARIT DHE TË FOLURIT

Nënkategoritë:

- I. 1 Kulturë e të dëgjuarit dhe të folurit
- I. 2 Tekste letrare dhe joletrare
- I. 3 Njohuri gjuhësore

KATEGORIA

II. TË LEXUARIT

Nënkategoritë:

- II. 1 Kulturë e të lexuarit
- II. 2 Tekste letrare dhe joletrare
- II. 3 Njohuri gjuhësore

KATEGORIA

III. TË SHKRUARIT

Nënkategoritë:

- III. 1 Kulturë e të shkruarit
- III. 2 Tekste letrare dhe joletrare
- III. 3 Njohuri gjuhësore

Vërejtje: Përmbajtjet e programit mësimor realizohen në funksion të tri kategorive kryesore:

- I.1, I.2, I.3. Kulturë e të dëgjuarit dhe të folurit, Kulturë e të lexuarit, Kulturë e të shkruarit 40 orë
- I.2, II.2, III.2 Tekste letrare dhe joletrare 20 orë
- I.3, II.3, III.3 Njohuri gjuhësore 10 orë
- Në dispozicion 4 orë

PROGRAMI NË FORMË TABELARE

Nënkategoritë: I.1, II.1 III.1	Përmbajtja	Rezultatet e pritshme
* Kulturë e të dëgjuarit dhe të folurit * Kulturë e të lexuarit * Kulturë e të shkruarit	Komunikimi në gjuhën shqipe(Bashkëbisedim) Natyra Dëgjimi i incizimeve (Zgjedhje e lirë) Recitim (Poezia “ Vendi im” dhe “Gjuha shqipe”) Drejtshqiptimi i tingujve (Vallja e shkronjave)	Nxënësit aftësohen të komunikojnë me të tjerët Përvetësojnë fjalë dhe shprehje që lidhen me temën “Natyra” Kuptojnë përmbajtjen e incizimit dhe aftësohen të recitojnë bukur Përvetësojnë

	<p>Dallimi i rrokjeve dhe ndarja e fjalës në rrokje Diftongjet Fjala (Kuptimi dhe përdorimi i tyre. Loja e fjalëve) Formimi i fjalive të ndryshme (komunikimi në situata të ndryshme: në klasë, në fushën e sportit Rrëfimi i përrallës (Kuptimi i përmbajtjes dhe ritregimi) Bisedojmë për filmat e shikuar Shikohet filmi i zgjedhur për fëmijë (Diskutimi për filmin) Një ëndërr, një dëshirë... Komentimi i përjetimeve Përvoja ime e mësimit të gjuhës Çka mësova në klasën IV Si e mësojmë Gjuhën shqipe në klasë e pestë Flas shqip më mirë. Kam mësuar të lexoj më mirë Ushtrime leximi (Tekste të zgjedhura letrare dhe jo letrare) Përshkruaj një tekst dhe komentoj brendinë(tekste të zgjedhura letrare dhe joletrare) Dëshiroj të shkruaj edhe më mirë Pasurimi i fjalorit me fjalë të reja Kuptimi i fjalëve të panjohura Kuptimi i përmbajtjes së fjalive Përmbajtja e tekstit dhe komentimi me gojë dhe me shkrim</p>	<p>drejtshqiptimin e tingujve Bëjnë ndarjen e fjalëve në rrokje sipas drejtshkrimit Të shqiptojnë diftongjet Kuptojnë fjalët dhe shprehjet e ndryshme Aftësohen të formojnë fjali dhe të komunikojnë kur gjenden në situata të ndryshme Aftësohen të rrëfejnë dhe të ritregojnë përrallën Analizojnë filmin dhe diskutojnë për aspektet kryesore të realizimit filmik Rrëfejnë ëndrrën dhe paraqesin dëshirat e tyre Vlerësojnë arritjet e veta të mësimit të gjuhës shqipe Flasin për ecurinë dhe nivelin e mësimit të shqipes në klasën e pestë (Paraqesin sidomos vështirësitë gjatë mësimit) Ushtrojnë leximin e pavarur dhe të lirë Aftësohen të përshkruajnë vetë dhe të komentojnë brendinë e tekstit Shprehin dëshirën dhe gatishmërinë për ta mësuar edhe mirë gjuhën shqipe Mësojnë kuptimin e fjalëve të panjohura Kuptojnë përmbajtjen e fjalive dhe të teksteve Aftësohen të bëjnë komente</p>
--	---	---

Nënkategoritë: I.2, II.2 III.3	Përmbajtja	Rezultatet e pritshme
*Tekste letrare dhe joletrare	Poezi, tregime, përralla, pjesë dramatike Krijime popullore: këngë, valle, fabula, fjalë të urta Artikuj nga gazetatat dhe revistat për fëmijë Botime të ilustruara për fëmijë Njohja e përmbajtjes së tregimit Tema e trajtuar Rrëfimi letrar Personazhet letrare (Analizë) Gjuha e krijimit artistik Romani për fëmijë (Lexim i romaneve të zgjedhura për fëmijë në gjuhën shqipe dhe në gjuhët e tjera (Bashkëbisedim lidhur me romanet e lexuara) Fëmijët shikojnë së bashku pjesën teatrale (Bisedë për Teatrin dhe për pjesën teatrale	Lexojnë tekste letrare dhe joletrare dhe komunikojnë Shkurtimisht flasin dhe shkruajnë për përmbajtjen e teksteve të lexuara Bisedojnë për personazhet e letërsisë për fëmijë Recitojnë dhe bëjnë dramatizime Lexojnë me interesim tekstet e zgjedhura letrare dhe joletrare Njohin përmbajtjen e tregimeve për fëmijë Analizojnë personazhet Bisedojnë për gjuhën e përdorur Diskutojnë për vlerën artistike të romaneve të lexuara Njohin dallimet gjuhësore të romaneve në gjuhën shqipe dhe në gjuhën amtare Aftësohen të bëjnë vlerësimin e tyre për veprën dramatike të shikuar në Teatër
Nënkategoritë: I.3, II.3, III.3	Përmbajtja	Rezultatet e pritshme
*Njohuri gjuhësore	Pasurimi i fjalorit me fjalë të reja Fjalë të thjeshta dhe fjalë jo të thjeshta Rrënja, parashtesa dhe prapashtesa e fjalës Numri i emrit (Përforcim) Akordimi i fjalëve në fjali Flasin dhe hartojmë një tekst Shprehim mendimet tona Të argumentojmë propozimet tona Të	Nxënësit përvetësojnë fjalë të reja Dallojnë fjalët e thjeshta dhe fjalët jo të thjeshta dhe mësojnë përdorimin e tyre Dallojnë pjesët përbërëse të fjalës dhe funksionin e tyre Përdorin saktësisht emrin

	<p>plotësojmë formularë të administratës shkollore për klasën e pestë Të shkruajmë kërkesa të ndryshme personale Të shkruajmë njoftim për organizimin e orës letrare Formimi i fjalive dhe hartimi i tekstit të veçantë Renditja e fjalëve në fjali të ndryshme dhe në periudhë</p>	<p>në njëjës dhe në shumës Përvetësojmë akordimin e fjalëve në fjali Aftësohen të flasin dhe të hartojnë tekste të ndryshme Aftësohen të shprehin mendimet e tyre Argumentojnë propozimet Aftësohen të plotësojnë formularët Mësojnë të shkruajnë kërkesë Formojnë fjali dhe hartojnë tekst të veçantë Bëjnë renditjen adekuate të fjalëve në fjali dhe në periudhë Aftësohen të flasin, të lexojnë dhe të shkruajnë shqip</p>
--	---	--

Përmbajtja

Fjalë të urta shqipe
E bukura e dheut (Përrallë popullore, Fragment)
Gjëegjëza (Zgjedhje)
Ismail Kadare: “Princesha Argjiro” (Fragment)
Naim Frashëri: “Gjuha shqipe”
Në Muzeun Etnografik
Gëte: “Lulja e pyllit”
Sami Frashëri: “Dheu është flori”
Në ekspozitën e arteve figurative
Faik Konica: “E bija e mbretit dhe trëndafilat”
Dritëro Agolli: “Harabeli”
Biblioteka për fëmijë “Hivzi Sulejmani”
Odhise Grillo: “Fjala është e vogël shumë”
Vehbi Kikaj “Sarajet e bardha” (Fragment)
Në Pallatin e Rinisë
Agim Deva: “Dy duar, tre fëmijë”

Rifat Kukaj“Kosova”
Vorea Ujko:“Livadhi”
Në teatër

Nga përmbajtjet mësimore arsimtarët zgjedhin temat adekuate dhe i përshtatin në kuadër të nënkategorive të caktuara sipas planit mësimor. Arsimtarët mund të zgjedhin edhe përmbajtje të tjera nga libri i leximit, nga gazetatat dhe nga revistat për fëmijë.

Njësitë mësimore realizohen sipas planit dhe programit mësimor, varësisht nga numri i përgjithshëm i orëve mësimore. Parashihen orët për njësitë e reja mësimore dhe ato për përsëritje dhe përforcim të lëndës së mësuar më parë.

METODOLOGJIA

Për të realizuar me sukses programin e lëndës Gjuhë shqipe për nxënësit e komuniteteve joshqiptare në klasën e pestë fillore kërkohet zbatimi i metodologjisë bashkëkohore të mësimdhënies së gjuhëve, i metodave dhe i teknikave mësimore dhe i mjeteve të konkretizimit. Metodika e mësimin të gjuhës amtare, metodika e përvetësimit të gjuhëve të huaja dhe metodologjia e mësimdhënies në tërësi, përfshijnë udhëzime interesante dhe të dobishme për këtë veprimtari arsimore. Komunikimi të zhvillohet në plan më të gjerë: bashkëbisedimi, dëgjimi i realizimeve programore audiovizuale me tematikë dhe me përmbajtje që lidhet me mësimin e gjuhës shqipe, por edhe me lëndë të tjera, të shprehurit me gojë dhe me shkrim, puna në grupe, në çifte, debatet, testet, intervistat, letërkëmbimi, lojërat me role, lojërat skenike (dramatizimi), ushtrime leximi dhe shkrimi, lojëra mësimi, pyetësori, fleta kontrolluese dhe forma të tjera të komunikimit me gojë dhe me shkrim.

Parimet kryesore metodologjike të mësimin të gjuhës shqipe janë:

- Përqendrimi në komunikim;
- Përqendrimi në gjuhën e gramatizuar;
- Përqendrimi në nxënësin dhe në të nxënit e tij;

Roli i mësimdhënësit është i pazëvendësueshëm. Ai duhet të njohë dhe të zbatojë metodat dhe teknikat bashkëkohore të mësimdhënies.

Ai duhet të njohë mirë nxënësit, përgatitjen dhe aftësitë e tyre, prirjet për mësimin e gjuhës. Nxënësi duhet të jetë në qendër të vëmendjes.

Mjetet mësimore: libri, fletorja e punës, fotografitë, kasetat disqet, ilustrimet, videoprojektori, materiali auditiv, videomateriali dhe mjetet e tjera të konkretizimit. Mësimdhënësi, varësisht nga njësia mësimore dhe nga qëllimet e mësimin, zgjedh mjete mësimore, me të cilat e konkretizon mësimin, nxit aktivitetin e nxënësve dhe siguron cilësinë më të lartë të realizimit të mësimin praktik.

VLERËSIMI

Vlerësimi i punës me nxënësit dhe i suksesit në mësim ka rëndësi të madhe. Mësimdhënësi në vazhdimësi duhet të vlerësojë:

- * Njohuritë që kanë fituar nxënësit: në ç`shkallë kanë zotëruar fjalorin dhe sa është i aftë nxënësi t`i përdorë shkathtësitë gjuhësore gjatë komunikimit
- * Angazhimin e nxënësve në procesin e mësimin
- * Përvetësimin e njohurive nga nxënësit e klasës së tretë (niveli i parë, niveli i dytë dhe niveli i tretë)
- * Suksesi i kënaqshëm, i arritur me të gjithë vënësit e klasës, por edhe me secilin nxënë.
- * Ecuritë e volitshme, por edhe ato të pavolitshme të mësimin, identifikohen vështirësitë, pengesat, shqyrtohen problemet e veçanta të mësimdhënies, të përdorimit të mjeteve të konkretizimit etj., dhe ndërmerren masa për përmirësimin i nivelit të mësimin të gjuhës shqipe, që nxënësit të flasin, të lexojnë dhe të shkruajnë lirshëm dhe të arrijnë sukses sa më të mirë në mësim dhe në komunikim të përditshëm në shkollë dhe në ambiente të tjera.
- * Mësimdhënësi vlerëson drejtshqiptimin e tingujve dhe të fjalëve, leximin dhe shkrimin e teksteve, fjalorin e nxënësve dhe në tërësi vlerëson shkathtësinë e komunikimit. Po ashtu vlerëson edhe shkallën e përvetësimin të njohurive të tjera plotësuese, që lidhen me programin e kësaj lënde mësimore.
- * Me vlerësimin e gjithanshëm dhe të vazhdueshëm mësimdhënësi synon të përmirësojë nivelin e mësimin. Vlerësimi i drejtpërdrejtë bëhet gjatë zhvillimit të orëve të mësimin dhe sidomos gjatë përforcimit të njësive mësimore, ndërsa vlerësimi indirekt bëhet

me anë të ushtrimeve, të diktimit dhe të formave të tjera të komunikimit.

- * Vlerësimi apo vetëvlerësimi bëhet edhe nga nxënësit. Ata e pyesin njëri tjetrin, përgjigjen dhe bëjnë vlerësimin e njohurive dhe shkallën e aftësisë për komunikim në gjuhën shqipe.
- * Vlerësimi përfshin: leksikun, radhitjen e fjalëve në fjali, të shprehurit me gojë, leximin, të shprehurit me shkrim, aftësinë e komunikimit, pyetjet dhe përgjigjet, shqiptimin e tingujve dhe të fjalëve, komunikimin aktiv, angazhimin individual dhe në grupe gjatë procesit të mësimet etj.

LITERATURA

Plani dhe programi mësimor 4, MASHT, Prishtinë, 2004

Bahri Beci, Gjuha shqipe 4, “Dukagjini”, 2004

Musai, Bardhyl: Metodologjia e mësimdhënies, Tiranë, 2003

Teksti i klasës së pestë do të hartohet mbi bazë të programit të ri

Tekstet e gjuhës shqipe, dhe të gjuhëve të tjera, që i plotësojnë
kërkesat e këtij programi

GJUHË SHQIPE

6

HYRJE

Në kapitullin GJUHËT DHE KOMUNIKIMI të *Kornizës së kurrikulit të ri të Kosovës*, duke filluar nga klasa e tretë e arsimit fillor, përfshihet edhe lënda mësimore *Gjuhë shqipe* - për nxënësit e komuniteteve joshqiptare të Kosovës. Gjuha shqipe është gjuhë e mjedisit dhe ka objektiva të përgjithshëm dhe specifike. Mësimi i shqipes në arsimin fillor synon të sigurojë mundësi për komunikim brenda shoqërisë kosovare dhe më gjerë, për arsimim të gjithanshëm, për bashkëpunim dhe për qëllime të tjera shumë të dobishme për jetë dhe për veprimtari të gjithanshme.

Gjatë hartimit të këtij programi mësimor janë marrë parasysh nivelet e përcaktuara në “*Kornizën e përbashkët evropiane të raportit mbi gjuhët*”, të miratuar dhe të publikuar nga Këshilli i Evropës (2001), kërkesat dhe kushtet e shkollimit të nxënësve, disa programe mësimore për gjuhën e dytë në disa shkolla evropiane dhe përvojat e mësimin të gjuhës shqipe në përgjithësi.

Përmbajtjet e programit të lëndës mësimore *Gjuhë shqipe* janë të përshtatshme dhe i përgjigjen moshës së nxënësve. Ecuria e mësimin në tërësi zgjon intersimin e tyre për ta përvetësuar gjuhën në mënyrë funksionale: nxënësit të përdorin fjalë dhe shprehje nga jeta e përditshme, të komunikojnë lehtë, të flasin, të lexojnë dhe të shkruajnë. Programi përfshin këto tërësi programore: Të dëgjuarit dhe të folurit, Të lexuarit, Të shkruarit dhe Njohuri gjuhësore.

QËLLIMI

Qëllimi i mësimin të Gjuhës shqipe në klasën e gjashtë për nxënësit e komuniteteve joshqiptare është përfundimi i njohurive të gjuhës shqipe, të përvetësuar më parë në arsimin fillor dhe zhvillimi i lëndës për përvetësuar

vetësimin e njohurive dhe të shkathtësive të reja të komunikimit në gjuhën shqipe.

- Nxënësit të kuptojnë përmbajtjet letrare dhe joletrare;
- Të përdorin fjalë dhe shprehje nga jeta e përditshme;
- Në shkollë dhe në aktivitete të tjera të përdorin fjalë, fjali dhe shprehje, me të cilat realizojnë komunikimin për plotësimin e nevojave konkrete;
- Zhvillimi i aftësive për të komunikuar me gojë dhe me shkrim;
- Përjetimi artistik nga leximi i krijimeve të zgjedhura letrare dhe artistike të përshtatshme për moshën e nxënësve;
- Realizimi i objektivave të përgjithshëm dhe specifike që parashihen për mësimin e gjuhës shqipe si lëndë mësimore për komunitete jo-shqiptare, siç janë: aftësimi i nxënësve për të folur, për të lexuar dhe për të shkruar gjuhën shqipe, bashkëpunimi i mirë midis nxënësve dhe shoqërimi, respektimi i gjuhës dhe i kulturës, edukimi i nxënësve në frymën e mirëkuptimit dhe të respektimit të njëri-tjetrit.

OBJEKTIVAT E PËRGJITHSHËM

Nxënësit duhet të jenë në gjendje:

- Të zhvillojnë kulturën gjuhësore të mjedisit;
- Të flasin, të shkruajnë dhe të komunikojnë në gjuhën shqipe;
- Të kuptojnë dhe të analizojnë tekste joletrare dhe letrare;

Të identifikojnë:

- Tekste të ndryshme dhe elemente gjuhësore;
- Fjalët e ndryshueshme dhe të pandryshueshme;

Të zbatojnë:

- Njohuritë e fituara gjuhësore: fonetike, gramatikore dhe leksikore;
- Njohuritë e fituara mbi modelet e teksteve letrare dhe joletrare;

Të analizojnë:

- Fjalë, fjali të thjeshta dhe fjali të përbëra;
- Tekste të ndryshme letrare dhe joletrare;

Të vlerësojnë:

- Përdorimin e drejtë të fjalëve, të fjalive dhe të shprehjeve gjuhësore;
- Tekste letrare dhe joletrare;

Të formojnë qëndrimin kritik dhe të vlerësojë vlerat:

- Të zhvillojnë aftësitë për vlerësim kritik;
- Të përvetësojnë shkathhtësitë e komunikimit;
- Të fitojnë shprehje të leximit dhe edukatë qytetare.

KATEGORIA

I. TË DËGJUARIT DHE TË FOLURIT

Nënkategoritë:

- I. 1. Kulturë e të dëgjuarit dhe të folurit
- I. 2. Tekste letrare dhe joletrare
- I. 3. Njohuri gjuhësore

KATEGORIA

II. TË LEXUARIT

Nënkategoritë:

- II. 1. Kulturë e të lexuarit
- II. 2. Tekste letrare dhe joletrare
- II. 3. Njohuri gjuhësore

KATEGORIA

III. TË SHKRUARIT

Nënkategoritë:

III. 1. Kulturë e të shkruarit

III. 2. Tekste letrare dhe joletrare

III. 3. Njohuri gjuhësore

Vërejtje: Përmbajtjet e programit mësimor realizohen në funksion të të tri kategorive kryesore:

I.1, I.2, I.3. Kulturë e të dëgjuarit dhe të folurit, Kulturë e të lexuarit, Kulturë e të shkruarit 40 orë

I.2, II.2, III.2. Tekste letrare dhe joletrare 20 orë

I.3, II.3, III.3. Njohuri gjuhësore 14 orë

PROGRAMI

Nënkategoritë: I.1, II.1 III.1	Përmbajtja	Rezultatet e pritshme
* Kulturë e të dëgjuarit dhe të folurit * Kulturë e të lexuarit * Kulturë e të shkruarit	Biseda e arsimtarit me nxënësit; Gjuha shqipe e folur dhe gjuha e shkruar; Dëgjimi i dialogëve të incizuar dhe i teksteve të tjera; Përsëritje, bisedë për punën në klasë, për jetën shkollore, për jetën në shtëpi dhe për aktivitetet e tjera në rrethin jetësor; Forma të ndryshme të komunikimit: dialogu, monologu; Tekste me karakter edukativ dhe tekste të zgjedhura letrare: poezi,	- Nxënësit dëgjojnë me vëmendje dhe kuptojnë pjesë të zgjedhura letrare dhe joletrare, recitime, dialogë, monologë, përmbajtje dhe paraqitje të ndryshme tonike; - Nxënësit flasin, shkruajnë dhe aftësohen për komunikim; - Bisedojnë lirshëm për jetën në shkollë, për mjediset ku jetojnë dhe për tema të tjera; - Në mënyrë graduale përvetësojnë drejtshqiptimin dhe drejtshkrimin e gjuhës shqipe; - Përvetësojnë teknikat e të

	tregime dhe tekste dramatike për fëmijë; Fjalori (Pasurimi i fjalorit me fjalë të reja); Ushtrime gjuhësore.	folurit; - Pasurojnë fjalorin, recitojnë, përgatisin role të pjesëve dramatike; - Aftësohen për të shprehur mendimet e tyre me gojë dhe me shkrim.
Nënkategoritë: I.2, II.2 III.3	Përmbajtja	Rezultatet e pritshme
*Tekste letrare dhe joletrare	Tekste letrare dhe joletrare: Letërsi shqipe dhe letërsi botërore për fëmijë; poezi, poema (fragmente), tregime, roman (fragment), pjesë dramatike (fragment); Tregimi i shkurtër; Krijime nga krijimtaria popullore: përralla, fabula, poezi; Artikuj nga gazetat dhe revistat për fëmijë; Përshkrimi i pamjeve të natyrës; Teksti letrar; Krahasimi: rrëfimi letrar dhe të folurit e përditshëm.	- Nxënësit lexojnë dhe komentojnë tekstet joletrare dhe krijimet artistike; - Njohin veçoritë themelore të veprave letrare; - Fitojnë njohuri për gjinitë dhe llojet letrare, për letërsinë popullore dhe për letërsinë e shkruar; - Flasin dhe shkruajnë për vlerat artistike, lexojnë literaturë të zgjedhur dhe duke lexuar përjetojnë kënaqësinë estetike; - Nxënësit shprehin mendimin vlerësues për anët pozitive të veprës letrare dhe për të metat.
Nënkategoritë: I.3, II.3, III.3	Përmbajtja	Rezultatet e pritshme
*Njohuri gjuhësore	<i>Tingujt</i> : Zanoret, Bashkëtingëlloret; Rrokja. Fjala. <i>Emri</i> . Lakimi i emrit. Fjalitë e thjeshtë. Fjalitë e përbërë. Kryefjalitë dhe kallëzuesit. Krahasimi i shkrimit të gjuhës shqipe dhe i shkrimit të gjuhës amtare (ngjashmëritë dhe	- Njohin ndryshimet e gjuhës shqipe në krahasim me gjuhën amtare; - Mësojnë fjalë dhe shprehje gjuhësore dhe aftësohen t'i përdorin në të shprehurit me gojë dhe me shkrim; - Mësojnë përdorimin e emrit dhe të foljes;

	dallimet); Përdorimi i shkronjës së madhe; Shenjat e pikësimit; Leximi i tekstit të shkruar nga nxënësit; Diktimi dhe format e tjera të kombinuara të shprehjes me gojë dhe me shkrim; Ushtrime leksikore; Fjalët e huazuar nga gjuhët e tjera.	- Dallojnë gjuhën standarde shqipe nga format dialektore; - Zbatojnë rregullat e drejtshkrimit; - Mësojnë t`i përdorin shenjat e pikësimit dhe lexojnë me intonacion; - Mësojnë përdorimin e “ë” dhe të shkronjës së madhe.
--	---	--

Njësitë mësimore realizohen sipas planit dhe programit mësimor, varësisht nga numri i përgjithshëm i orëve mësimore. Parashihen orët për njësitë e reja mësimore dhe ato për përsëritje dhe përforsim të lëndës së mësuar më parë.

Përmbajtja:

Gjuha shqipe (Gjuha e folur dhe gjuha e shkruar)

Shkolla jonë

Si të paraqitemi ose të prezantohemi

Puna në klasë

Si të pyesim

Si të shprehim dëshirat tona

Stinët dhe muajt e vitit (Përshkrime)

Vendlindja ime dhe bukuritë e natyrës

Familja dhe farefisi

Shprehim mendimet tona

Të njohim dhe të përdorim fjalorin

Poezi të zgjedhura për fëmijë (Zgjedhje)

Tregime të zgjedhura (Zgjedhje)

Romani për fëmijë (Fragment i zgjedhur)

Shfaqje në Teatrin për fëmijë

Udhëtimi me mjete të ndryshme të komunikacionit

Profesioni im i ardhshëm

E dua muzikën
Sporti
Mjetet e informimit (Shtypi, Radio, Televizioni, Interneti)
Gazeta dhe revistat për fëmijë
Ushqimi dhe pijet
Pemët dhe perimet

Nga këto tema mësimdhënësi i zgjedhë disa prej tyre: për bashkëbisedim, për lexim për ushtrime me shkrim dhe për komunikim. Ai mund të përfshijë edhe vetë disa tema për të cilat nxënësit tregojnë interesim të veçantë dhe mund të zhvillojnë edhe aktivitete plotësuese: fletushka e nxënësve, gazeta e murit, përgatitja e recitimeve, rolet skenike etj.

LIDHJA NDËRLËNDORE

Mësimi i Gjuhës shqipe në klasën e gjashtë për nxënësit e komuniteteve joshqiptare ka rëndësi të madhe, sepse ofron mundësi për lidhje ndërlëndore. Nxënësit e përvetësojnë gjuhën shqipe dhe njëkohësisht fitojnë njohuri të shumta, ose i përforcojnë ato, nga fushat e tjera të dijes dhe të komunikimit. Lidhja ndërlëndore me mësimin e gjuhëve të tjera është më e theksuar: me mësimin e gjuhës amtare, me mësimin e gjuhës së huaj etj. Programi mësimor i kësaj lënde përfshin përmbajtje të ndryshme nga fushat e tjera programore, siç janë: Artet, Shhkencat shoqërore, Shkencat e natyrës, Edukata fizike dhe sportet, Edukata qytetare etj.

Lidhjet ndërprogramore të mësimi të Gjuhës shqipe si lëndë mësimore janë shumë të gjera.

UDHËZIME METODOLOGJIKE

Për të realizuar me sukses programin e lëndës Gjuhë shqipe për nxënësit e komuniteteve joshqiptare kërkohet zbatimi i metodologjisë bashkëkohore të mësimdhënies së gjuhëve, i metodave dhe i teknikave mësimore adekuate. Metodika e leximit dhe shkrimit, metodika e mësimin të gjuhëve dhe ajo e përvetësimit të gjuhëve të tjera, përfshijnë udhëzime interesante dhe të dobishme për këtë veprimtari arsimore. Komunikimi të zhvillohet në plan më të gjerë: bashkëbisedimi, dëgjimi i realizimeve programore audiovizuale me tematikë dhe me përmbajtje që lidhet me mësimin e gjuhës shqipe, komunikimi me gojë dhe me shkrim, puna në

grupe, në çifte, debatet, testet dhe intervistat e thjeshta, letërkëmbimi dhe komunikimi përmes internetit, lojërat me role, lojërat skenike (dramatizimi), teste me vende të zbrazëta, lojëra mësimi dhe forma të tjera komunikimi me gojë me shkrim.

Parimet kryesore metodologjike të mësimi të gjuhës shqipe janë:

- Përqendrimi në komunikim;
- Përqendrimi në gjuhën e gramatizuar;
- Përqendrimi në nxënësin dhe në të nxënit e tij.

Roli i mësimdhënësit është i pazëvendësueshën. Ai duhet të njohë dhe të zbatojë metodat dhe teknikat bashkëkohore të mësimdhënies.

Mjetet mësimore: libri, fletorja e punës, fotografitë, videoprojektori, materiali auditiv, materiali pamor, videomateriali, ilustrimet dhe mjete e tjera të konkretizimit.

VLERËSIMI

Vlerësimi i punës me nxënësit dhe i suksesit në mësim ka rëndësi të madhe. Mësimdhënësi në vazhdimësi duhet të vlerësojë:

- * Njohuritë që kanë fituar nxënësit: në ç`shkallë kanë zotëruar fjalorin dhe sa është i aftë nxënësi t`i përdorë shkathtësitë gjuhësore gjatë komunikimit
- * Angazhimin e nxënësve në procesin e mësimi
- * Përvetësimin e njohurive nga nxënësit e klasës së gjashtë (niveli i parë, niveli i dytë dhe niveli i tretë);
- * Suksesin e kënaqshëm, të arritur me të gjithë nxënësit e klasës, por edhe me secilin nxënës;
- * Eecuritë e volitshme, por edhe ato të pavolitshme të mësimi, identifikohen vështirësitë, pengesat, shqyrtohen problemet e veçanta të mësimdhënies, të përdorimit të mjeteve të konkretizimit etj., dhe ndërmerren masa për përmirësimin i nivelit të mësimi të gjuhës shqipe, që nxënësit të flasin, të lexojnë dhe të shkruajnë lirshëm dhe të arrijnë sukses sa më të mirë në mësim dhe në komunikim të përditshëm në shkollë dhe në mjedise të tjera.

- * Mësimdhënësi vlerëson drejtshqiptimin e tingujve dhe të fjalëve, leximin dhe shkrimin e teksteve, fjalorin e nxënësve dhe në tërësi vlerëson shkathtësinë e komunikimit. Po ashtu vlerëson edhe shkallën e përvetësimit të njohurive të tjera plotësuese, që lidhen me programin e kësaj lënde mësimore.
- * Me vlerësimin e gjithanshëm dhe të vazhdueshëm mësimdhënësi synon të përmirësojë nivelin e mësimin. Vlerësimi i drejtpërdrejtë bëhet gjatë orëve të zhvillimit të orëve të mësimin dhe sidomos gjatë përfundimit të njësive mësimore, ndërsa vlerësimi i tërthort bëhet me anë të testeve, të diktimit dhe të hartimit me shkrim.
- * Verësimi apo vetëvlerësimi bëhet edhe nga nxënësit. Ata e pyesin njëri-tjetrin, përgjigjen dhe bëjnë vlerësimin e njohurive dhe shkallën e aftësimin për komunikim në gjuhën shqipe.
- * Vlerësimi përfshin: leksikun, radhitjen e fjalëve në fjali, të shprehurit me gojë, leximin, të shprehurit me shkrim, aftësinë e komunikimit, pyetjet dhe përgjigjet, shqiptimin e tingujve dhe të fjalëve, komunikimin aktiv, angazhimin individual dhe në grupe gjatë procesit të mësimin etj.

LITERATURA

Plani dhe Programi Mësimor 6, Prishtinë, 2003

Musai, Bardhyl: Psikologjia e edukimit - zhvillimi, të nxënit, mësimdhënia, Tiranë, 1999

Beci, Bahri: Gjuha shqipe 6, Libri Shkollor, Prishtinë, 2003

Leximi letrar 6, Libri Shkollor , Prishtinë, 2000

Muka, Petrit: Të mësuarit me objektiva dhe modeli A-94, Prishtinë, 1997

GJUHË SHQIPE

7

HYRJE

Lënda mësimore Gjuhë shqipe për klasën e shtatë - për nxënësit e komuniteteve joshqiptare të Kosovës, përfshihet në lëmin *Gjuhët dhe komunikimi* dhe ka rëndësi të madhe për formimin kulturor dhe për komunikimin me gojë dhe me shkrim të nxënësve. Mësimi i shqipes në shkollën e mesme të ulët synon të zhvillojë dijet dhe shkathtësitë për komunikim, të sigurojë mundësi për komunikim brenda shoqërisë kosovare dhe më gjerë, për arsimim të gjithanshëm, për bashkëpunim dhe për qëllime të tjera shumë të dobishme për jetë dhe për veprimtari kulturore, shoqërore dhe ekonomike.

Gjatë hartimit të këtij programi mësimor janë marrë parasysh nivelet e përcaktuara në “*Kornizën e përbashkët evropiane të raportit mbi gjuhët*”, të miratuar dhe të publikuar nga Këshilli i Evropës (2001), kërkesat dhe kushtet e shkollimit të nxënësve dhe disa programe mësimore për gjuhën e dytë.

Përmbajtjet e programit të lëndës mësimore *Gjuhë shqipe* janë të përshtatshme dhe u përgjigjen moshës së nxënësve. Ecuria e mësimit në tërësi zgjon intersimin e tyre për ta përvetësuar gjuhën në mënyrë funksionale: të vazhdojnë mësimin e gjuhës shqipe, të përvetësojnë më mirë njohuritë e fituara më parë, në mënyrë graduale të fitojnë njohuri të reja, të pasurojnë fjalorin, të përdorin fjalë dhe shprehje nga jeta e përditshme, nga jeta shkollore dhe nga tekstet letrare dhe joletrare. Të aftësohen për të përdorur forma të ndryshme të komunikimit, të pyesin dhe të përgjigjen rrjedhshëm me gojë dhe me shkrim, të komunikojnë lehtë, të flasin, të lexojnë dhe të shkruajnë. Programi përfshin këto kategori programore: Të dëgjuarit dhe të folurit, Të lexuarit, Të shkruarit dhe Njohuri gjuhësore. Në kuadër të çdo kategorie përfshihen edhe nënkategoritë e programit të Gjuhës shqipe.

QËLLIMI

Qëllimi i mësimit të Gjuhës shqipe në klasën e shtatë - për nxënësit e komuniteteve joshqiptare është përforcimi dhe zhvillimi i njohurive të përvetësuara më parë në arsimin fillor dhe në klasën e gjashtë dhe përvetësimi i njohurive dhe i shkathtësive të reja.

- Nxënësit të kuptojnë dhe të përdorin fjalë dhe shprehje nga jeta e përditshme, nga jeta shkollore, nga aktivitetet e tjera kulturore dhe shoqërore. Të aftësohen të përdorin shprehje të llojllojshme, me të cilat begatojnë komunikimin e duhur për plotësimin e nevojave konkrete dhe për formimin kulturor;
- Zhvillimi i aftësive për të komunikuar me gojë dhe me shkrim në shkollë, jashtë shkollës dhe në aktivitete të tjera;
- Përjetimi artistik i krijimeve të zgjedhura letrare dhe artistike;
- Nxënësit të inkurajohen të marrin pjesë në aktivitete arsimore, kulturore dhe shoqërore;
- Të njohin gjuhën shqipe, veçoritë e saj dhe shkurtimisht të njohin origjinën dhe zhvillimin e saj;
- Realizimi i objektivave të përgjithshëm dhe specifikë që parashihen për mësimin e gjuhës shqipe si lëndë mësimore për komunitete joshqiptare, siç janë: aftësimi i nxënësve për të folur, për të lexuar dhe për të shkruar gjuhën shqipe;
- Bashkëpunimi i mirë midis nxënësve dhe shoqërimi, respektimi i gjuhës shqipe dhe i gjuhëve të tjera, motivimi për ta përvetësuar gjuhën shqipe dhe për ta njohur kulturën dhe qytetërimin shqiptar.

OBJEKTIVAT E PËRGJITHSHËM

Nxënësit duhet të jenë në gjendje:

- Të zhvillojnë kulturën gjuhësore të mjedisit;
- Të flasin, të shkruajnë dhe të komunikojnë në gjuhën shqipe;
- Të kuptojnë dhe të analizojnë tekste letrare dhe joletrare.

Të identifikojnë:

- Tekste të ndryshme dhe elemente gjuhësore;
- Shkathtësi të komunikimit.

Të zbatojnë:

- Njohuritë e fituara gjuhësore: gramatikore dhe leksikore;
- Njohuritë e fituara mbi modelet e teksteve letrare dhe joletrare.

Të analizojnë:

- Fjalë, fjali të thjeshta dhe fjali të përbëra;
- Tekste të ndryshme.

Të vlerësojnë:

- Pasurinë e gjuhës shqipe me fjalë dhe me shprehje gjuhësore;
- Tekste letrare dhe joletrare.

Të formojnë qëndrimin kritik dhe të vlerësojnë vlerat:

- Të zhvillojnë aftësitë për vlerësim kritik;
- Të përvetësojnë shkathhtësitë e komunikimit;
- Të fitojnë shprehi të leximit dhe edukatë qytetare.

KATEGORIA

I. TË DËGJUARIT DHE TË FOLURIT

Nënkategoritë:

- I. 1. Kulturë e të dëgjuarit dhe të folurit
- I 2. Tekste letrare dhe joletrare
- I. 3. Njohuri gjuhësore

KATEGORIA

II. TË LEXUARIT

Nënkategoritë:

- II. 1. Kulturë e të lexuarit
- II. 2. Tekste letrare dhe joletrare
- II. 3. Njohuri gjuhësore

KATEGORIA

III. TË SHKRUARIT

Nënkategoritë:

- III. 1. Kulturë e të shkruarit
- III. 2. Tekste letrare dhe joletrare
- III. 3. Njohuri gjuhësore

Vërejtje: Përmbajtjet e programit mësimor realizohen në funksion të të tri kategorive kryesore:

I.1, I.2, I.3. Kulturë e të dëgjuarit dhe të folurit, Kulturë e të lexuarit, Kulturë e të shkruarit 40 orë

I.2, II.2, III.2 Tekste letrare dhe joletrare 20 orë

I.3, II.3, III.3 Njohuri gjuhësore 14 orë

PROGRAMI

Nënkategoritë: I.1, II.1 III.1	Përmbajtja	Rezultatet e pritshme
* Kulturë e të dëgjuarit dhe të folurit * Kulturë e të lexuarit * Kulturë e të shkruarit	Gjuha shqipe e folur dhe gjuha e shkruar; Dëgjimi i dialogëve të incizuar dhe i teksteve të tjera; Bisedë për punën në klasë, për jetën shkollore, për jetën në shtëpi dhe për aktivitetet e tjera në rrethin jetësor; Forma të ndryshme të komunikimit: dialogu, monologu; Tekste të zgjedhura letrare: poezi, tregime dhe tekste dramatike për fëmijë; Tekste joletrare. Tekste praktike: prezantime, përshëndetje, urime, ftesa, letra, falënderime, kërkesa, lajmërime.	- Nxënësit dëgjojnë me vëmendje dhe kuptojnë pjesë të zgjedhura, recitime, dialogë, monologë, përmbajtje dhe paraqitje të ndryshme tonike; - Nxënësit flasin dhe aftësohen për komunikim; - Bisedojnë lirshëm për çështje dhe për tema të ndryshme, për jetën në shkollë, për veprimtaritë e tyre dhe për tema të tjera; - Në mënyrë graduale përvetësojnë drejtshqiptimin dhe drejtshkrimin e gjuhës shqipe; -Përvetësojnë teknikat e të folurit; - Pasurojnë fjalorin, recitojnë, përgatisin role të pjesëve dramatike;

		- Aftësohen për të shprehur mendimet e tyre me gojë dhe me shkrim në situata të ndryshme.
Nënkategoritë: I.2, II.2 III.3	Përmbajtja	Rezultatet e pritshme
* Tekste letrare dhe joletrare	Tekste letrare dhe joletrare; <i>Letërsi shqipe dhe letërsi botërore për fëmijë:</i> poezi, poema (fragmente), tregime, roman (fragment), pjesë dramatike (fragment). Rrëfimi; <i>Nga krijimtaria popullore:</i> përralla, fabula, poezi; Tema. Subjekti. Shprehja e figurshme dhe jo e figurshme; Artikuj nga gazetat dhe revistat për fëmijë; Përshkrimi i pamjeve të natyrës; Krijimi letrar (veçoritë kryesore); Gjuha e tekstit letrar dhe të folurit e përditshëm.	- Nxënësit lexojnë dhe komentojnë tekstet joletrare dhe krijimet artistike; - Njohin veçoritë themelore të veprave letrare; - Fitojnë njohuri për gjinitë dhe llojet letrare, për letërsinë popullore dhe për letërsinë e shkruar; - Flasin dhe shkruajnë për vlerat artistike, lexojnë literaturë të zgjedhur dhe duke lexuar përjetojnë kënaqësinë estetike; - Nxënësit shprehin mendimin vlerësues për aspekte të ndryshme të veprës.
Nënkategoritë: I.3, II.3, III.3	Përmbajtja	Rezultatet e pritshme
* Njohuri gjuhësore	Dialektet e shqipes; Gjuha letrare; Përemri, mbiemri, numërori; Kohët dhe mënyrat e foljes; Krahasimi i shkrimit të gjuhës shqipe dhe i shkrimit të gjuhës amtare (ngjashmëritë dhe dallimet); Leximi i tekstit të shkruar nga nxënësit; Përdorimi i “ë”; Diktimi dhe format e	-Mësojnë cilat janë dialektet e gjuhës shqipe dhe të folmet; -Njohin ndryshimet e gjuhës shqipe në krahasim me gjuhën amtare; - Përvetësojnë gjuhën letrare; -Mësojnë fjalë dhe shprehje gjuhësore dhe aftësohen t`i përdorin në të shprehurit me gojë dhe me shkrim; -Mësojnë përdorimin e emrit, të përemrit, të mbiemrit, të numërorit dhe të foljes;

	tjera të kombinuara të shprehjes me gojë dhe me shkrim; Formimi i fjalëve dhe i fjalive; Shkrimi i tekstit me temë të lirë; Fjalët me shumë kuptime; Mësimi i fjalëve të reja; Ushtrime gjuhësore; Ushtrime përkthimi.	-Dallojnë gjuhën standarde nga format dialektore -Zbatojnë rregullat e drejtshkrimit; -Mësojnë t`i përdorin shenjat e pikësimit dhe lexojnë me intonacion; - Aftësohen për të përkthyer fjalë dhe tekste.
--	--	--

Njësitë mësimore realizohen sipas planit dhe programit mësimor, varësisht nga numri i përgjithshëm i orëve mësimore. Parashihen orët për njësitë e reja mësimore dhe ato për përsëritje dhe përforcim të lëndës së mësuar më parë.

Përmbajtja:

Libri është burim i diturisë
Monumentet kulturore
Krijimtaria letrare (nga letërsia shqipe dhe nga letërsia botërore)
Poezi të zgjedhura për fëmijë
Tregime të zgjedhura
Romani për fëmijë (fragment i zgjedhur)
Përralla popullore
Gjinitë dhe llojet letrare
Shfaqje në Teatrin për fëmijë
E dua pikturën
Filmi (bisedë për filmin e shikuar)
Nxënësit e vendbanimit tim
Programi shkollor i Radios
Programi shkollor i Televizionit
Interneti (Komunikimi)
Intervista
Simbolet kombëtare
Skënderbeu

Flasim dhe shkruajmë
Leksiku i shqipes
Miqësia
Një letër shokut/shoqes

Nga këto tema mësimdhënësi zgjedh disa sosh: për bashkëbisedim, për lexim për detyra me shkrim dhe për komunikim. Ai mund të përfshijë edhe vetë disa tema, për të cilat nxënësit tregojnë interesim të veçantë dhe mund të zhvillojnë edhe aktivitete plotësuese: fletushka e nxënësve, gazeta e murit, përgatitja e recitimeve, rolet skenike etj.

LIDHJA NDËRLËNDORE

Mësimi i Gjuhës shqipe në klasën e shtatë për nxënësit e komuniteteve joshqiptare ka rëndësi të madhe, sepse ofron mundësi për lidhje programore dhe ndërlëndore. Nxënësit e përvetësojnë gjuhën shqipe dhe njëkohësisht fitojnë njohuri të reja ose i përforcojnë ato, nga fushat e tjera të dijes dhe të komunikimit. Lidhja ndërlëndore me mësimin e gjuhëve të tjera është më e theksuar: me mësimin e gjuhës amtare, me mësimin e gjuhës së huaj etj. Programi mësimor i kësaj lënde përfshin përmbajtje të ndryshme nga fushat e tjera programore, siç janë: Artet, Shkencat shoqërore, Shkencat e natyrës, Edukata fizike dhe sportet, Edukata qytetare etj.

Nxënësit njihen edhe me lëndë të tjera, në të cilat përfshihen tema interesante, siç janë: të drejtat e fëmijës, të drejtat e njeriut, parimet e shoqërisë demokratike, miqësia, mirëkuptimi, toleranca, solidariteti dhe mirëqenia, shëndetësia, ruajtja e mjedisit, kultura teknike etj.

UDHËZIME METODOLOGJIKE

Për të realizuar me sukses programin e lëndës Gjuhë shqipe për nxënësit e komuniteteve joshqiptare kërkohet zbatimi i metodologjisë bashkëkohore të mësimdhënies së gjuhëve, i metodave dhe i teknikave mësimore. Metodika e mësimin të gjuhës amtare, metodika e përvetësimit të gjuhëve të huaja dhe metodologjia e mësimdhënies në tërësi, përfshijnë udhëzime interesante dhe të dobishme për këtë veprimtari arsimore. Komunikimi të zhvillohet në plan më të gjerë: bashkëbisedimi, dëgjimi i realizimeve programore audiovizuale me tematikë dhe me përmbajtje që lidhet me mësimin e gjuhës shqipe, por edhe me lëndë të tjera, të shpre-

hurit me gojë dhe me shkrim, puna në grupe, në çifte, debatet, testet, intervistat, letërkëmbimi, komunikimi përmes internetit, lojërat me role, lojërat skenike (dramatizimi), hartime, ese, lojëra mësimi, pyetësi, fleta kontrolluese dhe forma të tjera komunikimi me gojë dhe me shkrim.

Parimet kryesore metodologjike të mësimit të gjuhës shqipe janë:

- Përqendrimi në komunikim;
- Përqendrimi në gjuhën e gramatizuar;
- Përqendrimi në nxënësin dhe në të nxënit e tij;

Roli i mësimdhënësit është i pazëvendësueshën. Ai duhet të njohë dhe të zbatojë metodat dhe teknikat bashkëkohore të mësimdhënies.

Ai duhet të njohë mirë nxënësit, përgatitjen dhe aftësitë e tyre, prirjet për mësimin e gjuhës. Nxënësi duhet të jetë në qendër të vëmendjes.

Mjetet mësimore: libri, fletorja e punës, fotografitë, kasetat disqet, ilustrimet, videoprojektori, materiali auditiv, videomateriali dhe mjetet e tjera të konkretizimit. Mësimdhënësi, varësisht nga njësia mësimore dhe nga qëllimet e mësimit, zgjedh mjete mësimore, me të cilat e konkretizon mësimin, nxit aktivitetin e nxënësve dhe siguron cilësinë më të lartë të realizimit të mësimit praktik. Në klasë dhe në mjedise të tjera jashtë saj, edhe nxënësit sjellin mjete të ndryshme konkretizimi.

VLERËSIMI

Vlerësimi i punës me nxënësit dhe i suksesit në mësim ka rëndësi të madhe. Mësimdhënësi në vazhdimësi duhet të vlerësojë:

- * Njohuritë që kanë fituar nxënësit: në ç`shkallë kanë zotëruar fjalorin dhe sa është i aftë nxënësi t`i përdorë shkathtësitë gjuhësore gjatë komunikimit;
- * Angazhimin e nxënësve në procesin e mësimit;
- * Përvetësimin e njohurive nga nxënësit e klasës së shtatë (niveli i parë, niveli i dytë dhe niveli i tretë);
- * Suksesin e kënaqshëm, i arritur me të gjithë nxënësit e klasës, por edhe me secilin nxënësi;
- * Ecurinë e volitshme, por edhe ato të pavolitshme të mësimit, identifikohen vështirësitë, pengesat, shqyrtohen problemet e veçanta të

mësimdhënies, të përdorimit të mjeteve të konkretizimit etj., dhe ndërmerren masa për përmirësimin e nivelit të mësimin të gjuhës shqipe, që nxënësit të flasin, të lexojnë dhe të shkruajnë lirshëm dhe të arrijnë sukses sa më të mirë në mësim dhe në komunikim të përditshëm në shkollë dhe në mjedise të tjera.

- * Mësimdhënësi vlerëson drejtshqiptimin e tingujve dhe të fjalëve, leximin dhe shkrimin e teksteve, fjalorin e nxënësve dhe në tërësi vlerëson shkathtësinë e komunikimit. Po ashtu vlerëson edhe shkallën e përvetësimit të njohurive të tjera plotësuese, që lidhen me programin e kësaj lënde mësimore.
- * Me vlerësimin e gjithanshëm dhe të vazhdueshëm mësimdhënësi synon të përmirësojë nivelin e mësimin. Vlerësimi i drejtpërdrejtë bëhet gjatë orëve të zhvillimit të orëve të mësimin dhe sidomos gjatë përfundimit të njësive mësimore, ndërsa vlerësimi i tërthortë bëhet me anë të testeve, të diktimit dhe të hartimit me shkrim.
- * Verësimi apo vetëvlerësimi bëhet edhe nga nxënësit. Ata e pyesin njëri tjetrin, përgjigjen dhe bëjnë vlerësimin e njohurive dhe shkallën e aftësisit për komunikim në gjuhën shqipe.
- * Vlerësimi përfshin: leksikun, radhitjen e fjalëve në fjali, të shprehurit me gojë, leximin, të shprehurit me shkrim, aftësinë e komunikimit, pyetjet dhe përgjigjet, shqiptimin e tingujve dhe të fjalëve, komunikimin aktiv, angazhimin individual dhe në grupe gjatë procesit të mësimin etj.

LITERATURA

Plani dhe programi mësimor 7, MASHT, Prishtinë, 2004

Gjuhë shqipe 7, Libri Shkollor, Prishtinë, 1997

Musai, Bardhyl: Metodologjia e mësimdhënies, Tiranë, 2003

Teksti i klasës se shtatë që do të hartohet mbi bazë të programit të ri

Tekstet ekzistuese të gjuhës shqipe që i plotësojnë kërkesat e këtij programi

GJUHË SHQIPE

8

HYRJE

Lënda mësimore Gjuhë shqipe për klasën e tetë- për nxënësit e komuniteteve joshqiptare të Kosovës, përfshihet në lëmin *Gjuhët dhe komunikimi* dhe ka rëndësi të madhe për mësimin e gjuhës shqipe, për formimin kulturor dhe për komunikimin me gojë dhe me shkrim të nxënësve. Mësimi i shqipes në shkollën e mesme të ulët synon të zhvillojë dijet dhe shkathtësitë për komunikim, të sigurojë mundësi për komunikim brenda shoqërisë kosovare dhe më gjerë, për arsimim të gjithanshëm, për bashkëpunim dhe për qëllime të tjera shumë të dobishme për jetë dhe për veprimtari kulturore dhe shoqërore.

Gjatë hartimit të këtij programi mësimor janë marrë parasysh nivelet e përcaktuara në “*Kornizën e përbashkët evropiane të raportit mbi gjuhët*”, të miratuar dhe të publikuar nga Këshilli i Evropës (2001), kërkesat dhe kushtet e shkollimit të nxënësve dhe disa programe mësimore për gjuhën e dytë.

Përmbajtjet e programit të lëndës mësimore *Gjuhë shqipe* janë të përshtatshme dhe u përgjigjen moshës së nxënësve. Ecuria e mësimin në tërësi zgjon interesimin e tyre për ta përvetësuar gjuhën në mënyrë funksionale: të vazhdojnë mësimin e gjuhës shqipe, të përvetësojnë më mirë njohuritë e fituara më parë, në mënyrë graduale të fitojnë njohuri të reja, të pasurojnë fjalorin, të përdorin fjalë dhe shprehje nga jeta e përditshme, nga jeta shkollore dhe nga tekstet letrare dhe joletrare. Të aftësohen për të përdorur forma të ndryshme të komunikimit, të pyesin dhe të përgjigjen rrjedhshëm me gojë dhe me shkrim, të komunikojnë lehtë, të flasin, të lexojnë dhe të shkruajnë. Programi përfshin këto kategori programore: Të dëgjuarit dhe të folurit, Të lexuarit dhe Të shkruarit. Në kuadër të çdo kategorie përfshihen edhe nënkategoritë e programit të Gjuhës shqipe.

QËLLIMI

Qëllimi i mësimit të Gjuhës shqipe në klasën e tetë për nxënësit e komuniteteve joshqiptare është përforsimi dhe zhvillimi i njohurive të përvetësuara më parë në arsimin fillor dhe në klasën e shtatë, si edhe përvetësimi i njohurive dhe i shkathtësive të reja të gjuhës shqipe dhe të komunikimit.

- Nxënësit të kuptojnë dhe të përdorin fjalë dhe shprehje nga jeta e përditshme, nga jeta shkollore, nga aktivitetet e tjera kulturore dhe shoqërore. Të aftësohen të përdorin shprehje të llojllojshme, me të cilat begatojnë komunikimin e duhur për plotësimin e nevojave konkrete të komunikimit dhe për formimin kulturor;
- Zhvillimi i aftësive për të komunikuar me gojë dhe me shkrim në shkollë, jashtë shkollës dhe në aktivitete të tjera;
- Përjetimi artistik i krijimeve të zgjedhura letrare dhe artistike;
- Nxënësit të inkurajohen të marrin pjesë në aktivitete arsimore, kulturore dhe shoqërore;
- Të njohin gjuhën shqipe, veçoritë e saj dhe shkurtimisht të njohin origjinën dhe zhvillimin e saj;
- Realizimi i objektivave të përgjithshëm dhe specifike që parashihen për mësimin e gjuhës shqipe si lëndë mësimore për komunitete joshqiptare, siç janë: aftësimi i nxënësve për të folur, për të lexuar dhe për të shkruar gjuhën shqipe;
- Bashkëpunimi i mirë midis nxënësve dhe shoqërimi, respektimi i gjuhës shqipe dhe i gjuhëve të tjera, motivimi për ta përvetësuar gjuhën shqipe dhe për ta njohur kulturën, letërsinë dhe qytetërimin shqiptar në përgjithësi.

OBJEKTIVAT E PËRGJITHSHËM

Nxënësit duhet të jenë në gjendje:

Të zhvillojnë

- kulturën gjuhësore
- shkathtësitë e komunikimit

Të identifikojnë

- Tekste të ndryshme dhe elemente gjuhësore
- Shkathtësi të komunikimit

Të zbatojnë

- Njohuritë e fituara gjuhësore: gramatikore dhe leksikore
- Njohuritë e fituara mbi modelet e teksteve letrare dhe joletrare

Të analizojnë

- Fjalë, fjali të thjeshta dhe fjali të përbëra
- Tekste të ndryshme letrare dhe joletrare

Të vlerësojnë

- Pasurinë e gjuhës shqipe me fjalë dhe me shprehje gjuhësore
- Tekste letrare dhe joletrare

Të formojnë qëndrimin kritik dhe të vlerësojnë vlerat

- Të zhvillojnë aftësitë për vlerësim kritik
- Të fitojnë shprehi të leximit dhe edukatë qytetare

KATEGORIA

I. TË DËGJUARIT DHE TË FOLURIT

Nënkategoritë:

- I. 1 Kulturë e të dëgjuarit dhe të folurit
- I. 2 Tekste letrare dhe joletrare
- I. 3 Njohuri gjuhësore

KATEGORIA

II. TË LEXUARIT

Nënkategoritë:

- II. 1 Kulturë e të lexuarit
- II. 2 Tekste letrare dhe joletrare
- II. 3 Njohuri gjuhësore

KATEGORIA

III. TË SHKRUARIT

Nënkategoritë:

- III. 1 Kulturë e të shkruarit
- III. 2 Tekste letrare dhe joletrare
- III. 3 Njohuri gjuhësore

Vërejtje: Përmbajtjet e programit mësimor realizohen në funksion të tri kategorive kryesore:

I.1, I.2, I.3. Kulturë e të dëgjuarit dhe të folurit, Kulturë e të lexuarit,
Kulturë e të shkruarit 40 orë

I.2, II.2, III.2 Tekste letrare dhe joletrare 20 orë

I.3, II.3, III.3 Njohuri gjuhësore 10 orë

Në dispozicion 4 orë

PROGRAMI NË FORMË TABELARE

Nënkategoritë: I.1, II.1 III.1	Përmbajtja	Rezultatet e pritshme
<p>* Kulturë e të dëgjuarit dhe të folurit</p> <p>* Kulturë e të lexuarit</p> <p>* Kulturë e të shkruarit</p>	<p>Dëgjimi i teksteve letrare dhe jo letrare të incizuara dhe interpretimi i tyre;</p> <p>Recitimi i poezive të zgjedhura;</p> <p>Dëgjimi i realizimeve të zgjedhura skenike dhe filmike;</p> <p>Dialogu dhe monologu</p> <p>Vendet, popujt dhe gjuhët e tyre;</p> <p>Ushtrime leximi;</p> <p>Ushtrime shkrimi;</p> <p>Fjalë të urta;</p> <p>Pranvera (Tekst letrar);</p> <p>Fshati im, qyteti im (Tekste);</p> <p>Për të qeshur (Tekst i zgjedhur);</p> <p>Harta e Kosovës (Komente, pyetje dhe përgjigje);</p> <p>Historia e Kosovës (Informacion praktik);</p> <p>Letërsia shqipe (Shkrimtarë dhe vepra letrare për të rritur dhe për fëmijë);</p> <p>Monumenti i Skënderbeut ;</p> <p>Kultura fizike (Komentim i ndeshjes sportive);</p> <p>Sportet dhe ushtrimet sportive (futbolli, basketbolli, volejbolli, noti, atletika)</p> <p>Analizë e veprës letrare</p> <p>Hartim i lirë;</p> <p>Korrigjimi i hartimeve ;Detyra e shtëpisë (Vendi im)</p> <p>Ushtrime leximi;</p> <p>Ushtrime shkrimi;</p>	<p>Nxënësit dëgjojnë me vëmendje dhe kuptojnë pjesë të zgjedhura;</p> <p>Aftësohen të recitojnë bukur;</p> <p>Dëgjojnë realizime skenike dhe filmike, dallojnë dialogun dhe monologun;</p> <p>Mbajnë në mend emrat e popujve, të vendeve dhe të gjuhëve;</p> <p>Përvetësojnë më mirë shkrimin dhe leximin;</p> <p>Lexojnë tekste të llojeve të ndryshme;</p> <p>Mbajnë në mend dhe i shënojnë emrat në hartën e Kosovës;</p> <p>Flasin shkurtimisht për historinë e Kosovës;</p> <p>Mësojnë disa të dhëna për letërsinë shqipe;</p> <p>Flasin për figurën dhe për monumentin e Skënderbeut;</p> <p>Komentojnë ndeshjen sportive; Flasin për sportet;</p> <p>Analizojnë krijimin letrar;</p> <p>Shkruajnë hartim</p> <p>Korrigjojnë tekstin e shkruar;</p> <p>Bëjnë detyrat shtëpiake dhe i korrigjojnë;</p> <p>Nxënësit aftësohen për komunikim me gojë dhe me shkrimi;</p>

Nënkategoritë: I.2, II.2 III.3	Përmbajtja	Rezultatet e pritshme
*Tekste letrare dhe joletrare	<p>Tekste letrare dhe joletrare; Letërsi shqipe dhe letërsi botërore për fëmijë: poezi, poema (Fragmente), tregime, roman (Fragment), pjesë dramatike (Fragment). Rrëfimi ; Nga krijimtaria popullore: përralla, fabula, poezi; Poezia lirike Analizë e tregimit të lexuar; Personazhi letrar; Test Analiza dhe vlerësimi i testit; Si e kaloj një ditë pushimi; Artikuj nga gazetatat dhe revistat për fëmijë; Përshkrimi i pamjeve të natyrës ; Krijimi letrar (veçoritë kryesore); Gjuha e tekstit letrar dhe të folurit e përditshëm; Të shprehim mendimet tona;</p>	<p>- Nxënësit lexojnë dhe komentojnë tekstet letrare dhe shkrimet e tjera joletrare; -Njohin veçoritë themelore të veprave letrare: lirika, epika, drama; -Fitojnë njohuri për gjinitë dhe llojet letrare, për letërsinë popullore dhe për letërsinë e shkruar; Rrëfejnë për ngjarjet; Flasin për personazhet letrare; -Flasin dhe shkruajnë disa fjali për vlerat artistike të veprës; Bëjnë testin dhe e korrigjojnë; Lexojnë literaturë të zgjedhur dhe duke lexuar përjetojnë kënaqësinë estetike; Bëjnë përshkrimin e natyrës -Shprehin mendimet e tyre dhe komunikojnë me gojë dhe me shkrim;</p>
Nënkategoritë: I.3, II.3, III.3	Përmbajtja	Rezultatet e pritshme
*Njohuri gjuhësore	<p>Drejtshqiptimi dhe drejtshkrimi; Rrokja, theksi, intonacioni; Fjalë dhe forma fjalësh; Fjalë të reja ; Modele fjalish; Trajta e pa shquar dhe e shquar e emrit (mbaresat e trajtës së shquar njëjës dhe shumës)</p>	<p>Nxënësit përvetësojnë drejtshqiptimin dhe drejtshkrimin e shqipes; Shqiptojnë mirë tingujt dhe theksojnë fjalët; Përvetësojnë forma fjalësh; Përdorin modele fjalish; Dallojnë trajtën e pashquar dhe të shquar</p>

	<p>Fjalë dhe forma gramatikore; Folja <i>flas</i> (Zgjedhimi); Folja <i>shkruaj</i> (Zgjedhimi); Parafjalët <i>në</i> dhe <i>nga</i>; Mbiemrat e nyjshëm dhe të panyjshëm; Ndajfolje mënyre: <i>mirë, keq, pastër, shkurt, thjesht, ëmbël</i>; Parafjalët: <i>te, tek, nëpër,, me, pa, mbi, nën etj.</i>; Ushtrime: plotësimi i fjalive jo të plota; Fjalë të reja; Përemri lidhor: <i>që, i cili, e cila</i>; Krahasimi i shkrimit të gjuhës shqipe dhe i shkrimit të gjuhës amtare (ngjashmëritë dhe dallimet); Leximi i tekstit të shkruar nga nxënësit; Diktimi dhe format e tjera të kombinuara të shprehjes me gojë dhe me shkrim; Formimi i fjalëve dhe i fjalive; Shkrimi i tekstit me temë të lirë; Zgjedhimi i foljeve të formës veprorë: <i>punoj, mësoj, lexoj, shkoj</i> etj. Fjalët me shumë kuptime; Zgjedhimi i foljeve të formës joveprorë: <i>lahem, krihem, vishem, gëzohem</i> etj Ushtrime gjuhësore; Ushtrime përkthimi.</p>	<p>të emrave në njëjës dhe në shumës; Përvetësojnë fjalët e reja dhe dallojnë disa forma gramatikore; Zgjedhojnë foljet: <i>flas</i> dhe <i>shkruaj</i> duke formuar fjali; Formojnë fjali në të cilat përfshihen parafjalët <i>në, nga, tek, nëpër, me, pa, mbi, nën etj.</i>; Plotësojnë fjalitë jo të plota në të folur dhe me shkrim; Pasurojnë fjalorin me fjalë të reja; Përdorin përemrat lidhorë: <i>që, i cili, e cila etj.</i>; Krahasojnë gjuhën shqipe me gjuhën amtare (ngjashmëritë dhe dallimet); Përvetësojnë leximin dhe shkrimin; Aftësohen të dallojnë formimin e fjalëve dhe të fjalive; Shkruajnë një tekst të shkurtër me temë të lirë; Zgjedhojnë foljet e formës veprorë: <i>punoj, mësoj, lexoj, shkoj</i>; Zgjedhojnë foljet e formës joveprorë: : <i>lahem, krihem, vishem, gëzohem</i>; Bëjnë ushtrime gjuhësore dhe të përkthimit;</p>
--	---	--

Njësitë mësimore realizohen sipas planit dhe programit mësimor, varësisht nga numri i përgjithshëm i orëve mësimore. Parashihen orët për njësitë e reja mësimore dhe ato për përsëritje dhe përforsim të lëndës së mësuar më parë.

Përmbajtja:

Jemi miq me njëri tjetrin

Ditë vjeshte

Libri i gjuhës shqipe

Krijimtaria letrare (nga letërsia shqipe dhe nga letërsia botërore)

Poezi të zgjedhura për fëmijë

Tregime të zgjedhura

Romani për fëmijë (Fragment i zgjedhur)

Përralla popullore

Gjinitë dhe llojet letrare

Shfaqje në Teatrin për fëmijë

Lepuri dhe dentisti

Filmi (Bisedë për filmin e shikuar)

Vendbanimi im

Si ta hartojmë një raport

Shkrimtari Naim Frashëri

Festivali i këngës për fëmijë

Programi shkollor i Radios

Programi shkollor i Televizionit

Interneti (Komunikimi)

Në pallatin e rinisë dhe të sporteve

Fjalë të urta

Bora e parë

Prishtina

Polici dhe nxënësit

Autoportreti

Monumenti i Skënderbeut

Poezia ime
Nëna
Bisedë miqsh
Gazmoret dhe skeçi
Flasim dhe shkruajmë
Leksiku i shqipes
Në plazh
Një letër prindit

Nga këto tema mësimdhënësi i zgjedh disa prej tyre: për bashkë-bisedim, për lexim për detyra me shkrim dhe për komunikim. Ai mund të përfshijë edhe vetë disa tema, për të cilat nxënësit tregojnë interesim të veçantë dhe mund të zhvillojnë edhe aktivitete plotësuese: fletushka e nxënësve, gazeta e murit, përgatitja e recitimeve, rolet skenike etj.

LIDHJA NDËRLËNDORE

Mësimi i Gjuhës shqipe në klasën e tetë për nxënësit e komuniteteve joshqiptare ka rëndësi të madhe sepse ofron mundësi për lidhje programore dhe ndërlëndore. Nxënësit e përvetësojnë gjuhën shqipe dhe njëkohësisht fitojnë njohuri të reja ose i përforcojnë ato, nga fushat e tjera të dijës dhe të komunikimit. Lidhja ndërlëndore me mësimin e gjuhëve të tjera është më e theksuar: me mësimin e gjuhës amtare, me mësimin e gjuhës së huaj etj. Programi mësimor i kësaj lënde përfshin përmbajtje të ndryshme nga fushat e tjera programore, siç janë: Artet, Shkencat shoqërore, Shkencat e natyrës, Edukata fizike dhe sportet, Edukata qytetare etj.

Nxënësit njihen edhe me lëndë të tjera, në të cilat përfshihen tema interesante siç janë: të drejtat e fëmijës, të drejtat e njeriut, parimet e shoqërisë demokratike, miqësia, mirëkuptimi, toleranca, solidariteti dhe mirëqenia, shëndetësia, ruajtja e ambientit, kultura teknike etj.

METODOLOGJIA

Për të realizuar me sukses programin e lëndës Gjuhë shqipe për nxënësit e komuniteteve joshqiptare (klasa VIII) kërkohet zbatimi i metodologjisë bashkëkohore të mësimdhënies së gjuhëve, i metodave dhe

i teknikave mësimore. Metodika e mësimit të gjuhës amtare, metodika e përvetësimit të gjuhëve të huaja dhe metodologjia e mësimdhënies në tërësi, përfshijnë udhëzime interesante dhe të dobishme për këtë veprimtari arsimore. Komunikimi të zhvillohet në plan më të gjerë: bashkëbisedimi, dëgjimi i realizimeve programore audiovizuale me tematikë dhe me përmbajtje që lidhet me mësimin e gjuhës shqipe, por edhe me lëndë të tjera, të shprehurit me gojë dhe me shkrim, puna në grupe, në çifte, debatet, testet, intervistat, letërkëmbimi, komunikimi nëpërmjet internetit, lojërat me role, lojërat skenike (dramatizimi), hartime, ese, lojëra mësimi, pyetësori, fleta kontrolluese dhe forma të tjera të komunikimit me gojë dhe me shkrim.

Parimet kryesore metodologjike të mësimit të gjuhës shqipe janë:

- Përqendrimi në komunikim;
- Përqendrimi në gjuhën e gramatizuar;
- Përqendrimi në nxënësin dhe në të nxënit e tij;
- Loja e memories;
- Aktrimi me role individuale;
- Puna me grupe;

Roli i mësimdhënësit është i pazëvendësueshëm. Ai duhet të njohë dhe të zbatojë metodat dhe teknikat bashkëkohore të mësimdhënies.

Ai duhet të njohë mirë nxënësit, përgatitjen dhe aftësitë e tyre, prirjet për mësimin e gjuhës. Nxënësi duhet të jetë në qendër të vëmendjes.

Mjetet mësimore: libri, fletorja e punës, fotografitë, kasetat disqet, vizatimet, ilustrimet, videoprojektori, materiali auditiv, videomateriali dhe mjetet e tjera të konkretizimit. Mësimdhënësi, varësisht nga njësia mësimore dhe nga qëllimet e mësimit, zgjedh mjete mësimore, me të cilat e konkretizon mësimin, nxit aktivitetin e nxënësve dhe siguron cilësinë më të lartë të realizimit të mësimit praktik. Në klasë dhe në ambiente të tjera jashtë saj, edhe nxënësit sjellin mjete të ndryshme të konkretizimit.

VLERËSIMI

Vlerësimi i punës me nxënësit dhe i suksesit në mësim ka rëndësi të madhe. Mësimdhënësi në vazhdimësi duhet të vlerësojë:

- * Vlerësimi i njohurive dhe i shkathtësive (të folurit, leximi, shkrimi, komunikimi me gojë dhe me shkrim) të klasë së shtatë

- * Njohuritë që kanë fituar nxënësit: në ç`shkallë kanë zotëruar fjalorin dhe sa është i aftë nxënësi t`i përdorë shkathtësitë gjuhësore gjatë komunikimit
- * Angazhimin e nxënësve në procesin e mësimin
- * Përvetësimin e njohurive nga nxënësit e klasës së tetë (niveli i parë, niveli i dytë dhe niveli i tretë)
- * Suksesi i kënaqshëm, i arritur me të gjithë nxënësit e klasës, por edhe me secilin nxënë.
- * Ecuritë e vulltshme, por edhe ato të pavulltshme të mësimin, identifikohen vështirësitë, pengesat, shqyrtohen problemet e veçanta të mësimdhënies, të përdorimit të mjeteve të konkretizimit etj., dhe ndërmerren masa për përmirësimin i nivelit të mësimin të gjuhës shqipe, që nxënësit të flasin, të lexojnë dhe të shkruajnë lirshëm dhe të arrijnë sukses sa më të mirë në mësim dhe në komunikim të përditshëm në shkollë dhe në ambiente të tjera.
- * Mësimdhënësi vlerëson drejtshqiptimin e tingujve dhe të fjalëve, leximin dhe shkrimin e teksteve, fjalorin e nxënësve dhe në tërësi vlerëson shkathtësinë e komunikimit. Po ashtu vlerëson edhe shkallën e përvetësimin të njohurive të tjera plotësuese, që lidhen me programin e kësaj lënde mësimore.
- * Me vlerësimin e gjithanshëm dhe të vazhdueshëm mësimdhënësi synon të përmirësojë nivelin e mësimin. Vlerësimi i drejtpërdrejtë bëhet gjatë orëve të zhvillimit të orëve të mësimin dhe sidomos gjatë përforsimit të njësive mësimore, ndërsa vlerësimi indirekt bëhet me anë të testeve, të diktimit dhe të hartimit me shkrim.
- * Vlerësimi apo vetëvlerësimi bëhet edhe nga nxënësit. Ata e pyesin njëri tjetrin, përgjigjen dhe bëjnë vlerësimin e njohurive dhe shkallën e aftësimin për komunikim në gjuhën shqipe.
- * Vlerësimi përfshin: leksikun, radhitjen e fjalëve në fjali, të shprehurit me gojë, leximin, të shprehurit me shkrim, aftësinë e komunikimit, pyetjet dhe përgjigjet,, shqiptimin e tingujve dhe të fjalëve, komunikimin aktiv, angazhimin individual dhe në grupe gjatë procesit të mësimin etj.

LITERATURA

Plani dhe programi mësimor *Gjuhë shqipe* për nxënësit e komuniteteve joshqiptare për klasën 3,6,7,10,11, MASHT, Prishtinë, 2004

Plani dhe programi mësimor 7, MASHT, Prishtinë, 2004

Gjuhë shqipe 7, Libri Shkollor, Prishtinë, 1997

Musai, Bardhyl: Metodologjia e mësimdhënies, Tiranë, 2003

Teksti i klasës së tetë që do të hartohet mbi bazë të programit të ri

Tekstet ekzistuese të gjuhës shqipe që i plotësojnë kërkesat e këtij programi

GJUHË SHQIPE

9

HYRJE

Lënda mësimore Gjuhë shqipe për klasën e nëntë- për nxënësit e komuniteteve joshqiptare të Kosovës, përfshihet në lëmin *Gjuhët dhe komunikimi* dhe ka rëndësi të madhe për mësimin e gjuhës shqipe, për formimin kulturor dhe për komunikimin me gojë dhe me shkrim të nxënësve. Mësimi i shqipes në shkollën e mesme të ulët synon të zhvillojë dijet dhe shkathtësitë për komunikim, të sigurojë mundësi për komunikim brenda shoqërisë kosovare dhe më gjerë, për arsimim të gjithanshëm, për bashkëpunim dhe për qëllime të tjera shumë të dobishme për jetë dhe për veprimtari kulturore dhe shoqërore.

Gjatë hartimit të këtij programi mësimor janë marrë parasysh nivelet e përcaktuara në “*Kornizën e përbashkët evropiane të raportit mbi gjuhët*”, të miratuar dhe të publikuar nga Këshilli i Evropës (2001), kërkesat dhe kushtet e shkollimit të nxënësve dhe disa programe mësimore për gjuhën e dytë.

Përmbajtjet e programit të lëndës mësimore *Gjuhë shqipe 9* janë të përshtatshme dhe u përgjigjen moshës së nxënësve. Ecuria e mësimit në tërësi zgjon interesimin e tyre për ta përvetësuar gjuhën në mënyrë funksionale: të vazhdojnë mësimin e gjuhës shqipe, të përvetësojnë më mirë njohuritë e fituara më parë, në mënyrë graduale të fitojnë njohuri të reja, të pasurojnë fjalorin, të përdorin fjalë dhe shprehje nga jeta e përditshme, nga jeta shkollore dhe nga tekstet letrare dhe joletrare. Të aftësohen për të përdorur forma të ndryshme të komunikimit, të pyesin dhe të përgjigjen rrjedhshëm me gojë dhe me shkrim, të komunikojnë lehtë, të flasin, të lexojnë dhe të shkruajnë. Programi përfshin këto kategori programore: Të dëgjuarit dhe të folurit, Të lexuarit, Të shkruarit dhe Njohuri gjuhësore. Në kuadër të çdo kategorie përfshihen edhe nënkategoritë e programit të Gjuhës shqipe.

QËLLIMI

Qëllimi i mësimit të Gjuhës shqipe në klasën e nëntë për nxënësit e komuniteteve joshqiptare është përforcimi dhe zhvillimi i njohurive të përvetësuar më parë në arsimin fillor dhe sidomos në klasën e tetë, si edhe përvetësimi i njohurive dhe i shkathtësive të reja të gjuhës shqipe dhe të komunikimit.

- Nxënësit të kuptojnë dhe të përdorin fjalë dhe shprehje nga jeta e përditshme, nga jeta shkollore, nga aktivitetet e tjera kulturore dhe shoqërore. Të aftësohen të përdorin shprehje të llojllojshme, me të cilat begatojnë komunikimin e duhur për plotësimin e nevojave konkrete të komunikimit dhe për formimin kulturor;
- Zhvillimi i aftësive për të komunikuar me gojë dhe me shkrim në shkollë, jashtë shkollës dhe në aktivitete të tjera;
- Përjetimi artistik i krijimeve të zgjedhura letrare dhe artistike;
- Nxënësit të inkurajohen të marrin pjesë në aktivitete arsimore, kulturore dhe shoqërore;
- Të njohin gjuhën shqipe, veçoritë e saj dhe shkurtimisht të njohin origjinën dhe zhvillimin e saj;
- Realizimi i objektivave të përgjithshëm dhe specifike që parashihen për mësimin e gjuhës shqipe si lëndë mësimore për komunitete joshqiptare, siç janë: aftësimi i nxënësve për të folur, për të lexuar dhe për të shkruar gjuhën shqipe;
- Bashkëpunimi i mirë midis nxënësve dhe shoqërimi, respektimi i gjuhës shqipe dhe i gjuhëve të tjera, motivimi për ta përvetësuar gjuhën shqipe dhe për ta njohur kulturën, letërsinë dhe qytetërimin shqiptar në përgjithësi.

OBJEKTIVAT E PËRGJITHSHËM

Nxënësit duhet të jenë në gjendje:

Të zhvillojnë kulturën gjuhësore

- Të flasin, të shkruajnë dhe të komunikojnë në gjuhën shqipe
- Të kuptojnë dhe të analizojnë tekste letrare dhe joletrare

Të identifikojnë

- Tekste të ndryshme dhe elemente gjuhësore
- Shkathësi të komunikimit

Të zbatojnë

- Njohuritë e fituara gjuhësore: gramatikore dhe leksikore
- Njohuritë e fituara mbi modelet e teksteve letrare dhe joletrare

Të analizojnë

- Fjalë, fjali të thjeshta dhe fjali të përbëra
- Tekste të ndryshme

Të vlerësojnë

- Pasurinë e gjuhës shqipe me fjalë dhe me shprehje gjuhësore
- Tekste letrare dhe joletrare

Të formojnë qëndrimin kritik dhe të vlerësojnë vlerat

- Të zhvillojnë aftësitë për vlerësim kritik
- Të përvetësojnë shkathësitë e komunikimit
- Të fitojnë shprehje të leximit dhe edukatë qytetare

KATEGORIA

I. TË DËGJUARIT DHE TË FOLURIT

Nënkategoritë:

- I. 1 Kulturë e të dëgjuarit dhe të folurit
- I 2 Tekste letrare dhe joletrare
- I. 3 Njohuri gjuhësore

KATEGORIA

II. TË LEXUARIT

Nënkategoritë:

- II. 1 Kulturë e të lexuarit
- II. 2 Tekste letrare dhe joletrare
- II. 3 Njohuri gjuhësore

KATEGORIA

III. TË SHKRUARIT

Nënkategoritë:

- III. 1 Kulturë e të shkruarit
- III. 2 Tekste letrare dhe joletrare
- III. 3 Njohuri gjuhësore

Vërejtje: Përmbajtjet e programit mësimor realizohen në funksion të tri kategorive kryesore:

I.1, I.2, I.3. Kulturë e të dëgjuarit dhe të folurit, Kulturë e të lexuarit, Kulturë e të shkruarit 40 orë

I.2, II.2, III.2 Tekste letrare dhe joletrare 20 orë

I.3, II.3, III.3 Njohuri gjuhësore 10 orë

Në dispozicion 4 orë

PROGRAMI NË FORMË TABELARE

Nënkategoritë: I.1, II.1 III.1	Përmbajtja	Rezultatet e pritshme
<p>* Kulturë e të dëgjuarit dhe të folurit</p> <p>* Kulturë e të lexuarit</p> <p>* Kulturë e të shkruarit</p>	<p>Viti i ri shkollor</p> <p>Flasim, pyesim dhe përgjigjemi</p> <p>Format e komunikimit në gjuhën shqipe Dëgjim i poezive të incizuara.</p> <p>Recitime të poezive të zgjedhura</p> <p>Leximi i tregimit “Luli i vocërr” të Migjenit</p> <p>Familja ime.</p> <p>Familja e ngushtë dhe e gjerë (Bashkëbisedim)</p> <p>Vizita jonë në Shtëpinë e kulturës ose në institucionet siç janë: shkolla tjetër e afërt, muzeu, teatri, biblioteka, galeria e arteve, ekspozita, kinemaja etj. (Bisedojmë për përshtypjet).</p> <p>Edukatë qytetare: përsëritje dhe urime (takime miqësore, ditëlindja dhe festat e tjera)</p> <p>Rrëfim personal për një ngjarje</p> <p>Përshkrim i bukurisë së natyrës</p> <p>Intervistë për gazetën e fëmijëve</p> <p>Ushtrime komunikimi (Fëmijët dhe shoqëria)</p> <p>Të drejtat e fëmijëve (Teksti i Konventës së OKB-së mbi të drejtat e fëmijëve).</p> <p>Dëgjimi i incizimeve nga CD-të</p> <p>Tregime në bazë të figurave</p> <p>Shkrimi i teksteve në bazë të</p>	<p>Nxënësit aftësohen të komunikojnë: të dallojnë mirë tingujt dhe fjalët, të rrëfejnë, të pyesin dhe të përgjigjen.</p> <p>Aftësohen të flasin dhe ta kuptojnë njëri tjetrin gjatë bisedës.</p> <p>Aftësohen të shprehin mendimet e veta dhe të përcjellin te të tjerët porosinë e duhura.</p> <p>Aftësohen të flasin bukur dhe të recitojnë.</p> <p>Aftësohen të lexojnë tekste letrare dhe të analizojnë tregimin.</p> <p>Bisedojnë për familjen dhe për aktivitetet e saj.</p> <p>Vizitojnë institucionet kulturore, i njohin më mirë ato dhe shpalosin përshtypjet e tyre.</p> <p>Në takimet e tyre miqësore, në festime dhe kudo tjetër, sipas rastit, përsëritjes, urojnë, shprehin gëzimin, dashurinë.</p> <p>Rrëfejnë për ngjarjet e ndryshme.</p> <p>Përshkruajnë bukurinë e natyrës</p> <p>Aftësohen të bëjnë intervista.</p> <p>Bisedojnë pozitën e fëmijëve në shoqëri.</p> <p>I njohin të drejtat e fëmijëve, ashtu siç përfshihen në Konventë.</p>

	<p>figurave Krijimi i tregimeve të thjeshta Shkrimi i eseve Përkthimi i një pjesë të tekstit Ritregimi e një pjese të zgjedhur të tekstit Diktim (Tekst i zgjedhur) Format e ndryshme të komunikimit. Komentimi i ngjarjeve të rëndësishme. Komentimi i ngjarjeve të përjetuara nga nxënësit. Pasurimi i fjalorit me fjalë të reja nga tekstet e zgjedhura letrare Recitimi i vjershave të zgjedhura Dëgjimi i realizimeve të ndryshme skenike Vendet, popujt, gjuhët dhe kulturat e tyre (Emërtimet gjuhësore)</p>	<p>Bisedojnë dhe shkruajnë për rëndësinë dhe për zbatimin e tyre. Krijojnë tregime. Shkruajnë ese. Përkthejnë dhe ritregojnë. Ritregojnë përmbajtje të zgjedhura. Aftësohen të shkruajnë tekstin e diktuar. Komunikojnë në mënyra të ndryshme. Komentojnë ngjarjet e përjetuara. Përvetësojnë fjalë të reja. Recitojnë vjersha të zgjedhura. dhe realizojnë dialog. Emërtojnë vendet, popujt dhe gjuhët e tyre. Njohin disa veçori të kulturave të tyre.</p>
Nënkategoritë: I.2, II.2 III.3	Përmbajtja	Rezultatet e pritshme
*Tekste letrare dhe joletrare	<p>Letërsi shqipe dhe letërsi botërore për fëmijë: poezi, poema (Fragmente), tregime, roman (Fragment), pjesë dramatike (Fragment). Rrëfimi ; Nga krijimtaria popullore: përralla, fabula, poezi; Analizë e romanit të lexuar; Personazhi letrar; Test Analiza dhe vlerësimi i testit; Artikuj nga gazetatat dhe revistat për fëmijë; Përshkrimi i fenomeneve të natyrës ;</p>	<p>- Nxënësit lexojnë dhe komentojnë tekste letrare dhe era joletrare; -Njohin veçoritë themelore të veprave letrare: lirika, epika, drama; -Fitojnë njohuri për gjinitë dhe llojet letrare, për letërsinë popullore dhe për letërsinë e shkruar; Rrëfejnë për ngjarjet; Flasin për personazhet letrare; -Flasin dhe shkruajnë disa fjali për vlerat artistike të veprës;</p>

	<p>Krijimi letrar (veçoritë kryesore); Gjuha e figurshme. Konkretizimi me tekste letrare.</p> <p>Gjuha e pa figurshme. Konkretizimi me tekste të të folurit të përditshëm në familje, në shkollë dhe në shoqëri. Shprehja e mendimit të lirë.</p> <p>Mendimi vlerësues për aktivitete arsimore dhe kulturore në shkollë (Bashkëbisedim)</p>	<p>Bëjnë testin dhe e korrigjojnë;</p> <p>Lexojnë literaturë të zgjedhur dhe duke lexuar përjetojnë kënaqësinë estetike;</p> <p>Bëjnë përshkrimin e natyrës</p> <p>-Shprehin mendimet e tyre dhe komunikojnë me gojë dhe me shkrim.</p> <p>Përdorin gjuhën standarde shqipe.</p> <p>Paraqesin mendimin vlerësues për aktivitete arsimore dhe kulturore në shkollë.</p>
Nënkategoritë: I.3, II.3, III.3	Përmbajtja	Rezultatet e pritshme
*Njohuri gjuhësore	<ul style="list-style-type: none"> -Gjuha e folur -Gjuha e shkruar - Zgjerimi i fjalive me fjalë të reja -Shumësi i emrave dhe përshtatja e foljeve në fjali - Shkrimi i emrave gjeografikë - Shumësi i mbiemrave -Ushtrime të zgjedhimit të foljeve - Lakimi i përemrave -Numërorët - Ushtrime gramatikore (Koha e tashme, koha e shkuar dhe koha e ardhshme) -Ligjërimit -Tregimi dhe ritregimi -Ligjërata e drejtë - Ligjërata e zhdrejtë. - Përdorimi i shenjave të pikësimit - Sintaksa e fjalisë (Ushtrime të foluri dhe ushtrime shkrimi) 	<p>Nxënësit aftësohen të flasin gjuhën standarde. Ata dallojnë të folmet dialektore.</p> <p>Plotësojnë fjalitë me gjymtyrë të tjera.</p> <p>Përshtatin shumësin e emrave me trajtat e foljeve. Shkruajnë emrat gjeografikë.</p> <p>Mësojnë shumësin e mbiemrave, zgjedhimin e foljeve dhe lakimin e përemrave.</p> <p>Përdorin drejt numërorët</p> <p>Njohin format e ligjërimit</p> <p>Aftësohen të tregojnë dhe ta ritregojnë</p> <p>Njohin ligjëratën e drejtë dhe të zhdrejtë</p> <p>Përdorin shenjat e pikësimit</p> <p>Aftësohen të shprehin mendimet me fjali të plota.</p>

	<p>-Fjalë e thjeshtë pohore. -Fjalë e thjeshtë mohore. -Fjalë e përbërë mohore. -Fjalë e përbërë pohore. Periudha (Zgjedhja e shembujve nga tekstet letrare dhe joletrare. Hartim (Tema e lirë) Korrigjim i hartimit. Struktura e fjalëve dhe fjalive. Pjesët e pandryshueshme të ligjëratës Ndajfolja Parafjala Pashirra</p> <p>Si të pyesim dhe të përgjigjemi? Si të kontaktojmë me të tjerët dhe të bisedojmë? Si t'i shprehim pikëpamjet tona? Si t'i shprehim ndjenjat tona? Si t'i shprehim mendimet, dëshirat, kërkesat tona? Si të bëjmë vërejtje a kritikë? Si të përshkruajmë ? Si të argumentojmë? Si të hartojmë një raport? Ushtrime komunikimi me shkrim dhe me gojë, duke pasuruar fjalorin e përdorur dhe duke zbatuar drejtshqiptimin dhe drejtshkrimin e shqipes.</p>	<p>Përdorin fjalitë e thjeshta dhe të përbëra (pohore dhe mohore) Aftësohen të shprehin mendimet duke formuar periudhën Bëjnë hartim të lirë dhe korrigjojnë gabimet. Analizojnë fjalët dhe fjalitë (dallojnë pjesët përbërëse) Përdorin pjesët e pandryshueshme të ligjëratës. Aftësohen të shtrojnë pyetje dhe të përgjigjen. Aftësohen të komunikojnë me të tjerët, të shqyrtojnë së bashku çështje të ndryshme, të shprehin pikëpamjet e veta, të shprehin disponimin dhe ndjenjat Shprehin mendimet, bëjnë kërkesat, bëjnë vërejtje dhe kritikë të duhur.. Aftësohen të bëjnë përshkrime, të argumentojnë. Hartojnë raport lidhur me punën e klasës Përsosin komunikimin me gojë dhe me shkrim, pasurojnë fjalorin dhe zbatojnë drejtshkrimin e gjuhës shqipe.</p>
--	--	---

Njësitë mësimore realizohen sipas planit dhe programit mësimor, varësisht nga numri i përgjithshëm i orëve mësimore. Parashihen orët për njësitë e reja mësimore dhe ato për përsëritje dhe përforcim të lëndës së mësuar më parë.

Nga këto tema mësimdhënësi i zgjedh disa prej tyre: për bashkëbisedim, për lexim për detyra me shkrim dhe për komunikim. Ai

mund të përfshijë edhe vetë disa tema, për të cilat nxënësit tregojnë interesim të veçantë dhe mund të zhvillojnë edhe aktivitete plotësuese (fletushka e nxënësve, gazeta e murit, përgatitja e recitimeve, rolet skenike etj.).

LIDHJA NDËRLËNDORE

Mësimi i Gjuhës shqipe në klasën e nëntë për nxënësit e komuniteteve joshqiptare ka rëndësi të madhe, sepse ofron mundësi për lidhje programore dhe ndërlëndore. Nxënësit e përvetësojnë gjuhën shqipe dhe njëkohësisht fitojnë njohuri të reja ose i përforcojnë ato, nga fushat e tjera të dijës dhe të komunikimit. Lidhja ndërlëndore me mësimin e gjuhëve të tjera është më e theksuar: me mësimin e gjuhës amtare, me mësimin e gjuhës së huaj etj. Programi mësimor i kësaj lënde përfshin përmbajtje të ndryshme nga fushat e tjera programore, siç janë: Artet, Shkencat shoqërore, Shkencat e natyrës, Edukata fizike dhe sportet, Edukata qytetare etj.

Nxënësit njihen edhe me lëndë të tjera, në të cilat përfshihen tema interesante siç janë: të drejtat e fëmijës, të drejtat e njeriut, parimet e shoqërisë demokratike, miqësia, mirëkuptimi, toleranca, solidariteti dhe mirëqenia, shëndetësia, ruajtja e ambientit, kultura teknike etj.

METODOLOGJIA

Për të realizuar me sukses programin e lëndës Gjuhë shqipe për nxënësit e komuniteteve joshqiptare (klasa IX) kërkohet zbatimi i metodologjisë bashkëkohore të mësimdhënies së gjuhëve, i metodave dhe i teknikave mësimore. Metodika e mësimin të gjuhës amtare, metodika e përvetësimit të gjuhëve të huaja dhe metodologjia e mësimdhënies në tërësi, përfshijnë udhëzime interesante dhe të dobishme për këtë veprimtari arsimore. Komunikimi të zhvillohet në plan më të gjerë: bashkëbisedimi, dëgjimi i realizimeve programore audiovizuele me tematikë dhe me përmbajtje që lidhet me mësimin e gjuhës shqipe, por edhe me lëndë të tjera, të shprehurit me gojë dhe me shkrim, puna në grupe, në çifte, debatet, testet, intervistat, letërkëmbimi, komunikimi nëpërmjet internetit, lojërat me role, lojërat skenike (dramatizimi), hartime, ese, lojëra mësimi, pyetësori, fleta kontrolluese dhe forma të tjera të komunikimit me gojë dhe me shkrim.

Parimet kryesore metodologjike të mësimit të gjuhës shqipe janë:

- Përqendrimi në komunikim;
- Përqendrimi në gjuhën e gramatizuar;
- Përqendrimi në nxënësin dhe në të nxënit e tij;
- Aktrimi me role individuale;
- Puna me grupe;

Roli i mësimit është i pazëvendësueshëm. Ai duhet të njohë dhe të zbatojë metodat dhe teknikat bashkëkohore të mësimit.

Ai duhet të njohë mirë nxënësit, përgatitjen dhe aftësitë e tyre, prirjet për mësimin e gjuhës. Nxënësi duhet të jetë në qendër të vëmendjes.

Mjetet mësimore: libri, fletorja e punës, fotografite, kasetat disqet, vizatimet, ilustrimet, videoprojektori, materiali auditiv, videomateriali dhe mjetet e tjera të konkretizimit. Mësimit, varësisht nga njësia mësimore dhe nga qëllimet e mësimit, zgjedh mjetet mësimore, me të cilat konkretizon mësimin, nxit aktivitetin e nxënësve dhe siguron cilësinë më të lartë të realizimit të mësimit praktik. Në klasë dhe në ambiente të tjera jashtë saj edhe nxënësit sjellin mjetet e ndryshme të konkretizimit.

VLERËSIMI

Vlerësimi i punës me nxënësit dhe i suksesit në mësime ka rëndësi të madhe. Mësimit në vazhdimësi duhet të vlerësojë:

- * Përvetësimin e njohurive dhe të shkathtësive (të folurit, leximi, shkrimi, komunikimi me gojë dhe me shkrim)
- * Njohuritë që kanë fituar nxënësit: në ç`shkallë kanë zotëruar fjalorin dhe sa është i aftë nxënësi t`i përdorë shkathtësitë gjuhësore gjatë komunikimit
- * Angazhimin e nxënësve në procesin e mësimit
- * Përvetësimin e njohurive nga nxënësit e klasës së nëntë (niveli i parë, niveli i dytë dhe niveli i tretë)
- * Suksesi i kënaqshëm, i arritur me të gjithë nxënësit e klasës, por edhe me secilin nxënë.

- * Ecuritë e volitshme, por edhe ato të pavolitshme të mësimit, identifikohen vështirësitë, pengesat, shqyrtohen problemet e veçanta të mësimdhënies, të përdorimit të mjeteve të konkretizimit etj., dhe ndërmerren masa për përmirësimin i nivelit të mësimit të gjuhës shqipe, që nxënësit të flasin, të lexojnë dhe të shkruajnë lirshëm dhe të arrijnë sukses sa më të mirë në mësim dhe në komunikim të përditshëm në shkollë dhe në ambiente të tjera.
- * Mësimdhënësi vlerëson drejtshqiptimin e tingujve dhe të fjalëve, leximin dhe shkrimin e teksteve, fjalorin e nxënësve dhe në tërësi vlerëson shkathtësinë e komunikimit. Po ashtu vlerëson edhe shkallën e përvetësimit të njohurive të tjera plotësuese, që lidhen me programin e kësaj lënde mësimore.
- * Me vlerësimin e gjithanshëm dhe të vazhdueshëm mësimdhënësi synon të përmirësojë nivelin e mësimit. Vlerësimi i drejtpërdrejtë bëhet gjatë orëve të zhvillimit të orëve të mësimit dhe sidomos gjatë përfundimit të njësive mësimore, ndërsa vlerësimi indirekt bëhet me anë të testeve, të diktimit dhe të hartimit me shkrim.
- * Vlerësimi apo vetëvlerësimi bëhet edhe nga nxënësit. Ata e pyesin njëri tjetrin, përgjigjen dhe bëjnë vlerësimin e njohurive dhe shkallën e aftësisë për komunikim në gjuhën shqipe.
- * Vlerësimi përfshin: leksikun, radhitjen e fjalëve në fjali, të shprehurit me gojë, leximin, të shprehurit me shkrim, aftësinë e komunikimit, pyetjet dhe përgjigjet, shqiptimin e tingujve dhe të fjalëve, komunikimin aktiv, angazhimin individual dhe në grupe gjatë procesit të mësimit etj.

LITERATURA

Plani dhe programi mësimor *Gjuhë shqipe* për nxënësit e komuniteteve joshqiptare për klasën 3,4,5,6,7,8, , MASHT, Prishtinë.

Gjuhë shqipe 7, Libri Shkollor, Prishtinë, 1997

Teksti i klasës së nëntë, që do të hartohet mbi bazë të programit të ri

Tekstet ekzistuese të gjuhës shqipe dhe tekstet në gjuhët e tjera që i plotësojnë kërkesat e këtij programi.

GJUHË SHQIPE

10

HYRJE

Lënda mësimore *Gjuhë shqipe* - për nxënësit e klasës së dhjetë të komuniteteve joshqiptare të Kosovës përfshihet në planin dhe programin mësimor të shkollës së mesme të lartë. Mësimi i shqipes në të gjitha nivelet e shkollimit synon të sigurojë mundësi për komunikim brenda shoqërisë kosovare dhe më gjerë, për arsimim të gjithanshëm, për bashkëpunim dhe për qëllime të tjera shumë të dobishme për jetë dhe për veprimtari kulturore, shoqërore dhe ekonomike. Në këtë shkallë të arsimit të mesëm mësimi i Gjuhës shqipe është në funksion të komunikimit dhe të përvetëtimit të njohurive më të gjithanshme të kulturës gjuhësore dhe letrare.

Përmbajtjet e programit të lëndës mësimore *Gjuhë shqipe* janë mjaft të pasura në aspektin tematik dhe të problematikës së mësimin të gjuhës shqipe. Ato zhvillohen në ecurinë e përshtatshme, që kërkohet për mësimin efikas dhe të gjithanshëm. Lënda e mësimin të gjuhës në tërësi zgjon intersimin e nxënësve, për ta përvetësuar gjuhën në mënyrë funksionale: të flasin, të lexojnë, të shkruajnë dhe të përvetësojnë njohuri gjuhësore. Programi përfshin këto kategori kryesore: Të dëgjuarit dhe të folurit, Të lexuarit dhe Të shkruarit. Në kuadër të kategorive kryesore përfshihen nënkategoritë: Kulturë e të dëgjuarit dhe të folurit, Kulturë e të lexuarit, Kulturë e të shkruarit, Tekste letrare dhe joletrare dhe Njohuri gjuhësore. Plani mësimor e përcakton edhe vëllimin e tërësishëm të përmbajtjeve të programit mësimor. Ecuria e realizimit të programit mësimor, duke pasur parasysh faktin se disa nxënës gjuhën shqipe e njohin më mirë, ndërsa të tjerët ndoshta këtë gjuhë s`e kanë mësuar më parë, është mjaft komplekse dhe specifike. Për mësimin e gjuhës shqipe parashihen nivelet adekuate për klasat e shkollës së mesme të lartë.

QËLLIMI

Qëllimi i mësimit të Gjuhës shqipe në klasën e dhjetë për nxënësit e komuniteteve joshqiptare është:

- Përforcimi i lëndës së zhvilluar më parë në arsimin fillor dhe në arsimin e mesën të ulët;
- Përvetësimi i njohurive dhe i shkathtësive të reja gjuhësore, letrare dhe të fushave të tjera ndërlëndore;
- Nxënësit të flasin, të lexojnë dhe të shkruajnë në nivelin e duhur;
- Të kuptojnë mirë përmbajtje të ndryshme tekstesh letrare dhe jo-letrare;
- Të aftësohen të përdorin fjalë dhe shprehje nga jeta e përditshme, nga veprimtaritë arsimore, kulturore, ekonomike dhe shoqërore;
- Të përdorin fjalë dhe shprehje të ndryshme të terminologjisë;
- Të analizojnë dhe të komentojnë përmbajtje të zgjedhura dhe në këtë mënyrë të plotësojnë kërkesat konkrete për komunikim aktiv;
- Zhvillimi i aftësive për të komunikuar me gojë dhe me shkrim në shkollë, jashtë shkollës dhe në aktivitete të tjera;
- Përjetimi artistik i krijimeve të zgjedhura letrare dhe artistike;
- Përvetësimi i njohurive gramatikore;
- Realizimi i objektivave të përgjithshëm dhe specifikë, që parashi-hen për mësimin e Gjuhës shqipe si lëndë mësimore për nxënësit e komuniteteve joshqiptare, ashtu siç janë përfshirë në nënkategoritë kryesore dhe në këtë program mësimor;
- Bashkëpunimi i mirë midis nxënësve dhe shoqërimi;
- Zbatimi i njohurive të gjuhës shqipe dhe të kulturës shqiptare;
- Edukimi i nxënësve në frymën e mirëkuptimit, të tolerancës dhe të respektimit të njëri-tjetrit.

OBJEKTIVAT E PËRGJITHSHËM

Nxënësit duhet të jenë në gjendje:

- Të zhvillojnë kulturën gjuhësore të mjedisit dhe aftësitë e komunikimit;
- Të flasin, të shkruajnë dhe të komunikojnë në gjuhën shqipe;
- Të kuptojnë dhe të analizojnë tekste letrare dhe joletrare;

Të identifikojnë:

- Tekste të ndryshme dhe elemente gjuhësore;
- Shkathtësi të komunikimit;

Të zbatojnë:

- Njohuritë e fituara gjuhësore: gramatikore dhe leksikore;
- Njohuritë e fituara mbi modelet e teksteve letrare dhe joletrare;

Të analizojnë:

- Fjalë, fjali të thjeshta dhe fjali të përbëra;
- Tekste të ndryshme;

Të vlerësojnë:

- Pasurinë e gjuhës shqipe me fjalë dhe me shprehje gjuhësore;
- Tekste letrare dhe joletrare;

Të formojnë qëndrimin kritik dhe të vlerësojnë vlerat:

- Të zhvillojnë aftësitë për vlerësim kritik;
- Të përvetësojnë shkathtësitë e komunikimit;
- Të fitojnë shprehi të leximit dhe edukatë qytetare.

KATEGORIA

I. TË DËGJUARIT DHE TË FOLURIT

Nënkategoritë:

- I. 1. Kulturë e të dëgjuarit dhe të folurit
- I. 2. Tekste letrare dhe joletrare
- I. 3. Njohuri gjuhësore

KATEGORIA

II. TË LËXUARIT

Nënkategoritë:

- II. 1. Kulturë e të lexuarit
- II. 2. Tekste letrare dhe joletrare
- II. 3. Njohuri gjuhësore

KATEGORIA

III. TË SHKRUARIT

Nënkategoritë:

- III. 1. Kulturë e të shkruarit
- III. 2. Tekste letrare dhe joletrare
- III. 3. Njohuri gjuhësore

Vërejtje: Përmbajtjet e programit mësimor realizohen në funksion të të tri kategorive kryesore:

- I.1, I.2, I.3. Kulturë e të dëgjuarit dhe të folurit, Kulturë e të lexuarit, Kulturë e të shkruarit 40 orë
- I.2, II.2, III.2. Tekste letrare dhe joletrare 20 orë
- I.3, II.3, III.3. Njohuri gjuhësore 14 orë

PROGRAMI

Nënkategoritë: I.1, II.1 III.1	Përmbajtja	Rezultatet e pritshme
<p>* Kulturë e të dëgjuarit dhe të folurit</p> <p>* Kulturë e të lexuarit</p> <p>* Kulturë e të shkruarit</p>	<p>Bashkëbisedimi, komentimi, argumentimi dhe analiza e krijimeve letrare dhe e teksteve joletrae;</p> <p>Dëgjimi i dialogëve të incizuar dhe i teksteve të tjera;</p> <p>Mënyra të paraqitjes së ngjarjeve: ligjërimi, tregimi, ligjërata e drejtë, ligjërata e zhdrejtë, ligjërata e zhdrejtë e lirë, dialogu, citati;</p> <p>Bisedë për ngjarjet aktuale në shoqëri dhe për aktivitete të tjera;</p> <p>Dëgjimi i veprave ske-nike dhe filmike;</p> <p>Forma të ndryshme të komunikimit: dialogu, monologu.</p> <p>Leximi i teksteve let-rare (poezi, prozë, tek-ste të zgjedhura dra-matike) dhe i teksteve joletrare;</p> <p>Analiza e krijimit let-rar;</p> <p>Fjalë të urta;</p> <p>Gjëegjëza;</p> <p>Dokumentet më të her-shme të gjuhës shqipe (lexim i një frag-menti);</p> <p>Dialektet e gjuhës shqipe;</p> <p>Ushtrime leksikore;</p>	<p>- Nxënësit flasin mirë dhe lir-shëm, kuptojnë përmbajtjet e lexuara;</p> <p>-Pasurojnë leksikun dhe format e shprehjes në gjuhën e sotme shqipe;</p> <p>- Përvetësojnë disa mënyra të paraqitjes së ngjarjeve: ligjëri-min, tregimin, ligjëratën e drejtë, ligjëratën e zhdrejtë, dialogun;</p> <p>- Bisedojnë për ngjarjet aktuale;</p> <p>- Nxënësit dëgjojnë me vëmën-dje dhe kuptojnë pjesë të zgjedhura letrare dhe joletrare, recitime, dialogë, monologë, përmbajtje dhe paraqitje të ndryshme tonike;</p> <p>- Nxënësit flasin rrjedhshëm dhe komunikojnë me të tjerët;</p> <p>- Në mënyrë graduale përve-tësojnë drejtshqiptimin dhe drejtshkrimin e gjuhës shqipe;</p> <p>- Përvetësojnë teknikat e të folurit;</p> <p>- Pasurojnë fjalorin, recitojnë, përgatisin role të pjesëve dramatike;</p> <p>- Aftësohen për të shprehur mendimet dhe ndjenjat e tyre me gojë dhe me shkrim;</p> <p>-Nxënësit formojnë shprehinë për lexim korrekt dhe të rrjedh-shëm në gjuhën shqipe;</p> <p>- Përvetësojnë leximin, anali-zojnë tekstet letrare dhe joletrare dhe këto shkathtësi i ushtrojnë në mënyrë të vazhdueshme;</p> <p>-Krahasojnë kulturën e të shprehurit në shkollë dhe në mjedisin ku jetojnë;</p>

	<p>Ushtrime shkrimi dhe komunikimi; Tekste të zgjedhura letrare: poezi, tregime dhe tekste dramatike për fëmijë; Tekste joletrare; Hartimi i shkresave, shkrimi i dokumenteve dhe plotësimi i formularëve (kërkesa, jetëshkrimi, dëftesa, formulari për regjistrim në shkollë, shpallja, ftesa, dërgesa postare etj.); Shkrimi i ditarit; Hartimi me shkrim (temë e lirë dhe tema të caktuara nga mësimdhënësi); Korrigjimi i hartimeve dhe i detyrave me shkrim; Shkrimi i esesë.</p>	<p>-Duke lexuar, fitojnë njohuri për historinë e gjuhës shqipe, për dialektet dhe për gjuhën letrare shqipe; -Përvetësojnë shkrimin e gjuhës shqipe dhe komunikojnë me shkrim; - Nxënësit fitojnë njohuri më të plota se më parë për gjuhën dhe për letërsinë; - Hartojnë shkresa, shkruajnë dokumente dhe plotësojnë formularë të ndryshëm; - Mësojnë për disa kategori gramatikore, për të kuptuar funksionin e fjalëve në fjali dhe për të përvetësuar përdorimin e drejtë të tyre; - Nxënësit e përdorin librin e gjuhës shqipe, lexojnë shtypin, krijime letrare dhe literaturë të zgjedhur; - Shkruajnë dhe korrigjojnë shkrimet e tyre, duke e përvetësuar vazhdimisht drejtshkrimin e shqipes; -Fitojnë njohuri për funksionet gramatikore të fjalëve në fjali; - Duke njohur strukturën e fjalës dhe të fjalisë, në mënyrë graduale mësojnë për pjesët e ndryshueshme të ligjëratës dhe për pjesët e pandryshueshme të ligjëratës.</p>
Nënkategoritë: I.2, II.2 III.3	Përmbajtja	Rezultatet e pritshme
* Tekste letrare dhe joletrare	<p>Tekste letrare dhe joletrare. (Letërsi shqipe dhe letërsi botërore). Poezi, poema (fragmente), tregime, roman (fragment), pjesë</p>	<p>- Nxënësit lexojnë dhe komentojnë tekste joletrare dhe krijime artistike; -Njohin veçoritë themelore të veprave letrare; - Fitojnë njohuri për gjinitë dhe llojet letrare, për letërsinë</p>

	<p>dramatike (fragment). Tregimi; Rrëfimi në vetën e parë, rrëfimi në vetën e tretë; Nga krijimtaria popullore: përralla, fabula, poezi; Tema. Subjekti. Shrehja e figurshme dhe jo e figurshme. Artikuj nga gazetat dhe revistat për fëmijë; Përshkrimi i pamjeve të natyrës. Krijimi letrar (analizë); Gjuha e tekstit letrar dhe të folurit e përditshëm.</p>	<p>popullore dhe për letërsinë e shkruar; -Flasin dhe shkruajnë për vlerat artistike të veprës, lexojnë literaturë të zgjedhur dhe duke lexuar përjetojnë kënaqësinë estetike; -Nxënësit shprehin mendimin vlerësues për aspekte të ndryshme të veprës.</p>
Nënkategoritë: I.3, II.3, III.3	Përmbajtja	Rezultatet e pritshme
* Njohuri gjuhësore	<p>Gjuhë e folur dhe gjuhë e shkruar; Shprehje të gjuhës së folur dhe të gjuhës së shkruar; Pjesët e ndryshueshme të ligjëratës; Emri (Funksionet gramatikore që lidhen me emrin); Folja (Funksionet gramatikore që lidhen me foljen); Përemri, mbiemri, numërori; Kohët dhe mënyrat e foljes; Krahasimi i shkrimit të gjuhës shqipe dhe i shkrimit të gjuhës</p>	<p>- Mësojnë cilat janë dialektet e gjuhës shqipe; - Njohin ndryshimet e gjuhës shqipe në krahasim me gjuhën amtare; - Përvetësojnë gjuhën letrare; - Mësojnë fjalë dhe shprehje gjuhësore dhe aftësohen t`i përdorin në të shprehurit me gojë dhe me shkrim; - Mësojnë përdorimin e emrit, të përemrit, të mbiemrit, të numërorit dhe të foljes; - Dallojnë gjuhën standarde nga format dialektore; - Zbatojnë rregullat e drejtshkrimit; - Mësojnë t`i përdorin shenjat e pikësimit dhe lexojnë me intonacion;</p>

	<p>amtare (ngjashmëritë dhe dallimet); Diktimi dhe format e tjera të kombinuara të shprehjes me gojë dhe me shkrim; Formimi i fjalëve dhe i fjalive; Shkrimi i tekstit me temë të lirë; Fjalët me shumë kup-time; Fjalë nga terminologjia teknike shkencore; Ushtrime gjuhësore; Ushtrime përkthimi; Ushtrime drejtshkrimi. Zgjedhimi i foljeve (duke formuar fjali të llojeve të ndryshme); Formimi i fjalëve; Formimi i fjalive.</p>	<p>- Mësojnë formimin e fjalëve dhe të fjalive; -Njohin funksionet gramatikore që lidhen me emrin dhe me foljen; - Analizojnë fjalinë dhe gjejnë fjalët përbërëse të fjalisë; - Përvetësojnë format e drejta të folurit dhe të shkrimit; -Aftësohen të komunikojnë dhe të përkthejnë fjalë, fjali dhe tekste në gjuhën shqipe.</p>
--	--	--

Përmbajtja:

Krijime të zgjedhura letrare

(Nga letërsia shqipe dhe ajo e përgjithshme)

Llojet e poezisë lirike

Llojet e prozës

Llojet e gjinisë së dramës

Kultura tradicionale gojore dhe kultura e shkruar

Letërsia e vjetër shqipe (Veçoritë kryesore)

Në Galerinë e Arteve të Kosovës

Drama televizive

Reportazhi

Mjedisi i shkollës

Të drejtat dhe obligimet e nxënësve në shkollë

Nomenklatura e profesioneve
Brezovica (Bukuritë e natyrës, rekreacioni dhe sporti)
Të njohim Programin mësimor të shkollës së mesme të lartë
Dita e gruas (Barazia gjinore)
Kosova sot (Organet e qeverisjes)
Udhëpërshkrimi
Të pasurojmë bibliotekën
Pjesëmarrja në garat e diturisë
Konkursi letrar i shkollës sonë
Kujtime
Lektyrë shkollore (Dy vepra të zgjedhura)

Nga këto tema mësimdhënësi zgedh disa sosh: për bashkëbisedim, për lexim për detyra me shkrim dhe për komunikim. Ai mund të përfshijë edhe vetë disa tema, për të cilat nxënësit tregojnë interesim të veçantë dhe mund të zhvillojnë edhe aktivitete plotësuese: fletushka e nxënësve, gazeta e murit, përgatitja e recitimeve, rolet skenike etj.

LIDHJA NDËRLËNDORE

Mësimi i Gjuhës shqipe në klasën e dhjetë për nxënësit e komuniteteve joshqiptare ka rëndësi të madhe, sepse ofron mundësi për lidhje programore dhe ndërlëndore. Nxënësit e përvetësojnë gjuhën shqipe dhe njëkohësisht fitojnë njohuri të reja ose i përforcojnë ato, nga fushat e tjera të dijes dhe të komunikimit. Lidhja ndërlëndore me mësimin e gjuhëve të tjera është më e theksuar: me mësimin e gjuhës amtare, me mësimin e gjuhës së huaj etj. Programi mësimor i kësaj lënde përfshin përmbajtje të ndryshme nga fushat e tjera programore, siç janë: Artet, Shkencat shoqërore, Shkencat e natyrës, Edukata fizike dhe sportet, Edukata qytetare etj.

Nxënësit njihen edhe me lëndë të tjera, në të cilat përfshihen tema interesante siç janë: të drejtat e fëmijës, të drejtat e njeriut, parimet e shoqërisë demokratike, miqësia, mirëkuptimi, toleranca, solidariteti dhe mirëqenia, shëndetësia, qeverisja, ruajtja e mjedisit, kultura teknike etj.

UDHËZIME METODOLOGJIKE

Për të realizuar me sukses programin e lëndës Gjuhë shqipe për nxënësit e komuniteteve joshqiptare kërkohet zbatimi i metodologjisë bashkëkohore të mësimdhënies së gjuhëve, i metodave dhe i teknikave mësimore adekuate. Metodika e mëimit të gjuhës amtare, metodika e përvetësimit të gjuhëve të huaja dhe metodologjia e mësimdhënies në tërësi, përfshijnë udhëzime interesante dhe të dobishme për këtë veprimtari arsimore. Komunikimi të zhvillohet në plan më të gjerë: bashkëbisedimi, dëgjimi i realizimeve programore audiovizuale me tematikë dhe me përmbajtje që lidhet me mësimin e gjuhës shqipe, por edhe me lëndë të tjera, të shprehurit me gojë dhe me shkrim, puna në grupe, në çifte, debatet, testet, intervistat, letërkëmbimi, komunikimi përmes internetit, lojërat me role, lojërat skenike (dramatizimi), hartime, ese, lojëra mësimi, pyetësi, fleta kontrolluese dhe forma të tjera të komunikimit me gojë dhe me shkrim.

Parimet kryesore metodologjike të mëimit të gjuhës shqipe janë:

- Përqendrimi në komunikim;
- Përqendrimi në gjuhën e gramatizuar;
- Përqendrimi në nxënësin dhe në të nxënësit e tij;

Roli i mësimdhënësit është i pazëvendësueshën.

- Ai duhet të njohë dhe të zbatojë metodat dhe teknikat bashkëkohore të mësimdhënies.
- Ai duhet të njohë mirë nxënësit, përgatitjen dhe aftësitë e tyre, prirjet për mësimin e gjuhës. Nxënësi duhet të jetë në qendër të vëmendjes.

Mjetet mësimore: libri, fletorja e punës, fotografitë, ilustrimet, videoprojektori, materiali auditiv, videomateriali, ilustrimet dhe mjetet e tjera të konkretizimit.

VLERËSIMI

Vlerësimi i punës me nxënësit dhe i suksesit në mësim ka rëndësi të madhe. Mësimdhënësi në vazhdimësi duhet të vlerësojë:

- * Njohuritë që kanë fituar nxënësit: në ç`shkallë kanë zotëruar fjalorin dhe sa është i aftë nxënësi t`i përdorë shkathtësitë gjuhësore gjatë komunikimit;
- * Angazhimin e nxënësve në procesin e mësimit;
- * Përvetësimin e njohurive nga nxënësit e klasës së dhjetë (niveli i parë, niveli i dytë dhe niveli i tretë);
- * Suksesin e kënaqshëm, të arritur me të gjithë nënësit e klasës, por edhe me sejcilin nxënë;
- * Ecuritë e volitshme, por edhe ato të pavolitshme të mësimit, identifikohen vështirësitë, pengesat, shqyrtohen problemet e veçanta të mësimdhënies, të përdorimit të mjeteve të konkretizimit etj., dhe ndërmerren masa për përmirësimin i nivelit të mësimit të gjuhës shqipe, që nxënësit të flasin, të lexojnë dhe të shkruajnë lirshëm dhe të arrijnë sukses sa më të mirë në mësim dhe në komunikim të përditshëm në shkollë dhe në mjedise të tjera;
- * Mësimdhënësi vlerëson drejtshqiptimin e tingujve dhe të fjalëve, leximin dhe shkrimin e teksteve, fjalorin e nxënësve dhe në tërësi vlerëson shkathtësinë e komunikimit. Po ashtu vlerëson edhe shkallën e përvetësimit të njohurive të tjera plotësuese, që lidhen me programin e kësaj lënde mësimore dhe nivelin e të menduarit kritik;
- * Me vlerësimin e gjithanshëm dhe të vazhdueshëm mësimdhënësi synon të përmirësojë nivelin e mësimit. Vlerësimi i drejtpërdrejtë bëhet gjatë orëve të zhvillimit të orëve të mësimit dhe sidomos gjatë përforcimit të njësive mësimore, ndërsa vlerësimi i tërthort bëhet me anë të testeve, të diktimit dhe të hartimit me shkrim;
- * Verësimi apo vetëvlerësimi bëhet edhe nga nxënësit. Ata e pyesin njëri-tjetrin, përgjigjen dhe bëjnë vlerësimin e njohurive dhe shkallën e aftësisë për komunikim në gjuhën shqipe;
- * Vlerësimi përfshin: leksikun, radhitjen e fjalëve në fjali, të shprehurit me gojë, leximin, të shprehurit me shkrim, aftësinë e komunikimit, pyetjet dhe përgjigjet, shqiptimin e tingujve dhe të fjalëve, komunikimin aktiv, angazhimin individual dhe në grupe gjatë procesit të mësimit;
- * Vetëvlerësimi bëhet edhe nga vetë nxënësit.

LITERATURA

Libri me udhëzime për situatën me nxënësin në qendër, 2003

Plani dhe programi mësimor 10, MASHT, Prishtinë, 2004

Musai, Bardhyl: Metodologjia e mësimdhënies, Tiranë, 2003

Teksti i klasës së dhjetë, që do të hartohet mbi bazë të programit të ri

Tekstet ekzistuese të gjuhës shqipe që i plotësojnë kërkesat e këtij programi

GJUHË SHQIPE

11

HYRJE

Në kapitullin GJUHËT DHE KOMUNIKIMI të *Kornizës së kurrikulit të ri të Kosovës* (Arsimi i mesëm i lartë) përfshihet edhe lënda mësimore *Gjuhë shqipe* - për nxënësit e komuniteteve joshqiptare të Kosovës. Gjuha shqipe është gjuhë e dytë dhe ka objektiva të përgjithshëm dhe specifike. Mësimi i shqipes në të gjitha nivelet e shkollimit synon të sigurojë mundësi për komunikim brenda shoqërisë kosovare dhe më gjerë, për arsimim të gjithanshëm, për bashkëpunim dhe për qëllime të tjera shumë të dobishme për jetë dhe për veprimtari kulturore, shoqërore dhe ekonomike.

Gjatë hartimit të këtij programi mësimor janë marrë parasysh nivelet e përcaktuara në “*Kornizën e përbashkët evropiane të raportit mbi gjuhët*”, të miratuar dhe të publikuar nga Këshilli i Evropës (2001), kërkesat dhe kushtet e shkollimit të nxënësve dhe disa programe mësimore për gjuhën e dytë.

Përmbajtjet e programit të lëndës mësimore *Gjuhë shqipe* për klasën e njëmbëdhjetë janë në funksion të mësimimit efikas të gjuhës shqipe. Ecuria e mësimimit në tërësi zgjon intersimin e tyre për ta përvetësuar gjuhën në mënyrë funksionale: nxënësit arrijnë shkallë të duhur të përvetësimit të gjuhës shqipe, pasurojnë fjalorin, përmirësojnë nivelin e të shprehurit me gojë dhe me shkrim, përdorin fjalë dhe shprehje nga jeta e përditshme, por edhe fjalë e shprehje të lëndëve të tjera mësimore, nga sferat e tjera të diturisë, parashtrajnë pyetje më komplekse dhe përgjigjen në mënyrën e duhur. duke përdorur edhe një pjesë të terminologjisë teknike-shkencore. Nxënësit aftësohen të komunikojnë lehtë, të flasin, të lexojnë dhe të shkruajnë. Programi përfshin këto kategori: Të dëgjuarit dhe të folurit, Të lexuarit dhe Të shkruarit. Nënkatëgoritë e këtij programi mësimor përfshihen në pasqyrën tabelare.

QËLLIMI

Qëllimi i mësimit të Gjuhës shqipe në klasën e njëmbëdhjetë - për nxënësit e komuniteteve joshqiptare është përforcimi i njohurive të mëparshme, zhvillimi dhe përvetësimi i njohurive të reja të gjuhës shqipe dhe i shkathtësive të tjera të komunikimit.

- Nxënësit të kuptojnë fjalët, fjalitë, përmbajtjet dhe shprehjet gjuhësore dhe t'i shprehin mendimet e tyre me gojë dhe me shkrim. Të lexojnë dhe të shkruajnë në mënyrë të pavarur fjalë, fjali, dhe tekste të ndryshme;
- Të përvetësojnë fjalë dhe shprehje nga jeta e përditshme dhe të angazhohen të hartojnë tekste të ndryshme për plotësimin nevojave konkrete;
- Zhvillimi i aftësive për të komunikuar me gojë dhe me shkrim në shkollë, jashtë shollës dhe në aktivitete të tjera;
- Përjetimi artistik i krijimeve të zgjedhura letrare dhe artistike, të përshtatshme për moshën e nxënësve;
- Realizimi i objektivave të përgjithshëm dhe specifikë, që parashihen për mësimin e Gjuhës shqipe si lëndë mësimore për komunitete joshqiptare, siç janë: aftësimi i nxënësve për të folur, për të lexuar dhe për të shkruar gjuhën shqipe.
- Realizimi i këtij programi mësimor të Gjuhës shqipe, siç është theksuar në tekstin e Programit arsimor të Kosovës, "...synon të sigurojë mundësi për komunikim brenda shoqërisë kosovare, për bashkëpunim rajonal ndërkombëtar dhe për qëllime ekonomike".

OBJEKTIVAT E PËRGJITHSHËM

Nxënësit duhet të jenë në gjendje:

- Të zhvillojnë kulturën gjuhësore të mjedisit dhe aftësitë e komunikimit;
- Të flasin, të shkruajnë dhe të komunikojnë në gjuhën shqipe;
- Të kuptojnë dhe të analizojnë tekste letrare dhe joletrare;

Të identifikojnë:

- Tekste të ndryshme dhe elemente gjuhësore;
- Shkathtësi të komunikimit;

Të zbatojnë:

- Njohuritë e fituara gjuhësore: gramatikore dhe leksikore;
- Njohuritë e fituara mbi modelet e teksteve letrare dhe joletrare;

Të analizojnë:

- Fjalë, fjali të thjeshta dhe fjali të përbëra;
- Tekste të ndryshme;

Të vlerësojnë:

- Pasurinë e gjuhës shqipe me fjalë dhe me shprehje gjuhësore;
- Tekste letrare dhe joletrare;
- Të formojnë qëndrimin kritik dhe të vlerësojnë vlerat;
- Të zhvillojnë aftësitë për vlerësim kritik;
- Të përvetësojnë shkathtësitë e komunikimit;
- Të fitojnë shprehi të leximit dhe edukatë qytetare.

KATEGORIA

I. TË DËGJUARIT DHE TË FOLURIT

Nënkategoritë:

- I. 1. Kulturë e të dëgjuarit dhe të folurit
- I. 2. Tekste letrare dhe joletrare
- I. 3. Njohuri gjuhësore

KATEGORIA

II. TË LËXUARIT

Nënkategoritë:

- II. 1. Kulturë e të lexuarit
- II. 2. Tekste letrare dhe joletrare
- II. 3. Njohuri gjuhësore

KATEGORIA

III. TË SHKRUARIT

Nënkategoritë:

- III. 1. Kulturë e të shkruarit
- III. 2. Tekste letrare dhe joletrare
- III. 3. Njohuri gjuhësore

Vërejtje: Përmbajtjet e programit mësimor realizohen në funksion të të tri kategorive kryesore:

- I.1, I.2, I.3. Kulturë e të dëgjuarit dhe të folurit, Kulturë e të lexuarit, Kulturë e të shkruarit 40 orë
- I.2, II.2, III.2. Tekste letrare dhe joletrare 20 orë
- I.3, II.3, III.3. Njohuri gjuhësore 14 orë

PROGRAMI

Nënkategoritë: I.1, II.1 III.1	Përmbajtja	Rezultatet e pritshme
* Kulturë e të dëgjuarit dhe të folurit * Kulturë e të lexuarit * Kulturë e të shkruarit	Gjuha shqipe e folur dhe gjuha e shkruar (Dëgjimi i të folmeve dhe krahasimi i tyre: ngjashmëritë dhe dallimet); Përmbajtja e tekstit, identifikimi i fjalorit dhe i shprehjeve gjuhësore; Gjuha letrare dhe gjuha e	- Nxënësit dëgjojnë me vëmendje dhe kuptojnë pjesë të zgjedhura, recitime, dialogë, monologë, përmbajtje dhe paraqitje të ndryshme tonike; - Nxënësit flasin, lexojnë, shkruajnë dhe aftësohen për komunikim;

	<p>letërsisë; Forma të ndryshme të komunikimit: dialogu, monologu; Leximi i fragmenteve të teksteve të zgjedhura letrare: poezi, tregime dhe tekste dramatike; Identifikimi dhe krahasimi i teksteve letrare dhe joletrare; Kultura shqiptare dhe krahasimi i saj me kulturat e tjera; Krahasimi i teksteve të zgjedhura letrare dhe joletrare (Përmbajtja, motivet, temat, idetë, personazhet, figurat dhe shprehja letrare figurative, kompozicioni, veçoritë stilistike dhe gjuhësore); Shkrimi i përmbajtjes së tekstit të lexuar më parë; Përmirësimi i shkrimit; Analiza e shkrimit, interpretimi dhe vlerësimi; Hartimi me shkrim; Korrigjimi i tekstit të shkruar; Përkthimi i tekstit duke përdorur fjalorët.</p>	<ul style="list-style-type: none"> - Përvetësojnë forma të ndryshme komunikimi; - Njohin dallimet midis gjuhës së folme dhe gjuhës së shkruar shqipe; -Përvetësojnë drejtshqiptimin dhe drejtshkrimin e gjuhës shqipe; -Përvetësojnë teknikat e të folurit; -Krahasojnë kulturën shqiptare me kulturat e tjera; - Pasurojnë fjalorin, recitojnë, përgatisin role të pjesëve dramatike; - Aftësohen për të shprehur mendimet e tyre me gojë dhe me shkrim; - Krahasojnë tekstet letrare dhe joletrare; - Shkruajnë për përmbajtjen e tekstit, analizojnë, interpretojnë dhe vlerësojnë tekstin; - Korrigjojnë gabimet në të folur dhe në tekstin e shkruar
Nënkategoritë: I.2, II.2 III.3	Përmbajtja	Rezultatet e pritshme
*Tekste letrare dhe joletrare	<p>Tekste letrare dhe joletrare (Letërsi shqipe dhe letërsi botërore): poezi, poema (fragmente), tregime, roman (fragment), pjesë dramatike (fragment). Tregimi i shkurtër; Nga krijimtaria popullore: përralla, fabula, poezi; Të kuptuarit e teksteve të</p>	<ul style="list-style-type: none"> - Nxënësit identifikojnë tekstet joletrare dhe krijimet artistike. -Njohin veçoritë themelore të veprave letrare; - Fitojnë njohuri për gjinitë dhe llojet letrare, për letërsinë popullore dhe për letërsinë e shkruar; - Flasin dhe shkruajnë për

	<p>zgjdhura letrare dhe jolet-rare (Përmbajtja, motivet, temat, idetë, personazhet, figurat dhe shprehja letrare figurative, kompozicioni, veçoritë stilistike dhe gjuhësore);</p> <p>Artikuj nga gazetatat dhe revistat për fëmijë;</p> <p>Përshkrimi i pamjeve të natyrës;</p> <p>Krijimi letrar (Veçoritë kryesore) Gjuha e tekstit letrar dhe të folurit e përditshëm.</p>	<p>vlerat artistike, lexojnë literaturë të zgjedhur dhe duke lexuar përjetojnë kënaqësinë estetike;</p> <p>-Nxënësit shprehin mendimin vlerësues për aspekte të ndryshme të veprës.</p>
Nënkategoritë I.3, II.3, III.3	Përmbajtja	Rezultatet e pritshme
* Njohuri gjuhësore	<p><i>Drejtshkrimi:</i> shkrimi i datave, emrat gjeografikë, theksi, apostrofi, shkrimi i fjalëve njësh, ndaras dhe me vizë në mes, ndarja e fjalëve në fund të rreshtit;</p> <p>Rregullat e pikësimit;</p> <p>Pjesët e pandryshueshme të ligjëratës: ndajfolja, lidhëza, pjesëza dhe pasthirma;</p> <p>Sintaksë (Tipat e fjalisë dhe strukturat e tyre);</p> <p>Rendi i fjalëve në fjali;</p> <p>Ushtrime gjuhësore;</p> <p>Ushtrime përkthimi.</p>	<p>- Nxënësit përvetësojnë drejtshkrimin e gjuhës shqipe;</p> <p>- Njohin dhe i zbatojnë rregullat e pikësimit;</p> <p>- Mësojnë për pjesët e pandryshueshme të ligjëratës dhe zbatojnë përdorimin e drejtë të tyre;</p> <p>- Në lëmin e sintaksës njohin tipat e fjalisë dhe strukturat e tyre;</p> <p>- Përvetësojnë renditjen e drejtë të fjalëve në fjali;</p> <p>- Përvetësojnë gjuhën letrare;</p> <p>-Mësojnë fjalë dhe shprehje gjuhësore dhe aftësohen t'i përdorin në të shprehurit me gojë dhe me shkrim;</p> <p>-Dallojnë gjuhën standarde nga format dialektore</p> <p>- Zbatojnë rregullat e drejtshkrimit;</p> <p>- Aftësohen të bëjnë ushtrime gjuhësore dhe të bëjnë korrigjimin e gabimeve;</p> <p>- Aftësohen për përkthimin e teksteve të shkruara.</p>

Njësitë mësimore realizohen sipas planit dhe programit mësimor, varësisht nga numri i përgjithshëm i orëve mësimore. Parashihen orët për njësitë e reja mësimore dhe ato për përsëritje dhe përforsim të lëndës së mësuar më parë.

Përmbajtja

Poezi të zgjedhura

Tregime të zgjedhura

Novela (fragment)

Romani (fragment)

Teatri Kombëtar i Kosovës

Udhëtim fantastik

Në Muzeun e Kosovës

Muzika shqiptare

Sporti më i dashur

Gazetat dhe revistat shqiptare

Programi i gjuhës shqipe në RTK

Shkrimtarë të shquar të letërsisë botërore

Festat

Ditëlindja ime

Si e mësova gjuhën shqipe

Prishtina- kryeqyteti i Kosovës

Letërsia shqipe

Interneti (Hulumtimi im)

Artistët dhe veprimtaria e tyre

Shkrimi im

Organizata e Kombeve të Bashkuara

LIDHJA NDËRLËNDORE

Mësimi i Gjuhës shqipe në klasën e njëmbëdhjetë- për nxënësit e komuniteteve joshqiptare ka rëndësi të madhe, sepse ofron mundësi për lidhje ndërlëndore. Nxënësit e përvetësojnë gjuhën shqipe dhe njëkohësisht fitojnë njohuri të shumta ose i përforcojnë ato, nga fushat e tjera të dijes dhe të komunikimit. Lidhja ndërlëndore ndërprogramore me mësimin e gjuhëve të tjera është më e theksuar: me mësimin e gjuhës amtare, me mësimin e gjuhës së huaj etj. Programi mësimor i kësaj lënde përfshin edhe përmbajtje të ndryshme nga fushat e tjera programore, siç janë: Artet, Shkencat shoqërore, Shkencat e natyrës, Edukata fizike dhe sportet, Edukata qytetare etj.

UDHËZIME METODOLOGJIKE

Për të realizuar me sukses programin e lëndës Gjuhë shqipe- për nxënësit e komuniteteve joshqiptare kërkohet zbatimi i metodologjisë bashkëkohore të mësimdhënies së gjuhëve dhe zbatimi i metodave dhe i teknikave mësimore adekuate. Mësimdhënësi i Gjuhës shqipe duhet të përqendrohet në disa parime bazë:

- përqendrimi në komunikimin (shkathësitë e komunikimit: të dëgjuarit dhe të folurit);
- përqendrimi në gjuhën e gramatizuar;
- përqendrimi në nxënien dhe në të nxënit e tij.

Komunikimi të zhvillohet në plan më të gjerë: bashkëbisedimi, dëgjimi i realizimeve programore audiovizuale me tematikë dhe me përmbajtje që lidhet me mësimin e gjuhës shqipe, të shprehurit me gojë, të shprehurit me shkrim, puna në grupe, në çifte, debatet, hartimet, testet, intervistat, letërkëmbimi, komunikimi përmes internetit, lojërat me role, lojërat skenike (dramatizimi), teste me vende të zbrazëta, lojëra mësimi dhe forma të tjera të komunikimit dhe të shkrimit.

Roli i mësimdhënësit është i pazëvendësueshën. Ai duhet të njohë dhe të zbatojë metodat bashkëkohore të mësimdhënies.

Mjetet mësimore: libri, fletorja e punës, fotografitë, materiali auditiv, videomateriali, ilustrimet, pastaj doracakë, atlasë, broshura, gazeta, revista profesionale dhe shkencore, fotoslajde, filma, videokaseta dhe mjete të tjera konkretizimi.

VLERËSIMI

Vlerësimi i punës me nxënësit dhe i suksesit në mësim ka rëndësi të madhe.

Mësimdhënësi vlerëson në vazhdimësi arritjet në procesin mësimor. Ai vlerëson:

- Njohuritë e fituara më parë;
- Ecurinë e punës dhe shkallën e fitimit të njohurive të reja;
- Përvetësimin e fjalorit të gjuhës shqipe;
- Shkathtësitë gjuhësore gjatë komunikimit;
- Kulturën e të folurit;
- Kulturën e të shkruarit;
- Aktivitetet individuale dhe grupore;
- Përvetësimin e drejtshkrimit të gjuhës shqipe;
- Saktësinë e pyetjeve dhe të përgjigjeve;
- Përshkrimet dhe shpjegimet;
- Njohuritë e fituara gramatikore;
- Aftësinë e përkthimit të tekstit të lexuar dhe të shkruar.

Duke pasur parasysh objektivat e përgjithshëm dhe objektivat specifike, vlerësohet sukcesi i kënaqshëm, i arritur me të gjithë nxënësit e klasës, por edhe me sejcilin nxënës. Vlerësohen ecuritë e volitshme, por edhe ato të pavolitshme të mësimin, identifikohen vështirësitë, pengesat, shqyrtohen problemet e veçanta të mësimdhënies, të përdorimit të mjeteve të konkretizimit etj., dhe ndërmerren masa për përmirësimin i nivelit të mësimin të gjuhës shqipe, që nxënësit të flasin, të lexojnë dhe të shkruajnë lirshëm dhe të arrijnë sukses sa më të mirë në mësim dhe në komunikim të përditshëm në shkollë dhe në mjedise të tjera.

Me vlerësimin e gjithanshëm dhe të vazhdueshëm mësimdhënësi synon të përmirësojë nivelin e mësimin. Vlerësimi i drejtpërdrejtë bëhet gjatë orëve të zhvillimit të orëve të mësimin dhe sidomos gjatë përforsimit të njësive mësimore, ndërsa vlerësimi i tërthort bëhet me anë të testeve dhe të detyrave me shkrim.

Vlerësimi apo vetëvlerësimi bëhet edhe nga nxënësit. Ata e pyesin njëri tjetrin, përgjigjen dhe bëjnë vlerësimin.

LITERATURA

Plani dhe programi mësimor 11, Prishtinë,

Gjuhë shqipe 11

Musai, Bardhyl: Metodologjia e mësimdhënies, Tiranë, 2003

Qendra për Arsimin e Kosovës: Modele të mësimdhënies sipas strukturës ERR, Prishtinë, 2003

Buleshkaj, O dhe Mizzi, R: Mesazhe nga klasa: Ide dhe modele për mësimdhënie me nxënësin në qendër, Prishtinë, 2003

Pupovci, D.: Modele të reja të mësimdhënies, Prishtinë, 2003

GJUHË SHQIPE

12

HYRJE

Mësimi i Gjuhës shqipe në këtë klasë, si edhe në të gjitha nivelet e tjera të shkollimit të mëparshëm, synon të sigurojë mundësi për komunikim brenda shoqërisë kosovare dhe më gjerë, për arsimim të gjithanshëm, për bashkëpunim dhe për qëllime të tjera shumë të dobishme për jetë dhe për veprimtari kulturore, shoqërore dhe ekonomike.

Gjatë hartimit të këtij programi mësimor janë marrë parasysh nivelet e përcaktuara në “*Kornizën e përbashkët evropiane të raportit mbi gjuhët*”, të miratuar dhe të publikuar nga Këshilli i Evropës (2001), kërkesat dhe kushtet e shkollimit të nxënësve dhe disa programe mësimore për gjuhën e dytë.

Përmbajtjet e programit të lëndës mësimore *Gjuhë shqipe* për klasën e dymbëdhjetë janë në funksion të mësimimit efikas të gjuhës shqipe. Ecuria e mësimimit në tërësi zgjon interesimin e duhur për ta përvetësuar gjuhën në mënyrë funksionale: nxënësit arrijnë nivel të mirë të përvetësimit të gjuhës shqipe dhe e përdorin atë në aktivitetet arsimore, kulturore dhe në veprimtari të tjera, pasurojnë fjalorin, përmirësojnë nivelin e të shprehurit me gojë dhe me shkrim, përdorin fjalë dhe shprehje nga jeta e përditshme, por edhe fjalë e shprehje të lëndëve të tjera mësimore, nga sferat e tjera të diturisë, parashetrojnë pyetje më komplekse dhe përgjigjen në mënyrën e duhur. duke përdorur edhe një pjesë të terminologjisë teknike-shkencore. Nxënësit aftësohen të komunikojnë lehtë, të flasin, të lexojnë dhe të shkruajnë. Programi përfshin këto kategori : Të dëgjuarit dhe të folurit, Të lexuarit dhe Të shkruarit.

Nënkategoritë e këtij programi mësimor përfshihen në pasqyrën tabelore.

QËLLIMI

Qëllimi i mësimin të Gjuhës shqipe në klasën e dymbëdhjetë për nxënësit e komuniteteve joshqiptare është përforcimi i njohurive të mëparshme, zhvillimi dhe përvetësimi i njohurive të reja të gjuhës shqipe dhe i shkathtësive të tjera të komunikimit.

- Nxënësit të kuptojnë fjalët, fjalitë, përmbajtjet dhe shprehjet gjuhësore dhe t'i shprehin mendimet e tyre me gojë dhe me shkrim. Të lexojnë dhe të shkruajnë në mënyrë të pavarur fjalë, fjali, dhe tekste të ndryshme; -Të përvetësojnë fjalë dhe shprehje nga jeta e përditshme dhe të angazhohen të hartojnë tekste të ndryshme për plotësimin nevojave konkrete;
- Zhvillimi i aftësive për të komunikuar me gojë dhe me shkrim në shkollë, jashtë shollës dhe në aktivitete të tjera;
- Përjetimi artistik i krijimeve të zgjedhura letrare dhe artistike.
- Realizimi i objektivave të përgjithshëm dhe specifikë, që para-sihen për mësimin e Gjuhës shqipe si lëndë mësimore për komunitete joshqiptare, siç janë: aftësimi i nxënësve për të folur, për të lexuar dhe për të shkruar gjuhën shqipe.
- Realizimi i këtij programi mësimor të Gjuhës shqipe në klasën e dymbëdhjetë përfshin përmbajtje më të pasura për mësimin e gjuhës, të letërsisë dhe të kulturës shqiptare në përgjithësi. Kjo është shkalla e tretë e mësimin të gjuhës shqipe. Duke pasur parasysh moshën e nxënësve dhe nivelin e mëparshëm të përvetësimin të gjuhës shqip, shtohen kërkesat programore por edhe ato të rezultateve të pritshme.

Vërejtje: Përmbajtjet e programin mësimor realizohen në funksion të tri kategorive kryesore: *TË DËGJUARIT DHE TË FOLURIT, TË LEXUARIT DHE TË SHKRUARIT*

Nënkategoritë

I.1, I.2, I.3. Kulturë e të dëgjuarit dhe të folurit, Kulturë e të lexuarit,

Kulturë e të shkruarit 40 orë

I.2, II.2, III.2 Tekste letrare dhe joletrare 20 orë

I.3, II.3, III.3 Njohuri gjuhësore 10 orë

Në dispozicion 4 orë

OBJEKTIVAT E PËRGJITHSHËM

Nxënësit duhet të jenë në gjendje:

Të zhvillojnë

- kulturën gjuhësore në nivel më të lartë
- shkathhtësitë e komunikimit

Të identifikojnë

- Tekste të ndryshme dhe elemente gjuhësore

Të praktikojnë

- Të folurit, leximin dhe shkrimin në gjuhën shqipe

Të zbatojnë

- Njohuritë e fituara gjuhësore: gramatikore dhe leksikore
- Njohuritë e fituara mbi modelet e teksteve letrare dhe joletrare

Të analizojnë

- Fjalë, fjali të thjeshta dhe fjali të përbëra
- Tekste të ndryshme

Të vlerësojnë

- Pasurinë e gjuhës shqipe me fjalë dhe me shprehje gjuhësore
- Tekste letrare dhe joletrare

Të formojnë qëndrimin kritik dhe të vlerësojnë vlerat

- Të zhvillojnë aftësitë për vlerësim kritik
- Të fitojnë shprehi të leximit dhe edukatë qytetare

KATEGORIA

I. TË DËGJUARIT DHE TË FOLURIT

Nënkategoritë:

- I. 1 Kulturë e të dëgjuarit dhe të folurit
- I. 2 Tekste letrare dhe joletrare
- I. 3 Njohuri gjuhësore

KATEGORIA

II. TË LEXUARIT

Nënkategoritë:

- II. 1 Kulturë e të lexuarit
- II. 2 Tekste letrare dhe joletrare
- II. 3 Njohuri gjuhësore

KATEGORIA

III. TË SHKRUARIT

Nënkategoritë:

- III. 1 Kulturë e të shkruarit
- III. 2 Tekste letrare dhe joletrare
- III. 3 Njohuri gjuhësore

Vërejtje: Përmbajtjet e programit mësimor realizohen në funksion të tri kategorive kryesore:

- I.1, I.2, I.3. Kulturë e të dëgjuarit dhe të folurit, Kulturë e të lexuarit, Kulturë e të shkruarit 40 orë
- I.2, II.2, III.2 Tekste letrare dhe joletrare 20 orë
- I.3, II.3, III.3 Njohuri gjuhësore 10 orë

Në dispozicion 4 orë

PROGRAMI NË FORMË TABELARE

Nënkategoritë: I.1, II.1 III.1	Përmbajtja	Rezultatet e pritshme
<p>* Kulturë e të dëgjuarit dhe të folurit * Kulturë e të lexuarit * Kulturë e të shkruarit</p>	<p>Gjuha e sotme shqipe (Fjalori i shqipes së sotme-për shkollën e mesme); Dëgjimi i të folmeve dhe krahasimi i tyre: ngjashmëritë dhe dallimet); Përmbajtja e tekstit, identifikimi i fjalorit dhe i shprehjeve gjuhësore; Forma të ndryshme të komunikimit: dialogu, monologu; Leximi i fragmenteve të teksteve të zgjedhura letrare: poezi, tregime dhe tekste dramatike; Identifikimi dhe krahasimi i teksteve letrare dhe joletrare; Kultura shqiptare dhe krahasimi i saj me kulturat e tjera; Krahasimi i teksteve të zgjedhura letrare dhe joletrare (Përmbajtja, motivet, temat, idetë, personazhet, figurat dhe shprehja letrare figurative, kompozicioni, veçoritë stilistike dhe gjuhësore); Shkrimi i përmbajtjes së tekstit të lexuar më parë; Analiza e tekstit, interpretimi dhe vlerësimi; Hartimi me shkrim; Korrigjimi i tekstit të shkruar; Përkthimi i tekstit duke përdorur fjalorët.</p>	<p>Nxënësit mësojnë gjuhën e sotme shqipe dhe e pasurojnë fjalorin; - Dallojnë të folmet dialektore; -Nxënësit dëgjojnë me vëmendje dhe kuptojnë pjesë të zgjedhura, recitime, dialogë, monologë, përmbajtje dhe paraqitje të ndryshme tonike; - Nxënësit flasin, lexojnë, shkruajnë dhe aftësohen për komunikim; - Përvetësojnë forma të ndryshme të komunikimit; - Njohin kulturën shqiptare dhe bëjnë krahasime me kulturat e tjera; Dallojnë veçoritë e teksteve të ndryshme letrare dhe joletrare; Lexojnë dhe shkruajnë tekste me përmbajtje të ndryshme; Aftësohen për të shprehur mendimet e tyre me gojë dhe me shkrim; - Krahasojnë tekstet letrare dhe joletrare; -Shkruajnë për përmbajtjen e tekstit., analizojnë, interpretojnë dhe vlerësojnë tekstin; - Korrigjojnë gabimet në të folur dhe në tekstin e shkruar; - Përkthejnë tekste duke përdorur fjalorin</p>

Nënkategoritë: I.2, II.2 III.3	Përmbajtja	Rezultatet e pritshme
*Tekste letrare dhe joletrare	<p>Tekste letrare dhe joletrare (Letërsi shqipe dhe letërsi botërore): poezi, poema (Fragmente), tregime, roman (Fragment), pjesë dramatike (Fragment).</p> <p>Nga krijimtaria popullore: përralla, fabula, poezi; Të kuptuarit e teksteve të zgjedhura letrare dhe joletrare (Përmbajtja, motivet, temat, idetë, personazhet, figurat dhe shprehja letrare figurative, kompozicioni, veçoritë stilistike dhe gjuhësore); Artikuj nga gazetatat dhe revistat për fëmijë; Përshkrimi i pamjeve të natyrës ; Krijimi letrar (Veçoritë kryesore) ; Gjuha e tekstit letrar dhe të folurit e përditshëm;</p>	<p>- Nxënësit identifikojnë tekstet joletrare dhe krijimet artistike. -Njohin veçoritë themelore të veprave letrare ; -Fitojnë njohuri për gjinitë dhe llojet letrare, për letërsinë popullore dhe për letërsinë e shkruar ; -Flasin dhe shkruajnë për vlerat artistike, lexojnë literaturë të zgjedhur dhe duke lexuar përjetojnë kënaqësinë estetike ; -Nxënësit shprehin mendimin vlerësues për aspekte të ndryshme të veprës; Komentojnë artikujt e lexuar në gazeta dhe në revista ; Bëjnë përshkrimet e natyrës sipas stinëve ; Analizojnë krijimin letrar ; Përvetësojnë gjuhën letrare</p>
Nënkategoritë I.3, II.3, III.3	Përmbajtja	Rezultatet e pritshme
*Njohuri gjuhësore	<p>Historia e gjuhës shqipe (njohuritë themelore): Dialektet e gjuhës shqipe (Njohuri për dialektologjinë: gjuha shqipe e folur në vise të ndryshme);</p> <ul style="list-style-type: none"> - Sistemi fonetik i shqipes së sotme standarde ; - Lakimi i emrave; - Zgjedhimi i foljeve të rregullta dhe të parregullta 	<ul style="list-style-type: none"> - Nxënësit shkurtimisht mësojnë historinë e gjuhës shqipe; – Njohin dialektet e shqipes; - Mësojnë sistemin fonetik të shqipes; - Përvetësohet lakimi i emrave; -Zgjedhojnë foljet e rregullta dhe të parregullta; Ushtrojnë formimin e fjalive me gojë dhe me shkrim; Përdorin drejt gjymtyrët e

	<ul style="list-style-type: none"> - Formimi i fjalive - Gjymtyrët kryesore të fjalisë - Formimi i fjalëve të reja; - Parashtesat dhe prapashtesat - Formimi i kompozitave - Fjalia e përbërë - Fjalia e përbërë me bashkërenditje - Llojet e fjalisë së përbërë me bashkërenditje; - Përshtatja e kryefjalës dhe e kallëzuesit Pjesët e pandryshueshme të ligjëratës: ndajfolja, lidhëza, pjesëza dhe pasthirrma; Sintaksë (Tipat e fjalisë dhe strukturat e tyre); Rendi i fjalëve në fjali; Ushtrime gjuhësore; Ushtrime përkthimi; 	<ul style="list-style-type: none"> fjalisë; Përdorin parashtesat dhe prapashtesat; Përvetësojnë përdorimin e kompozitave; - Përdorin lloje të ndryshme të fjalive të përbëra dhe me bashkërenditje; - Në tekst dallojnë fjalitë me shumë gjymtyrë; - Bëjnë përshtatjen e kryefjalës dhe të kallëzuesit; - Mësojnë për pjesët e pandryshueshme të ligjëratës dhe zbatojnë përdorimin e drejtë të tyre; - Përdorin lloje të ndryshme të fjalive; - Përvetësojnë përdorimin e drejtë të fjalëve në fjali; - Bëjnë ushtrime gjuhësore dhe të përkthimit;
--	---	--

Njësitë mësimore realizohen sipas planit dhe programit mësimor, varësisht nga numri i përgjithshëm i orëve mësimore. Parashihen orët për njësitë e reja mësimore dhe ato për përsëritje dhe përforsim të lëndës së mësuar më parë.

Përmbajtja:

Poezi të zgjedhura
Tregime të zgjedhura
Novela (Fragment)
Romani (Fragment)
Balada (Zgjedhje)
Këngë kreshnike (Fragment i zgjedhur)
Gjon Buzuku; “ Meshari” (Fragment)
Jeronim De Rada: ”Këngët e Milosaos”, Fragment
Naim Frashëri: “Historia e Skënderbeut”, Fragment

Migjeni: Kënga e rinisë
Esad Mekuli: “Popullit tim”
Enver Gjerqeku: “Mirë se erdhe, vogëlushi im!”
Dritëro Agolli: “ Në pranverë”
Din Mehmeti: “Kosovë- Zog i Diellit”, Fragment
Ismail Kadare: “Gjenerali i ushtrisë së vdekur”- Fragment
Nazmi Rrahmani : “Malësorja”-Fragment
Josip Relaj:”Nita”, Fragment
Letërsi botërore (Zgjedhje)
Shkruaj artikullin për gazetën e shkollës
Ese (Temë e lirë)
Parlamenti i Kosovës (Tekst i zgjedhur)
Të drejtat e njeriut

LIDHJA NDËRLËNDORE

Mësimi i Gjuhës shqipe në klasën e dymbëdhjetë- për nxënësit e komuniteteve joshqiptare ka rëndësi të madhe, sepse ofron mundësi për lidhje ndërlëndore. Nxënësit e përvetësojnë gjuhën shqipe dhe njëkohësisht fitojnë njohuri të shumta ose i përforcojnë ato, nga fushat e tjera të dijes dhe të komunikimit. Lidhja ndërlëndore ndërprogramore me mësimin e gjuhëve të tjera është më e theksuar: me mësimin e gjuhës amtare, me mësimin e gjuhës së huaj etj. Programi mësimor i kësaj lënde përfshin edhe përmbajtje të ndryshme nga fushat e tjera programore, siç janë: Artet, Shkencat shoqërore, Shkencat e natyrës, Edukata fizike dhe sportet, Edukata qytetare etj.

UDHËZIME METODOLOGJIKE

Për të realizuar me sukses programin e lëndës Gjuhë shqipe- për nxënësit e komuniteteve joshqiptare kërkohet zbatimi i metodologjisë bashkëkohore të mësimdhënies së gjuhëve dhe zbatimi i metodave dhe i teknikave mësimore adekuate. Mësimdhënësi i Gjuhës shqipe duhet të përqendrohet në disa parime bazë:

- përqendrimi në komunikimin (shkathtësitë e komunikimit: të dëgjuarit dhe të folurit); - përqendrimi në gjuhën e gramatizuar;
- përqendrimi në nxënien dhe në të nxënit e tij.

Komunikimi të zhvillohet në plan më të gjerë: bashkëbisedimi, dëgjimi i realizimeve programore audiovizuale me tematikë dhe me përmbajtje që lidhet me mësimin e gjuhës shqipe, të shprehurit me gojë, të shprehurit me shkrim, puna në grupe, në çifte, debatet, hartimet, testet, intervistat, letërkëmbimi, komunikimi nëpërmjet internetit, lojërat me role, lojërat skenike (dramatizimi), teste me vende të zbrazëta, lojëra mësimi dhe forma të tjera të komunikimit dhe të shkrimit.

Roli i mësimdhënësit është i pazëvendësueshëm. Ai duhet të njohë dhe të zbatojë metodat bashkëkohore të mësimdhënies.

Mjetet mësimore: libri, fletorja e punës, fotografitë, materiali auditiv, videomateriali, ilustrimet, pastaj doracakë, atlasë, broshura, gazeta, revista profesionale dhe shkencore, fotoslajde, filma, videokaseta dhe mjete e tjera të konkretizimit.

VLERËSIMI

Vlerësimi i punës me nxënësit dhe i suksesit në mësim ka rëndësi të madhe.

Mësimdhënësi vlerëson në vazhdimësi arritjet në procesin mësimor. Ai vlerëson:

- Njohuritë e fituara më parë;
- Vlerësimi i njohurive të reja në klasën e dymbëdhjetë;
- Ecurinë e punës dhe shkallën e fitimit të njohurive të reja;
- Përvetësimin e fjalorit të gjuhës shqipe;
- Shkathësitë gjuhësore gjatë komunikimit;
- Kulturën e të folurit;
- Kulturën e të shkruarit;
- Aktivitetet individuale dhe grupe;
- Vlerësimi i njohurive për historinë e gjuhës dhe të letërsisë shqipe
- Përvetësimin e drejtshkrimit të gjuhës shqipe;
- Saktësinë e pyetjeve dhe të përgjigjeve;
- Përshkrimet dhe shpjegimet ;
- Njohuritë e fituara gramatikore;
- Aftësinë e përkthimit të tekstit të lexuar dhe të shkruar.

Duke pasur parasysh objektivat e përgjithshëm dhe objektivat specifikë, vlerësohet sukcesi i kënaqshëm, i arritur me të gjithë nxënësit e

klasës, por edhe me sejcilin nxënës. Vlerësohen ecuritë e volitshme, por edhe ato të pavolitshme të mësimit, identifikohen vështirësitë, pengesat, shqyrtohen problemet e veçanta të mësimdhënies, të përdorimit të mjeteve të konkretizimit etj., dhe ndërmerren masa për përmirësimin i nivelit të mësimit të gjuhës shqipe, që nxënësit të flasin, të lexojnë dhe të shkruajnë lirshëm dhe të arrijnë sukses sa më të mirë në mësim dhe në komunikim të përditshëm në shkollë dhe në ambiente të tjera.

Me vlerësimin e gjithanshëm dhe të vazhdueshëm mësimdhënësi synon të përmirësojë nivelin e mësimit. Vlerësimi i drejtpërdrejtë bëhet gjatë orëve të zhvillimit të orëve të mësimit dhe sidomos gjatë përforcimit të njësive mësimore, ndërsa vlerësimi indirekt bëhet me anë të testeve dhe të detyrave me shkrim.

Vlerësimi apo vetëvlerësimi bëhet edhe nga nxënësit. Ata e pyesin njëri tjetrin, përgjigjen dhe bëjnë vlerësimin.

LITERATURA

Plani dhe programi mësimor 12, MASHT, Prishtinë, 2005

Plani dhe programi mësimor 11, MASHT, Prishtinë, 2004

Gjuhë shqipe 11, Prishtinë, 2005

Musai, Bardhyl: Metodologjia e mësimdhënies, Tiranë, 2003

GJUHË SHQIPE

13

HYRJE

Lënda *Gjuhë shqipe* për klasën e trembëdhjetë - për nxënësit e komuniteteve joshqiptare të Kosovës ka objektiva të përgjithshëm dhe specifike. Mësimi i Gjuhës shqipe në këtë klasë, si edhe në të gjitha nivelet e tjera të shkollimit të mëparshëm, synon të sigurojë mundësi për komunikim brenda shoqërisë kosovare dhe më gjerë, për arsimim të gjithanshëm, për bashkëpunim dhe për qëllime të tjera shumë të dobishme për jetë dhe për veprimtari kulturore, shoqërore dhe ekonomike.

Gjatë hartimit të këtij programi mësimor janë marrë parasysh nivelet e përcaktuara në “*Kornizën e përbashkët evropiane të raportit mbi gjuhët*”, të miratuar dhe të publikuar nga Këshilli i Evropës (2001), kërkesat dhe kushtet e shkollimit të nxënësve dhe disa programe mësimore për gjuhën e dytë.

Përmbajtjet e programit të lëndës mësimore *Gjuhë shqipe* për klasën e trembëdhjetë janë në funksion të mësimimit efikas të gjuhës shqipe. Ecuria e mësimimit në tërësi zgjon interesimin e duhur për ta përvetësuar gjuhën në mënyrë funksionale: nxënësit arrijnë nivel të mirë të përvetësimit të gjuhës shqipe dhe e përdorin atë në aktivitetet arsimore, kulturore dhe në veprimtari të tjera, pasurojnë fjalorin, përmirësojnë nivelin e të shprehurit me gojë dhe me shkrim, përdorin fjalë dhe shprehje nga jeta e përditshme, por edhe fjalë e shprehje të lëndëve të tjera mësimore, nga sferat e tjera të diturisë, parashtrojnë pyetje më komplekse dhe përgjigjen në mënyrën e duhur. duke përdorur edhe një pjesë të terminologjisë teknike-shkencore. Nxënësit aftësohen të komunikojnë lehtë, të flasin, të lexojnë dhe të shkruajnë. Programi përfshin këto kategori : Kulturë e të dëgjuarit dhe të folurit, Kulturë e të lexuarit, Kulturë e të shkruarit.

Nënkategoritë e këtij programi mësimor përfshihen në pasqyrën tabelore.

QËLLIMI

Qëllimi i mësimin të Gjuhës shqipe në klasën e trembëdhjetë- për nxënësit e komuniteteve joshqiptare është përforcimi i njohurive të mëparshme, zhvillimi dhe përvetësimi i njohurive të reja të gjuhës shqipe dhe i shkathtësive të tjera të komunikimit.

- Nxënësit të kuptojnë fjalët, fjalitë, përmbajtjet dhe shprehjet gjuhësore dhe t'i shprehin mendimet e tyre me gojë dhe me shkrim. Të lexojnë dhe të shkruajnë në mënyrë të pavarur fjalë, fjali, dhe tekste të ndryshme; -Të përvetësojnë fjalë dhe shprehje nga jeta e përditshme dhe të angazhohen të hartojnë tekste të ndryshme për plotësimin nevojave konkrete;
- Zhvillimi i aftësive për të komunikuar me gojë dhe me shkrim në shkollë, jashtë shollës dhe në aktivitete të tjera;
- Përjetimi artistik i krijimeve të zgjedhura letrare dhe artistike.
- Realizimi i objektivave të përgjithshëm dhe specifike, që parashihen për mësimin e Gjuhës shqipe si lëndë mësimore për komunitete joshqiptare, siç janë: aftësimi i nxënësve për të folur, për të lexuar dhe për të shkruar gjuhën shqipe.
- Realizimi i këtij programi mësimor të Gjuhës shqipe në klasën e trembëdhjetë përfshin përmbajtje më të pasura për mësimin e gjuhës, të letërsisë dhe të kulturës shqiptare në përgjithësi. Kjo është shkalla e tretë e mësimin të gjuhës shqipe. Duke pasur parasysh moshën e nxënësve dhe nivelin e mëparshëm të përvetësimit të gjuhës shqipe, shtohen kërkesat programore por edhe ato të rezultateve të pritshme.

Vërejtje: Përmbajtjet e programit mësimor realizohen në funksion të tri kategorive kryesore:

I.1, I.2, I.3. Kulturë e të dëgjuarit dhe të folurit, Kulturë e të lexuarit, Kulturë e të shkruarit 40 orë

I.2, II.2, III.2 Tekste letrare dhe joletrare 20 orë

I.3, II.3, III.3 Njohuri gjuhësore 10 orë

Në dispozicion 4 orë

OBJEKTIVAT E PËRGJITHSHËM

Nxënësit duhet të jenë në gjendje:

- Të zhvillojnë kulturën gjuhësore në nivel më të lartë se më parë
- Të flasin, të shkruajnë dhe të komunikojnë në gjuhën shqipe
- Të kuptojnë dhe të analizojnë tekste letrare dhe joletrare

Të identifikojnë

- Tekste të ndryshme dhe elemente gjuhësore
- Shkathtësi të komunikimit

Të zbatojnë

- Njohuritë e fituara gjuhësore, gramatikore dhe leksikore
- Njohuritë e fituara mbi modelet e teksteve letrare dhe joletrare

Të analizojnë

- Fjalë, fjali të thjeshta dhe fjali të përbëra
- Periudha të ndryshme
- Tekste të ndryshme

Të vlerësojnë

- Pasurinë e gjuhës shqipe me fjalë dhe me shprehje gjuhësore
- Tekste letrare dhe joletrare

Të formojnë qëndrimin kritik dhe të vlerësojnë veprat letrare dhe tekstet e tjera

- Të zhvillojnë aftësitë për vlerësim kritik
- Të përvetësojnë shkathtësitë e komunikimit
- Të fitojnë shprehi të leximit dhe edukatë qytetare
- Të shkruajnë ese

KATEGORIA

I. TË DËGJUARIT DHE TË FOLURIT

Nënkategoritë:

- I. 1 Kulturë e të dëgjuarit dhe të folurit
- I. 2 Tekste letrare dhe joletrare
- I. 3 Njohuri gjuhësore

KATEGORIA

II. TË LEXUARIT

Nënkategoritë:

- II. 1 Kulturë e të lexuarit
- II. 2 Tekste letrare dhe joletrare
- II. 3 Njohuri gjuhësore

KATEGORIA

III. TË SHKRUARIT

Nënkategoritë:

- III. 1 Kulturë e të shkruarit
- III. 2 Tekste letrare dhe joletrare
- III. 3 Njohuri gjuhësore

Vërejtje: Përmbajtjet e programit mësimor realizohen në funksion të tri kategorive kryesore:

I.1, I.2, I.3. Kulturë e të dëgjuarit dhe të folurit, Kulturë e të lexuarit,
Kulturë e të shkruarit 40 orë

I.2, II.2, III.2 Tekste letrare dhe joletrare 20 orë

I.3, II.3, III.3 Njohuri gjuhësore 10 orë

Në dispozicion 4 orë

PROGRAMI NË FORMË TABELARE

Nënkategoritë: I.1, II.1 III.1	Përmbajtja	Rezultatet e pritshme
<p>* Kulturë e të dëgjuarit dhe të folurit</p> <p>* Kulturë e të lexuarit</p> <p>* Kulturë e të shkruarit</p>	<p>Fillimi i vitit të ri shkollor (Bashkëbisedim)</p> <p>Komunikimi me internet</p> <p>Ngjarjet aktuale në shkollë dhe jashtë shkollës (Komente në bazë të leximit të shtypit dhe të mjeteve të tjera të informimit)</p> <p>Një pjesë e shikuar teatrale (Bisedë)</p> <p>Vështrim me shkrim për veprën e lexuar</p> <p>Bisedë për filmin e shikuar</p> <p>Shkrimi i biografisë personale</p> <p>Plotësimi i aplikacioneve të ndryshme</p> <p>Ese</p> <p>Korrigjimi i esesë</p> <p>Profesionet e ndryshme (Bashkëbisedim)</p> <p>Hartimi i raportit</p> <p>Lajmi</p> <p>Reportazhi</p> <p>Kuizi i diturisë (Lënda: Gjuha shqipe)</p> <p>Recitime të zgjedhura</p> <p>Diktim</p> <p>Korrigjimi i diktimit</p> <p>Hartimi i ftesave</p> <p>Fjalori i gjuhës shqipe (Nxënësit kompletojnë fjalorin e vet)</p> <p>Ushtrime gjuhësore</p>	<p>Nxënësit flasin për fillimin e vitit shkollor.</p> <p>Aftësohen të komunikojnë me internet.</p> <p>Komentojnë ngjarjet aktuale në shkollë dhe jashtë shkollës.</p> <p>Flasin për pjesën e shikuar teatrale.</p> <p>Në vështrimin e tyre nxënësit analizojnë veprën e lexuar.</p> <p>Zhvillojnë bisedën për filmin e shikuar.</p> <p>Shkruajnë biografinë personale.</p> <p>Shkruajnë ese me temë të lirë.</p> <p>Bëjnë korrigjimin e esesë.</p> <p>Bisedojnë për profesionet e ndryshme.</p> <p>Hartojnë raport.</p> <p>Përgatisin me shkrim lajmet për gazetën e shkollës.</p> <p>Shkruajnë reportazh.</p> <p>Organizojnë kuizin e diturisë (Lënda:Gjuha shqipe).</p> <p>Recitojnë poezi të zgjedhura.</p> <p>Shkruajnë tekstin e diktuar.</p> <p>Bëjnë korrigjimin e diktimit.</p> <p>Shkruajnë ftesat.</p> <p>Kompletojnë një fjalor të vogël të gjuhës shqipe.</p> <p>Bëjnë ushtrime gjuhësore</p>

Nënkategoritë: I.2, II.2 III.3	Përmbajtja	Rezultatet e pritshme
*Tekste letrare dhe joletrare	<p>Tekste letrare dhe joletrare (Letërsi shqipe dhe letërsi botërore): poezi, poema (Fragmente), tregimi, novela, romani (Fragmente), pjesë dramatike (Fragment).</p> <p>Romani “<i>Gjenerali i ushtrisë së vdekur</i>” i Ismail Kadaresë (tema, idetë, veçoritë e romanit modern, personazhet, kompozicioni, stili, gjuha)</p> <p>Shkspiri: <i>Romeo dhe Zhulieta</i> (Fragment)</p> <p>Homeri: Akili qan për shokun e tij. (Fragment nga “<i>Iliada</i>”)</p> <p>Nga krijimtaria popullore: përralla, fabula, poezi;</p> <p>Të kuptuarit e teksteve të zgjedhura letrare dhe joletrare (Përmbajtja, motivet, temat, idetë, personazhet, figurat dhe shprehja figurative, kompozicioni, veçoritë stilistike dhe gjuhësore);</p> <p>Artikuj nga gazetat dhe revistat për fëmijë;</p> <p>Përshkrimi i pamjeve të natyrës ;</p> <p>Krijimi letrar (Veçoritë kryesore) ; Gjuha e tekstit letrar dhe të folurit e përditshëm;</p> <p>Gjeçovi: <i>Buka, kripa e zemra</i></p> <p>Esad Mekuli: <i>Popullit tim</i></p> <p>Migjeni: <i>Kanga e rinisë</i></p> <p><i>Fjalë të urta shqipe</i></p> <p>Vuk S. Karaxhiq : <i>Fjalë të urta popullore</i> (Zgjedhje nga libri: Vuk S. Karaxhiq: <i>Pjesë të zgjedhura</i>, Rilindja, Prishtinë, 1987)</p>	<p>- Nxënësit identifikojnë tekstet joletrare dhe krijimet artistike. -Njohin veçoritë themelore të veprave letrare ;</p> <p>-Fitojnë njohuri për gjinitë dhe llojet letrare, për letërsinë popullore dhe për letërsinë e shkruar ; -Flasin dhe shkruajnë për vlerat artistike, lexojnë literaturë të zgjedhur dhe duke lexuar përjetojnë kënaqësinë estetike ;</p> <p>-Nxënësit shprehin mendimin vlerësues për aspekte të ndryshme të veprës;</p> <p>Komentojnë artikujt e lexuar në gazeta dhe në revista ;</p> <p>Bëjnë përshkrimet e natyrës sipas stinëve ;</p> <p>Analizojnë krijimin letrar ;</p> <p>Përvetësojnë gjuhën letrare dhe informohen për çështje të ndryshme të jetës së rinisë dhe të shoqërisë</p> <p>Bëjnë përshkrimin e natyrës dhe pasurojnë fjalorin.</p> <p>Njohin veçoritë e krijimit letrar.</p> <p>Dallojnë mirë gjuhën e tekstit letrar nga të folurit e përditshëm.</p> <p>Lexojnë dhe analizojnë veprat letrare të autorëve</p>

	<p>Azem Shkreli: <i>E di një fjalë prej guri</i> Desanka Maksimoviq: <i>Vjeshtë e hareshme</i> <i>Ditari i Ana Frankut</i> (Fragment) Llazar Vuçković: <i>Pika e verës</i> Arif Bozaxhi <i>Sytë</i> Rexhep Qosja: Kritika letrare (Fragment i zgjedhur) Vështrimi kritik për veprën e lexuar. Ese (Tema e lirë)</p>	<p>të ndryshëm. Përdorin fjalët e urta dhe aftësohen të shprehin edhe vetë disa mendime aforistike. Lexojnë dhe analizojnë veprat letrare. Hartojnë fjalorin e veçantë me fjalët dhe shprehjet e teksteve të lexuara. Krahasojnë sajimet letrare dhe vlerësojnë vlerën e tyre artistike, stilistike dhe gjuhësore. Njohin veçoritë e kritikës letrare. Vepra letrare-lexuesi-kritika letrare (Bashkëbisedim)</p>
Nënkategoritë I.3, II.3, III.3	Përmbajtja	Rezultatet e pritshme
*Njohuri gjuhësore	<p>Gramatika e gjuhës shqipe Morfologjia dhe sintaksa përbëjnë gramatikën e një gjuhe. Morfologjia Pjesët e ndryshueshme të ligjëratës që lakohen: emri, mbiemri, përemri, numërori, ose që zgjedhohen: folja Pjesët e pandryshueshme të ligjëratës që nuk lakohen dhe nuk zgjedhohen: parafjala, lidhëza, dhe pjesëza. Nyjat e përparme Nyjat e prapme (nyjat shquese Tema e fjalës Fjalëformimi Zgjedhimi i foljeve Klasifikimi i foljeve sipas zgjedhimeve Foljet e parregullta</p>	<p>Fitojnë njohuri të përgjithshme për Morfologjinë dhe Sintaksën e gjuhës shqipe. Njohin pjesët e ligjëratës dhe lakojnë nëpër rasia pjesët e ndryshueshme Mësojnë zgjedhimin e foljeve. Mësojnë përdorimin e pesëve të pandryshueshme të ligjëratës. Përdorin drejt nyjat e përparme dhe ato shquese (të prapme). Dallojnë temën e fjalës. Njohin mënyrat e fjalëformimit të shqipes. Bëjnë zgjedhimin e</p>

	<p>Mënyrat e foljes Kohët e foljes Pjesorja Përcjellorja Ushtrime gjuhësore Sintaksa <i>Sintaksa e fjalisë</i> Njësitë sintaksore: Fjalja Periudha Togfjalëshi Kryefjala Kallëzuesi Gjymtyrët e tjera të fjalisë Rendi i fjalëve dhe i gjymtyrëve në fjali Llojet e fjalive: Fjalitë dëftore Fjalitë dëftore-thirrmore Fjalitë dëshirore-nxitëse Fjalitë pyetëse <i>Sintaksa e periudhës</i> Periudha dhe përbërja e saj Ushtrime gramatikore Hartim i lirë</p>	<p>foljeve në mënyra të ndryshme dhe në të ndryshme. Përdorin foljet e parregullta. Përdorin foljet në pjesore dhe në përcjellore Aftësohen të bëjnë ushtrime të ndryshme gjuhësore Fitojnë njohuri të përgjithshme për Sintaksën e gjuhës shqipe. Përdorin fjalitë dhe periudhat. Dallojnë togfjalëshin dhe e përdorin në fjali. Mësojnë gjymtyrët e fjalisë. Përdorin lloje të ndryshme të fjalisë. Aftësohen të analizojnë fjalinë dhe të përdorin kryefjalën, kallëzuesin dhe gjymtyrët e tjera sipas renditjes së duhur. Formojnë fjali me gjymtyrë të tjera dhe kuptojnë se çfarë duhet të jetë rendi i fjalëve në fjalitë e përbëra. Fitojnë njohuri të përgjithshme për sintaksën e periudhës.</p>
--	---	---

Njësitë mësimore realizohen sipas planit dhe programit mësimor, varësisht nga numri i përgjithshëm i orëve mësimore. Parashihen orët për njësitë e reja mësimore dhe ato për përsëritje dhe përfundim të lëndës së mësuar më parë.

LIDHJA NDËRLËNDORE

Mësimi i Gjuhës shqipe në klasën e trembëdhjetë- për nxënësit e komuniteteve joshqiptare ka rëndësi të madhe, sepse ofron mundësi për lidhje ndërlëndore. Nxënësit e përvetësojnë gjuhën shqipe dhe njëkohësisht fitojnë njohuri të shumta ose i përforcojnë ato, nga fushat e tjera të dijes dhe të komunikimit. Lidhja ndërlëndore ndërprogramore me mësimin e gjuhëve të tjera është më e theksuar: me mësimin e gjuhës amtare, me mësimin e gjuhës së huaj etj. Programi mësimor i kësaj lënde përfshin edhe përmbajtje të ndryshme nga fushat e tjera programore, siç janë: Artet, Shkencat shoqërore, Shkencat e natyrës, Edukata fizike dhe sportet, Edukata qytetare etj.

UDHËZIME METODOLOGJIKE

Për të realizuar me sukses programin e lëndës Gjuhë shqipe 13 për nxënësit e komuniteteve joshqiptare kërkohet zbatimi i metodologjisë bashkëkohore të mësimdhënies së gjuhëve dhe zbatimi i metodave dhe i teknikave mësimore adekuate. Mësimdhënësi i Gjuhës shqipe duhet të përqendrohet në disa parime bazë:

- përqendrimi në komunikimin (shkathësitë e komunikimit: të dëgjuarit dhe të folurit);
- përqendrimi në gjuhën e gramatizuar;
- përqendrimi në nxënien dhe në të nxënit e tij.

Komunikimi të zhvillohet në plan më të gjerë: bashkëbisedimi, dëgjimi i realizimeve programore audiovizuale me tematikë dhe me përmbajtje që lidhet me mësimin e gjuhës shqipe, të shprehurit me gojë, të shprehurit me shkrim, puna në grupe, në çifte, debatet, hartimet, testet, intervistat, letërkëmbimi, komunikimi nëpërmjet internetit, lojërat me role, lojërat skenike (dramatizimi), teste me vende të zbrazëta, lojëra mësimi dhe forma të tjera të komunikimit dhe të shkrimit.

Roli i mësimdhënësit është i pazëvendësueshëm. Ai duhet të njohë dhe të zbatojë metodat bashkëkohore të mësimdhënies.

Mjetet mësimore: libri, fletorja e punës, fotografitë, materiali auditiv, videomateriali, ilustrimet, pastaj doracakë, atlase, broshura, gazeta, revista profesionale dhe shkencore, fotoslajde, filma, videokaseta dhe mjete e tjera të konkretizimit.

VLERËSIMI

Vlerësimi i punës me nxënësit dhe i suksesit në mësim ka rëndësi të madhe.

Mësimdhënësi vlerëson në vazhdimësi arritjet në procesin mësimor. Ai vlerëson:

- Njohuritë e fituara më parë;
- Vlerësimi i njohurive të reja në klasën e trembëdhjetë;
- Ecurinë e punës dhe shkallën e fitimit të njohurive të reja;
- Përvetësimin e fjalorit të gjuhës shqipe;
- Shkathësitë gjuhësore gjatë komunikimit;
- Kulturën e të folurit;
- Kulturën e të shkruarit;
- Aktivitetet individuale dhe grupore;
- Vlerësimi i njohurive të përgjithshme për historinë e gjuhës dhe të letërsisë shqipe
- Përvetësimin e drejtshkrimit të gjuhës shqipe;
- Saktësinë e pyetjeve dhe të përgjigjeve;
- Përshkrimet dhe shpjegimet ;
- Njohuritë e fituara gramatikore;
- Aftësinë e përkthimit të tekstit të lexuar dhe të shkruar.

Duke pasur parasysh objektivat e përgjithshëm dhe objektivat specifike, vlerësohet sukcesi i kënaqshëm, i arritur me të gjithë nxënësit e klasës, por edhe me secilin nxënë. Vlerësohen ecuritë e volitshme, por edhe ato të pavolitshme të mësimin, identifikohen vështirësitë, pengesat, shqyrtohen problemet e veçanta të mësimdhënies, të përdorimit të mjeteve të konkretizimit etj., dhe ndërmerren masa për përmirësimin i nivelit të mësimin të gjuhës shqipe, që nxënësit të flasin, të lexojnë dhe të shkruajnë lirshëm dhe të arrijnë sukses sa më të mirë në mësim dhe në komunikim të përditshëm në shkollë dhe në ambiente të tjera.

Me vlerësimin e gjithanshëm dhe të vazhdueshëm mësimdhënësi synon të përmirësojë nivelin e mësimin. Vlerësimi i drejtpërdrejtë bëhet gjatë zhvillimit të orëve të mësimin dhe sidomos gjatë përforcimit të

njësive mësimore, ndërsa vlerësimi indirekt bëhet me anë të testeve dhe të detyrave me shkrim.

Vlerësimi apo vetëvlerësimi bëhet edhe nga nxënësit. Ata e pyesin njëri tjetrin, përgjigjen dhe bëjnë vlerësimin.

LITERATURA

Plani dhe programi mësimor 11, MASHT, Prishtinë, 2004

Plani dhe programi mësimor 12, MASHT, Prishtinë, 2005

Plani dhe programi mësimor 13, MASHT, Prishtinë, 2006

Gjuhë shqipe 11, Prishtinë, 2005

Tirazhi: 500 copë

E përgatiti për shtyp
SHTËPIA BOTUESE LIBRI SHKOLLOR – Prishtinë
Shtypi: GRAF-ING - Prishtinë

Katalogimi në botim - (CIP)
Biblioteka Kombëtare dhe Universitare e Kosovës

371.214 (496.51)

Plani dhe programi mësimor gjuhë shqipe : Për nxënësit e komuniteteve joshqiptare për klasat 3,4,5,6,7,8,9,10,11,12,13 / [Kryeredaktor Fehmi Ismaili].- Prishtinë : Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë, 2007 (Prishtinë: "Graf-ing").- 156 fq. ; 24 cm.

Literatura pas çdo punimi

ISBN 978-9951-16-009-4